Shërbime konsulence për zbatimin

e

# Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Shqipëri

## - Draft Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve Qarku Berat -




**30 Gusht 2019**

Financuar nga:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs, Education and Research EAER
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**

Zbatuar nga:

INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

SEHLHOFF GMBH
INGENIEURE + ARCHITEKTEN

FLAG
FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE

## TABELA E PËRMBAJTJES

**0 Përmbledhje ekzekutive ....... i**

**1 Informacion i përgjithshëm ....... 1**

1.1 Fushëveprimi i Planit ....... 2

1.2 Përmbledhje e sfidave kryesore sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat ....... 2

1.3 Kuadri rregullator dhe i politikave ....... 3

1.3.1 Kuadri ligjor ....... 3

1.3.2 Politikat dhe standardet ....... 8

1.3.3 Strategjitë dhe Planet ....... 9

1.4 Objektivat e përcaktuar në dokumentet ligjore dhe të politikave ....... 12

1.5 Konsultime me aktorët kryesorë për përgatitjen e PRMM ....... 16

**2 Analiza e Status-Quo ....... 18**

2.1 Kuadri i përgjithshëm ....... 18

2.2 Demografia & zhvillimi i popullsisë ....... 21

2.3 Karakteristikat e mbetjeve bashkiake në Qarkun Berat ....... 23

2.3.1 Përbërja e mbetjeve ....... 23

2.3.2 Sasitë e mbetjeve ....... 24

2.4 Organizimi institucional ....... 26

2.4.1 Niveli kombëtar ....... 26

2.4.2 Niveli rajonal ....... 27

2.4.3 Niveli vendor ....... 27

2.5 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve ....... 30

2.5.1 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve bashkiake të përziera ....... 30

2.5.2 Grumbullimi i materialeve të riciklueshme ....... 32

2.6 Trajtimi i mbetjeve ....... 32

2.7 Depozitimi i mbetjeve ....... 33

2.8 Kostot dhe financimi ....... 36

2.8.1 Kostot e shërbimeve MMN ....... 36

2.8.2 Financimi i shërbimeve MMN ....38
2.8.3 Vlerësimi i përballueshmërisë financiare ....40
2.9 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet ....41
**3 Planifikimi i menaxhimit rajonal të mbetjeve ....44**
3.1 Supozimet bazë për planifikimin ....44
3.1.1 Aktivitete rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve ....44
3.1.2 Bashkëpunimi me Zonat e tjera të Mbetjeve për menaxhimin rajonal të mbetjeve ....44
3.1.3 Parashikimi i numrit të popullsisë ....47
3.1.4 Parashikimi i sasisë së mbetjeve ....48
3.2 Përcaktimi i objektivave ....51
3.3 Teknologjitë dhe metodat e planifikuara për menaxhimin e ardhshëm rajonal të mbetjeve ....56
3.3.1 Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve ....56
3.3.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve ....59
3.3.3 Trajtimi i mbetjeve ....71
3.3.4 Asgjësimi i mbetjeve....81
3.3.5 Përmbledhje e teknologjive dhe metodave të preferuara ....87
3.4 Organizimi institucional për menaxhimin rajonal të mbetjeve ....88
3.4.1 Funksionet e Entit për drejtimin e objekteve rajonale MMN ....89
3.4.2 Alternativat institucionale dhe organizative për menaxhimin rajonal të mbetjeve ....90
3.4.3 Pjesëmarrja e sektorit privat në menaxhimin rajonal të mbetjeve ....95
3.4.4 Alternativa e parapëlqyer për drejtimin e objekteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve ....95
3.4.5 Procedurat për themelimin e një Autoriteti të Kompetencave të Përbashkëta në formën e një Shoqërie Aksionere dhe regjistrimi përkatës ....96
3.4.6 Struktura funksionale për menaxhimin rajonal të mbetjeve....97
3.5 Ekonomia dhe financimi....98
3.5.1 Financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve bashkiake....98
3.5.2 Kërkesat për financim....99
3.5.3 Kostot dhe mbulimi i kostove të shërbimeve MMN ....101
3.6 Ndërgjegjësimi publik, informimi dhe pjesëmarrja ....105
3.6.1 Informimi dhe marrëdhëniet me publikun....106

3.6.2 Masat për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut ........ 106
3.7 Menaxhimi i rrymave të tjera të mbetjeve ........ 108
3.7.1 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet ........ 108
3.7.2 Mbetjet nga aktivitetet tregtare dhe industriale ........ 111
3.7.3 Llumrat e kanalizimeve ........ 111
3.7.4 Mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet spitalore ........ 113
3.7.5 Mbetjet spitalore ........ 114
3.7.6 Rryma të veçanta mbetjesh nën Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) ........ 115
3.8 Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i Planit ........ 122
**4 Plani i Veprimit ........ 123**

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Statusi i Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve (PVMM) të bashkive në Qarkun Berat ........ 12
Tabela 2 Sasitë e mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara në Qarkun Berat në 2018 ........ 25
Tabela 3 Përfshirja e sektorit privat në shërbimet bashkiake të MMN ........ 30
Tabela 4 Lista e vend depozitimeve të identifikuara nga Nisma e Zbutjes së Riskut në Vend depozitime ........ 35
Tabela 5 Buxheti bashkiak (2018) për shërbimet MMN ........ 37
Tabela 6 Shpenzime për MMN dhe kostot specifike në 2017 ........ 37
Tabela 7 Alokimi i buxhetit për shërbimet MMN (2017) ........ 37
Tabela 8 Tarifat për shërbimet MMN për familje ........ 38
Tabela 9 Niveli i tarifave për shërbimet MMN që u tarifohen bizneseve ........ 39
Tabela 10 Të ardhurat nga tarifat MMN të mbledhura në 2017 sipas burimit ........ 39
Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet për MMN në 2017 në bashkitë e Qarkut Berat ........ 40
Tabela 12 Vendndodhjet e vend depozitimeve për mbetjet inerte të përcaktuara nga bashkitë ........ 43
Tabela 13 Sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit ........ 48

| | | |
|---|---|---|
| Tabela 14 | Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve për Qarkun Berat (2018 – 2042) | 49 |
| Tabela 15 | Objektivat e draft SKMIM (Korrik 2019) ku është bazuar përgatitja e PRMM | 53 |
| Tabela 16 | Synimet kombëtare për rikuperimin e mbetjeve (Draft SKMIM, Korrik 2019) | 63 |
| Tabela 17 | Krahasimi i alternativave teknologjike të identifikuara për trajtimin e mbetjeve të përziera | 76 |
| Tabela 18 | Përmbledhje e specifikimeve kyç të alternativave për trajtimin e mbetjeve të përziera | 78 |
| Tabela 19 | Lista e vendgrumbullimeve të identifikuara në Nismën e Zbutjes së Riskut në Vend depozitime | 85 |
| Tabela 20 | Përmbledhje e investimeve fillestare (pa përfshirë taksat dhe kostot e konsulencës) | 100 |
| Tabela 21 | Përllogaritje e kostove vjetore [EUR/vit] | 102 |
| Tabela 22 | Kostot specifike për tre skenarët e zbatimit [EUR/t] | 104 |
| Tabela 23 | Llogaritja e tarifave (që mbulojnë kostot) për familje për tre skenarët e zbatimit | 104 |
| Tabela 24 | Plani i Veprimit, i cili përmbledh aktivitetet kryesore, përgjegjësitë dhe afatet kohore për zbatimin e PRMM | 124 |


## TABELA E FIGURAVE


| | | |
|---|---|---|
| Figura 1 | Hierarkia e mbetjeve në përputhje me Direktivën Kuadër të BE | 13 |
| Figura 2 | Synimet për MMN në politikat dhe rregulloret shqiptare dhe direktivat e BE | 16 |
| Figura 3 | Hapat kyç për përgatitjen e PRMM dhe VSM përfshi procesin e konsultimit | 17 |
| Figura 4 | Pamje e përgjithshme e Qarkut Berat | 19 |
| Figura 5 | Rënia e numrit të popullsisë së Qarkut Berat gjatë viteve të kaluara | 21 |
| Figura 6 | Popullsia e përllogaritur e bashkive të Qarkut Berat në 2018 bazuar në të dhënat e INSTAT, të regjistrit civil dhe faktorit të korrigjimit të MF | 22 |
| Figura 7 | Përbërja e mbetjeve urbane e përllogaritur nga projekti SELEA | 24 |
| Figura 8 | Ofrimi i shërbimeve MMN në njësitë administrative të Qarkut Berat | 31 |

Figura 9 Vendndodhja e vendgrumbullimeve ekzistuese në Qarkun Berat..............34

Figura 10 Sasitë e mbetjeve inerte nga ndërtimet dhe prishjet në bashkitë e Qarkut Berat, të përllogaritura për vitin 2018..........................................42

Figura 11 Distancat e transportit drejt impianteve të trajtimit/ asgjësimit të mbetjeve jashtë Qarkut Berat..................................................................46

Figura 12 Parashikimi i popullsisë për Qarkun Berat (2018 – 2042)..........................47

Figura 13 Parashikimi i sasive të mbetjeve që do të grumbullohen deri në 2033.......50

Figura 14 Parashikimi i sasive të mbetjeve të grumbulluara sipas materialeve përbërëse..........................................................................................51

Figura 15 Ilustrimi i përkufizimit të parandalimit të mbetjeve ....................................57

Figura 16 Metodat e mundshme të grumbullimit......................................................60

Figura 17 Kamion kompaktor me vëllim 7 m³ ...........................................................61

Figura 18 Shembull i një kamioni vetëshkarkues me shasi 8.5 t (i mundshëm edhe si 4x4) .......................................................................................62

Figura 19 Distancat e transportit midis bashkive ......................................................68

Figura 20 Parimet e stacioneve të transferimit me ngarkim direkt pa ngjeshje dhe me ngjeshje.......................................................................................69

Figura 21 Stacion transferimi me rampë në Ersekë, Qarku Korçë............................70

Figura 22 Hapat e proceseve dhe produktet e impianteve TMB ...............................74

Figura 23 Komponentët e një impianti për incinerimin e mbetjeve............................75

Figura 24 Vendndodhja e vendgrumbullimeve ekzistuese në Qarkun Berat..............85

Figura 25 Ndërhyrjet kryesore për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat gjatë të tria fazave.............................................................88

Figura 26 Struktura funksionale e propozuar e kompanisë publike rajonale të menaxhimit të mbetjeve ..........................................................................97

Figura 27 Kostot specifike për tre skenarët e zbatimit ............................................103

Figura 28 Alternativat për menaxhimin e mbetjeve nga një shesh ndërtimi dhe prishjeje .............................................................................................109

Figura 29 Organizimi i depozitimit të mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet sipas VKM nr. 575..........................................................................................110

Figura 30 Proceset për përdorimin ose depozitimin e llumit të kanalizimeve...........112

Figura 31 Menaxhimi i MEE ....................................................................................118

Figura 32 Sistemi për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e PRMM në përputhje me draft amendimin e Ligjit nr. 10463.....................................123

## SHKURTIME

| | |
|---|---|
| AKM | Agjencia Kombëtare e Mjedisit |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| BE | Bashkimi Europian |
| CHF | Franga zvicerane |
| DLDP | Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor |
| EUR | Euro |
| INPAEL | Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor |
| INSTAT | Instituti Shqiptar i Statistikave |
| IRM | Impiant për rikuperimin e materialeve |
| ITUP | Impiant për trajtimin e ujërave të përdorura |
| IU | INFRASTRUKTUR & UMWELT |
| KE | Komisioni Europian |
| KfW | Banka Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau) |
| LDPM | Lëndë djegëse me prejardhje nga mbetjet |
| MBB | Mbetje bashkiake të biodegradueshme |
| MF | Ministria e Financave |
| MFJ | Mjetet në fund të jetës |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MIM | Menaxhimi i integruar i mbetjeve |
| MIMN | Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta |
| MM | Menaxhimi i mbetjeve |
| MMN | Menaxhimi i mbetjeve të ngurta |
| MNB | Mbetje të ngurta bashkiake |
| MNP | Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet |
| MP | Marrëdhënie me publikun |
| MEE | Mbetje elektrike dhe elektronike |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asociimit |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| NJQV | Njësi e qeverisjes vendore |
| OJQ | Organizatë jo-qeveritare |
| OZM | Operatori i Zonës së Mbetjeve |
| PCB | Bifenil i poliklorinuar |
| PET | Polietilen tereftalat |

| | |
|---|---|
| PPP | Partneritet Publik-Privat |
| PRMM | Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve |
| PSK | Përgjegjësia sociale e kompanisë |
| PVMM | Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve |
| PZP | Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit |
| QKB | Qendra Kombëtare e Biznesit |
| QKR | Qendra Kombëtare e Regjistrimit |
| RTA | Reforma Territoriale Administrative |
| SDC | Agjencia Zvicerane për Zhvillim |
| SECO | Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike |
| SKMIM | Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit |
| SKZHI | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim |
| SHA | Shoqëri aksionere |
| TA | Tretje anaerobike |
| TMB | Trajtim mekanik-biologjik |
| TVSH | Taksë mbi vlerën e shtuar |
| UNDP/ UNEP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNESCO | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën |
| UTM | Sistemi i koordinatave Universal Transverse Mercator |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VSM | Vlerësim Strategjik Mjedisor |
| ZMM | Zona e Menaxhimit të Mbetjeve |

## KURSI I KËMBIMIT PËR KONVERTIMIN E MONEDHAVE

Në raport për konvertimet nga Euro në Lekë është përdorur kursi i këmbimit
1 EUR = 122 Lekë.

# 0 Përmbledhje ekzekutive

## Informacion i përgjithshëm

Pesë bashkitë e Qarkut Berat janë duke zbatuar një Projekt për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIMN) të financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) me një kontribut grant prej 2.2 milion franga zvicerance. Zbatimi i projektit po mbështetet nga INFRASTRUKTUR & UMWELT, në partneritet me FLAG dhe SEHLHOFF.

Projekti mbështet zbatimin e rregulloreve shqiptare për mbetjet (përkatësisht përputhshmërinë me direktivat e BE për menaxhimin e mbetjeve) në bashkitë e Qarkut Berat. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur një Plan Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve (PRMM), si një element i rëndësishëm për të udhëhequr zhvillimin e ardhshëm të menaxhimit të mbetjeve.

Shtrirja kohore që mbulohet është në përputhje me periudhën e zbatimit të draft Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit (SKMIM), versionin e korrikut 2019, përkatësisht nga viti 2019 deri në 2033 të ndarë në tre faza:

Faza I Afatshkurtër: 2019 - 2023

Faza II Afatmesme: 2023 - 2028

Faza III Afatgjatë: 2028 - 2033

PRMM paraqet kornizën e politikave për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të gjeneruara brenda territorit të planifikuar. Në këtë plan përfshihet rryma e plotë e mbetjeve bashkiake, si edhe e mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet. Në përputhje me dispozitën e Direktivës Kuadër për Mbetjet, ambalazhet dhe mbetjet e tyre ashtu si edhe mbetjet bashkiake të biodegradueshme (MBB) janë trajtuar në kapituj specifikë.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është kryer njëkohësisht me procesin e hartimit të PRMM.

## Zona e Projektit

Ky plan mbulon një territor nën juridiksionin e Qarkut Berat, të përcaktuar si Zona e Mbetjeve Berat në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake (të quajtur më poshtë: Master Plani), i cili është tashmë në fazë miratimi. Territori përbëhet nga pesë

bashki: Bashkia Berat, Bashkia Kuçovë, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Poliçan dhe Bashkia Skrapar.

### Popullsia dhe sasitë e mbetjeve

Aktualisht në asnjë prej bashkive të qarkut Berat, nuk ka një sistem monitorimi për sasitë e grumbulluara të mbetjeve. Rrjedhimisht, sasitë e mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara vetëm mund të përllogariten në bazë të disa parametrave të caktuar, si norma specifike e prodhimit të mbetjeve, numri dhe përmasat e një turi grumbullimi, etj. Në Master Plan është përgatitur një përllogaritje e sasisë së mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara për të gjitha bashkitë në Shqipëri, përfshi ato të Qarkut të Beratit (Zona e Mbetjeve). Gjatë fazës fillestare të Projektit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit, nëpërmjet një pyetësori janë mbledhur nga bashkitë të dhënat për situatën aktuale dhe përllogaritja është përshtatur disi bazuar në mbulimin me shërbim grumbullimi. Për të qenë konform me të dhënat e planifikimit kombëtar, shifrat e përshtatura nga Master Plani kanë shërbyer si bazë për planifikim të mëtejshëm dhe për llogaritjet e kryera në këtë plan.

Popullsia dhe sasitë e mbetjeve tregohen në tabelën e mëposhtme.

| Prodhimi dhe grumbullimi i mbetjeve bashkiake në Qarkun Berat (2018) | | | |
|---|---|---|---|
| **Bashkia** | **Popullsia** | **Prodhimi i mbetjeve [t/vit]** | **Grumbullimi i mbetjeve [t/vit]** |
| Berat | 68,090 | 21,090 | 18,311 |
| Kuçovë | 36,557 | 9,154 | 7,676 |
| Poliçan | 12,306 | 2,062 | 1,482 |
| Skrapar | 13,275 | 2,477 | 1,332 |
| Ura Vajgurore | 29,401 | 4,719 | 3,774 |
| **Qarku Berat** | **159,629** | **39,503** | **32,574** |

Drafti i PRMM nga viti 2014 ka përdorur të dhënat nga një studim i kryer në kuadër të projektit INPAEL të mbështetur nga BE në 2009 për të përllogaritur përbërjen e mbetjeve në Qarkun Berat. Rezultatet paraqiten në figurën e mëposhtme. Pothuajse gjysma e sasisë së mbetjeve përbëhet nga mbetjet organike, e cila pasqyron një situatë të ngjashme të nivelit mesatar kombëtar.




## Sfidat kryesore lidhur me shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat

Aktualisht, aktivitetet kryesore që lidhen me MMN në Qarkun Berat konsistojnë vetëm në grumbullimin, transportin dhe depozitimin pothuajse të pakontrolluar të mbetjeve dhe ka shumë pak aktivitete ricikluese të ndërmarra nga sektori privat dhe informal. Planifikimi për menaxhimin e mbetjeve është në përgjithësi i papërshtatshëm për të përmbushur kërkesat dhe sfidat ekzistuese; monitorimi i performancës dhe kostos mund të përmirësohet ndjeshëm.

Pas reformës territoriale administrative në 2015, bashkitë janë përballur me sfida për të zgjeruar shërbimin bazë të MMN, në veçanti me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në zonat rurale malore të qarkut. Problemet e hasura janë për shkak të terrenit të vështirë, gjendjes së keqe të rrugëve që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin dhe me zonën urbane, si edhe shifrat e ulëta të popullsisë që jeton në vendbanime të shpërndara në zonat malore, çka rezulton në kosto specifike të MMN më të larta.

Përveç kësaj, praktikat aktuale të depozitimit të mbetjeve paraqesin risqe të larta mjedisore pasi dy vendgrumbullimet bashkiake më të mëdha të rajonit ndodhen në brigjet e lumit dhe asnjë nga vendgrumbullimet nuk funksionon sipas standardeve të përcaktuara në legjislacion. Në këtë drejtim, bashkitë janë penalizuar nga MTM me anë të gjobave për mungesën e rehabilitimit dhe mosfunksionimin e duhur të vendgrumbullimeve. Nga ana tjetër, bashkive u mungojnë kapacitetet financiare dhe teknike për të përmbushur

standardet e përcaktuara në VKM 389/2018 për standardet e rehabilitimit dhe funksionimit të vend depozitimeve.

## Objektivat dhe synimet për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve

Në përputhje me planifikimin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, objektivi kyç për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Berat shprehet si më poshtë:

**Minimizimi i efekteve negative të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis**

Në këtë aspekt, menaxhimi i mbetjeve do të kryhet pa vënë në rrezik shëndetin e njerëzve dhe pa dëmtuar mjedisin, në veçanti:

a) Pa rrezikuar ujin, ajrin, tokën, bimët ose kafshët;

b) Pa shkaktuar prishje të qetësisë publike me anë të zhurmave dhe aromave të rënda; dhe

c) Pa ndikuar negativisht peizazhin jashtë qendrave të banuara ose në vendet me interes të veçantë.

Tabela e mëposhtme përmbledh treguesit e synuar të draft Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit (SKMIM, korrik 2019) të cilat janë marrë për bazë për përgatitjen e PRMM në periudhat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

| **Synimet e draft SKMIM (korrik 2019) të marra në konsideratë për përgatitjen e PRMM** | | | |
|---|---|---|---|
| **Objektivat** | **Afatshkurtër 2019-2023** | **Afatmesëm 2023-2028** | **Afatgjatë 2028-2033** |
| **Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke zbatuar parimet kryesore dhe kërkesat ligjore për planifikimin** | | | |
| Matja e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve, sistemet e menaxhimit dhe raportimit | ✓ | ✓ | ✓ |
| Studim Fizibiliteti për ZMM Berat | ✓ | | |
| Planet Bashkiake për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të hartuara dhe në zbatim[1] | ✓ | ✓ (përditësim) | ✓ (përditësim) |
| Mbulim me shërbim (i popullsisë) | 80% | 90% | 95% |

[1] Këto synime janë marrë nga synimet e përcaktuara në draft SKMIM, por janë konvertuar në nivelin rajonal dhe janë përshtatur me situatën e Qarkut Berat.

| Synimet e draft SKMIM (korrik 2019) të marra në konsideratë për përgatitjen e PRMM | | | |
|---|---|---|---|
| **Objektivat** | **Afatshkurtër 2019-2023** | **Afatmesëm 2023-2028** | **Afatgjatë 2028-2033** |
| Norma e grumbullimit (e mbetjeve të prodhuara) | 70% | 90% | 95% |
| Mbulimi me shërbim MIMN[2] (total)<br>(në zonat urbane >100,000 banorë) | 20%<br>10% | 25%<br>20% | 30%<br>30% |
| % e sasisë së mbetjeve (për secilën rrymë) që shkon për riciklim/ totalit të sasisë së mbetjeve të prodhuara | 20% | 30% | 49% |
| Sasia e mbetjeve të biodegradueshme të reduktuara (të dhëna nga 2016) | deri në 75% | deri në 55% | deri në 35% |
| % e sasisë së mbetjeve të depozituara në vend depozitim ose vendgrumbullime / totalit të sasisë së mbetjeve të grumbulluara | 75% | 55% | 35% |
| Objekte për grumbullimin e diferencuar të MNP[1] | 1 | 3 | 5 |
| Sistemi (rajonal) i trajtimit & depozitimit të mbetjeve në përputhje me hierarkinë e mbetjeve[1] | ✓ | | |
| Rehabilitimi dhe mbyllja e vendgrumbullimeve[1] | 3 | 12 | 23 |
| Fondi vjetor për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve i alokuar në buxhetin bashkiak për MMN | >5% | | |
| % e mbetjeve inerte që grumbullohen dhe ripërdoren | 30% | 50% | 80% |
| Qendrat e pritjes për materialet e riciklueshme dhe të ripërdorshme | 5 | | |
| **Qëllimi strategjik 2: Përmirësimi dhe harmonizmi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve** | | | |
| Rregulloret e MIM janë vënë në zbatim në nivel bashkiak | ✓ | | |
| **Qëllimi strategjik 3: Financimi i qendrueshëm i menaxhimit të mbetjeve** | | | |
| Përllogaritja e kostos së plotë të shërbimit dhe tarifës së plotë të shërbimit | ✓ | | |
| Ngarkimi i kostos së plotë të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve | ✓ | ✓ | ✓ |
| Përcaktimi i sistemit të tarifave nga ana e bashkive | | ✓ | |
| Buxheti bashkiak i alokuar/ nevojës për fonde | 80% | 90% | 95% |
| Të ardhurat nga mbledhja e tarifave/ gjithsej kostove të shërbimit | 80% | 90% | 100% |
| Tarifat e mbledhura / shumës së faturuar | 80% | 90% | 100% |

[2] Menaxhimi i integruar i mbetjeve përkufizohet në draft amendimin (Korrik 2019) e Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 si grumbullimi, transporti, rikuperimi (përfshirë ndarjen) dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikqëyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

| Synimet e draft SKMIM (korrik 2019) të marra në konsideratë për përgatitjen e PRMM | | | |
|---|---|---|---|
| **Objektivat** | **Afatshkurtër 2019-2023** | **Afatmesëm 2023-2028** | **Afatgjatë 2028-2033** |
| Mbulimi i kostos për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve në qendrat e trajtimit & depozitimit përfundimtar nga ana e bashkive | 30% | 50% | 80%/100% |
| **Qëllimi strategjik 4: Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut në menaxhimin e mbetjeve** | | | |
| Njësia për mjedisin (MMN) me numër stafi 3 persona në secilën bashki | ✓ | | |
| Trajnimi i stafit bashkiak të njësisë për MMN | ✓ | ✓ | ✓ |
| Planet e hartuara me anë të proceseve me pjesëmarrje | 100% | 100% | 100% |
| % numrit të banorëve që ndajnë mbetjet në burim / % popullsisë që mbulohet me shërbimin e grumbullimit të diferencuar | 30% | 50% | 80% |
| Bashkitë ndërmarrin çdo vit fushata pastrimi | 5 | 5 | 5 |
| Në shkolla zbatohen kurrikula edukative për mbetjet | 100% | 100% | 100% |
| Në shkolla zbatohet grumbullimi i diferencuar i mbetjeve | 50% | 70% | 95% |
| **Qëllimi strategjik 5: Janë përgatitur instrumentet ligjore, institucionale dhe financiare për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme** | | | |
| Bashkitë raportojnë rrymat e mbetjeve të rrezikshme | | >70% | |
| % e mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet që devijohen nga depozitimi | >30% | >50% | >70% |
| Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektronike që grumbullohen veçmas nga familjet | | | >4kg/pers/vit |

## Teknologjitë dhe metodat e parapëlqyera

Në fazën e parë të PRMM duhet t’i jepet përparësi higjienës bazë për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për popullatën. Për këtë arsye, prioriteti më i lartë i takon grumbullimit dhe depozitimit të sigurt të mbetjeve, i ndjekur nga përmirësimi i riciklimit dhe kompostimit dhe në fund realizimi i impianteve komplekse të trajtimit. Pra, gjatë Fazës I në fokus të ndërhyrjes do të jenë këto fusha:

1. Përmirësimi i depozitimit të mbetjeve, përfshirë:
   - Zbatimin e planeve të përmirësimit për vend depozitimet në bashkitë Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore (masat afatshkurtra)
   - Ngritjen e strukturës operative të nevojshme për të drejtuar objektet rajonale të menaxhimit të mbetjeve;

- Ngritjen e skemave të financimit për të siguruar funksionimin e qendrueshëm dhe mirëmbajtjen e masave të investimit të zbatuara
- Ndërtimin e një vend depozitimi sanitar rajonal

2. Zhvillimi i një sistemi optimal për grumbullimin e mbetjeve, përfshirë:
   - Zgjerimin e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale dhe ato malore
   - Ngritjen e sistemeve të monitorimit financiar dhe të performancës
   - Rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve për t'i larguar mbetjet në mënyrë të përgjegjshme
3. Angazhimi i bashkive për riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve, përfshirë
   - Identifikimin dhe testimin e qasjeve më premtuese për grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme dhe trajtimin e mbetjeve organike
   - Krijimin e aleancave me sektorin privat dhe sektorin informal për riciklimin
   - Realizimin e impianteve të kompostimit për mbetjet e gjelbra
   - Realizimin e impianteve të ndarjes dhe trajtimit të mbetjeve në bashkëpunim me sektorin privat dhe atë informal
   - Zgjerimin e sistemeve të riciklimit dhe trajtimit bazuar në përvojën e projekteve pilot
4. Zhvillimi i një sistemi optimal për transferimin dhe transportin e mbetjeve
   - Ngritja e stacioneve të transferimit për të siguruar transportin e mbetjeve me efiçencë kostoje drejt objekteve rajonale

Faza II do të fokusohet në realizimin e një impianti rajonal për trajtimin e mbetjeve që do të zbatohet deri në 2028.

Përveç kësaj, bazuar në rezultatet/ eksperiencën e fazave të mëparshme do të forcohen më tej aktivitetet e rikuperimit të mbetjeve (skemat e grumbullimit të diferencuar, riciklimi, kompostimi). Ndërhyrjet kryesore gjatë të tria Fazave përmblidhen në figurën e mëposhtme.




## Organizimi institucional për menaxhimin rajonal të mbetjeve

Aktualisht të gjitha shërbimet e menaxhimit të mbetjeve ofrohen nga bashkitë e veçanta, përkatësisht kompanitë private në emër të bashkive. Sidoqoftë, disa elementë të një sistemi të integruar për menaxhimin e mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë për të funksionuar me efiçencë kostoje. Bashkëpunimi ndërbashkiak është parashikuar për elementët e mëposhtëm të sistemit të menaxhimit të mbetjeve:

- Vend depozitimi rajonal
- Stacionet e transferimit dhe transporti në distancë të largët (pas transferimit)
- Impiante komplekse për trajtimin e mbetjeve

Teksa nëpër bashki duhet të forcohen kapacitetet institucionale për planifikimin dhe zbatimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, strukturat organizative për shërbimet rajonale duhet të ngrihen nga zeroja. Duke marrë parasysh legjislacionin kornizë të zbatueshëm, alternativat më të përshtatshme të organizimit institucional duhet të shtjellohen bazuar në dy skenare:

*Alternativa 1:* Një ent brenda një bashkie

Bazuar në pranimin e përbashkët të të pesta bashkive, funksionet rajonale për MMN i delegohen një bashkie të vetme, psh. bashkisë pritëse të objektit të vend depozitimit rajonal. Kjo bashki i menaxhon shërbimet nëpërmjet ngritjes së një Enti të veçantë brenda organizimit të vet.

*Alternativa 2: Shoqëri tregtare (Shoqëri aksionere)*

Ngrihet një strukturë e veçantë si person juridik, bazuar në kornizën ligjore të shoqërive tregtare, e cila lejon pjesëmarrjen e pesë bashkive përfituese si edhe të aktorëve të tjerë (psh. të sektorit privat).

Alternativat e ndryshme të menaxhimit të objekteve rajonale për MMN në Qarkun Berat janë prezantuar dhe diskutuar gjatë një sërë seminaresh dhe udhëtimesh studimore me Ekipin e Kompetencave të projektit. Duke ditur se vendimet lidhur me organizimin institucional të parapëlqyer duhet të ndjekin procedurat e përcaktuara nga ligji, ka patur një preferencë të përgjithshme nga të gjitha bashkitë për të krijuar një shoqëri aksionere.

### Kostot dhe mbulimi i tyre

Kostot e përllogaritura të investimit fillestar paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme. Pa trajtimin kompleks të mbetjeve (i cili është planifikuar për një fazë të mëvonëshme) investimi fillestar shkon në total deri në rreth 9 milion EUR (1,098 milion Lekë).

| Përmbledhje e investimeve fillestare (pa taksat dhe konsulencën) | | |
|---|---|---|
| **Komponenti MMN** | **Gjithsej investimet fillestare të nevojshme (Përllogaritje)** | |
| Fshirja e rrugëve dhe grumbullimi I mbetjeve | 300,000 EUR | 36,600,000 Lekë |
| | Përfshin vetëm kostot për kontenierë për të gjitha bashkitë si edhe mjete për bashkinë Skrapar. Në bashkitë Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore presupozohet që investimet për mjetet e grumbullimit do t'i kryejë sektori privat | |
| Transferimi dhe transporti | 500,000 EUR | 61,000,000 Lekë |
| Vend depozitimi i ri rajonal | 4,500,000 EUR | 549,000,000 Lekë |
| Përmirësimi i vendgrumbullimeve në bashkitë Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore | 1,500,000 EUR | 183,000,000 Lekë |
| Ndërtimi i një argjinature në vend depozitimin e bashkisë Berat | 1,000,000 EUR | 122,000,000 Lekë |
| Mbyllja dhe rehabilitimi i vendgrumbullimeve (pas ndërtimit të një vend depozitimi rajonal) | 1,000,000 EUR | 122,000,000 Lekë |
| Impiante të vogla për kompostimin e mbetjeve të gjelbra nëpër bashki | 200,000 EUR | 24,400,000 Lekë |
| Impiante të volga për ndarjen, ruajtjen dhe trajtimin e materialeve të riciklueshme nëpër bashki | Supozohet që impiante të thjeshta për ndarjen e mbetjeve do të ndërtohen dhe menaxhohen nga sektori privat. | |
| Trajtimi kompleks i mbetjeve | Kosto investimi dhe financimi që duhet të sqarohen gjatë Fazës II | |
| **Grand Total (Faza I)** | **9,000,000 EUR** | **1,098,000,000 Lekë** |

Kostot për tre sistemet e MMN të mëposhtme sipas këtij PRMM janë përllogaritur me afërsi duke përdorur vlera reference:

- Koncepti bazë: zhvillimi i shërbimeve bazë të MMN përfshi vend depozitime të kontrolluara, masat e para për riciklimin dhe kompostimin
- Menaxhimi i Integruar Rajonal i Mbetjeve të Ngurta (MIMN): vend depozitim sanitar rajonal dhe sisteme gjithëpërfshirëse për riciklimin dhe kompostimin

- MIMN Rajonal me Trajtimin Mekanik-Biologjik (TMB): vend depozitim sanitar rajonal dhe impiant kompleks për trajtimin e mbetjeve.

Kostot llogariten si kosto sistemi (përfshi të gjithë elementët e shërbimeve MMN) për të gjithë qarkun, duke mos bërë dallime mes bashkive të ndryshme dhe shërbimeve të ofruara nga enti i ardhshëm rajonal për menaxhimin e mbetjeve.

Përllogaritja e kostove bazohet në tekonologjitë dhe metodat e planifikuara si edhe në parashikimin e sasisë së mbetjeve të grumbulluara. Kostot e shërbimit pritet të rriten nga 1.2 milion EUR në vit (149.7 milion Lekë/vit) për Konceptin Bazë, deri në 1.8 milion EUR në vit (214.3 milion Lekë/vit) pas vënies në punë të një vend depozitimi rajonal dhe 3 milion EUR në vit (366.8 milion Lekë/vit) pas vënies në punë të impiantit kompleks për trajtimin e mbetjeve. Për të krahasuar kostot specifike vjetore të të tre skenareve, këto kosto janë ndarë sipas sasisë së përllogaritur të mbetjeve të grumbulluara në vitin përkatës. Kostot specifike të përllogaritura paraqiten në diagramën e mëposhtme.

**Përllogaritje e kostove specifike për tre skenaret e zbatimit**




Është e dukshme që kostot specifike të sistemit MIMN (54 EUR/t ose 6,579 Lekë/t) pritet të jenë më të larta sesa kostot e konceptit bazë (38 EUR/t ose 4,610 Lekë/t). Arsyeja kryesore për rritjen e kostos është ndryshimi i mënyrës së depozitimit të mbetjeve nga një vend depozitim i kontrolluar në vend depozitim sanitar, si edhe zbatimi i transferimit dhe transportit të mbetjeve deri në vend depozitimin rajonal. Kosto shumë më të larta përllogariten për zbatimin e një sistemi MIMN me TMB (95 EUR/t ose 11,531 Lekë/t) për shkak të ndërtimit dhe funksionimit të një impianti TMB.

Për të vlerësuar ndikimin e këtij zhvillimi të kostos në tarifat për familjet, supozohet që financimi për sistemin e ardhshëm MIMN do të mbulohet tërësisht nëpërmjet tarifave. Gjithashtu supozohet që 60% e kostove do të mbulohen nga tarifat e familjeve dhe 40% nga tarifat e bizneseve (dhe institucioneve). Bazuar në këto supozime, është bërë llogaritja e këtyre tarifave që mbulojnë kostot, për të tre skenaret, sipas nivelit të arkëtimit të tarifave prej 90%, 70% dhe 50%.

| Tarifa e llogaritur për mbulimin e kostove për familje sipas tre skenarëve të zbatimit | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Niveli i arkëtimit të tarifave | Koncepti bazë me vend depozitime të kontrolluara | | MIMN me vend depozitim rajonal | | MIMN rajonal me TMB | |
| | EUR/familje/ muaj | Lekë/familje/ muaj | EUR/familje/ muaj | Lekë /familje/ muaj | EUR/familje / muaj | Lekë /familje/ muaj |
| 90% | 1.7 | 205 | 2.5 | 311 | 4.7 | 577 |
| 70% | 2.2 | 263 | 3.3 | 399 | 6.1 | 742 |
| 50% | 3.0 | 369 | 4.6 | 559 | 8.5 | 1,039 |

Kufiri i tarifës së përballueshme të MMN përllogaritet të jetë mesatarisht 699 Lekë/familje/muaj (bazuar në 1% të shpenzimeve aktuale për familje). Në këtë drejtim, tarifat e llogaritura për të mbuluar kostot për konceptin bazë dhe sistemin e MIMN me vend depozitim rajonal janë brenda kufirit të përballueshëm për të gjithë skenaret e nivelit të arkëtimit të tarifave. Po ashtu, sistemi rajonal MIMN me TMB, bazuar në të ardhurat aktuale për familje, do të ishte i përballueshëm nëse arkëtimi i tarifave bëhet në nivelin 90% ose më shumë. Për këtë arsye, gjatë planifikimit të impiantit kompleks për trajtimin e mbetjeve, duhet të rivlerësohet përballueshmëria financiare për alternativën e preferuar të trajtimit bazuar në situatën e të ardhurave në kohën përkatëse.

Tarifat në tabelën më sipër janë tarifat mesatare të llogaritura duke marrë parasysh numrin total të familjeve në rajon. Për të përcaktuar tarifat për secilën bashki dhe strukturë vendbanimi; zonat urbane, gjysëm-urbane dhe rurale, kostot dhe tarifat duhet të llogariten në bazë të kushteve lokale dhe normave specifike të gjenerimit të mbetjeve në secilën bashki dhe njësi administrative.

## Monitorimi dhe rishikimi i PRMM

PRMM do të rishikohet dhe, nëse është e nevojshme, të përditësohet të paktën çdo gjashtë vjet. Treguesit për monitorimin e zbatimit të planit janë në përputhje me treguesit e draft SKMIM (Korrik 2019). Performanca e PRMM do të monitorohet bazuar në synimet e planit. Në këtë mënyrë, mund të matet progresi dhe rezultatet e arritura, të merren

vendime bazuar në performancën dhe të përcaktohet dhe vlerësohet se sa i suksesshëm ka qenë plani. Në figurën e mëposhtme paraqitet sistemi për monitorimin dhe raportimin.

**Ndërhyrjet kryesore për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat**




## Plan Veprimi

Aktivitetet, përgjegjësitë dhe afatet kohore janë përmbledhur në planin e veprimit më poshtë. Për të gjitha aktivitetet janë trajtuar përgjegjësitë kryesore.

## Plani i Veprimit të PRMM të Qarkut Berat (Faqe 1/3)

Faza I · Faza II · Faza III

2019 · 2020 · 2021 · 2022 · 2023 · 2024 · 2025 · 2026 · 2027 · 2028 · 2029 · 2030 · 2031 · 2032 · 2033 (T1 T2 T3 T4 for each year)

| Nr. | Masat | Përgjegjësi a kryesore |
|---|---|---|
| **1** | **Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)** | |
| 1.1 | Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve | B |
| a) | Shtrirja e shërbimeve të grumbullimit në zonat rurale dhe malore | B |
| b) | Ngritja e sistemeve të monitorimit financiar dhe të performancës | B |
| ### | Grumbullimi i diferencuar materialeve të riciklueshme dhe mbetjeve organike | B |
| a) | Projekte pilot për grumbullimin e diferencuar | B |
| a1) | Projekte pilot për grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme të thata | B |
| a2) | Projekte pilot për grumbullimin e diferencuar dhe kompostimin e mbetjeve të gjelbra | B |
| b) | Shtrirja e grumbullimit të diferencuar në shkallë të gjerë | B |
| **2** | **Transporti dhe transferimi i mbetjeve** | |
| 2.1 | Projektimi konceptual i transportimit dhe transferimit | Q/B |
| 2.2 | Zbatimi i stacioneve të transferimit (projekt i detajuar, tenderimi, ndërtimi, vënia në punë) | NR |
| 2.3 | Funksionimi i stacioneve të transferimit si pjesë e sistemit rajonal të MIMN | NR |
| **3** | **Trajtimi i mbetjeve** | |
| 3.1 | Zbatimi i projekteve pilot për kompostimin kolektiv dhe në shtëpi të mbetjeve të gjelbra | B |
| 3.2 | Shtrirja e aktiviteteve të kompostimit | B |
| 3.3 | Projekt pilot për ndarjen e mbetjeve (Bashkia Kuçovë) | Kucova |
| 3.4 | Zbatimi i një impianti për Trajtim Mekanik Biologjik (TMB) | NR/B |
| a) | Planifikimi dhe ndërtimi i TMB | NR/B |
| b) | Funksionimi i MBT | NR/B |
| **4** | **Depozitimi i mbetjeve** | |
| 4.1 | Masa imediate për përmirësimin e vendgrumbullimeve bashkiake të bashkive Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore | B/MTM |
| 4.2 | Zbatimi i një vend depozitimi sanitar rajonal | B/NR |
| a) | Përzgjedhja e vendit dhe projektimi konceptual i vend depozitimit rajonal | B |
| b) | Zbatimi i një vend depozitimi sanitar rajonal (projekti i detajuar, tenderimi, ndërtimi dhe vënia në punë) | B/NR |
| c) | Funksionimi i vend depozitimit rajonal | NR |
| 4.3 | Rehabilitimi i vendgrumbullimeve të tjera të identifikuara në Raportin për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime të DLDP | B |

(B – Bashkitë, Q – Qarku Berat, NR – Ndërmarrja rajonale MM, M – Prodhuesit e mbetjeve, ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, MTM – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MASR – Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë)

## Plani i Veprimit të PRMM të Qarkut Berat (Faqe 2/3)

| Nr. | Masat | Përgjegjësi a kryesore |
|---|---|---|
| **5** | **Zhvillimi institucional** | |
| 5.1 | Ngritja e një njësie mjedisore (MMN) me një staf prej 3 personash në secilën bashki | B |
| 5.2 | Trajnim për stafin e bashkisë për MMN | ASPA/B |
| 5.3 | Ngritja e një ndërmarrjeje publike rajonale për menaxhimin e mbetjeve | B |
| a) | Dakordësia mbi strukturën organizative për menaxhimin rajonal të mbetjeve | B |
| b) | Krijimi i një enti për menaxhimin rajonal të mbetjeve | B |
| 5.4 | Krijimi i kapaciteteve në ndërmarrjen publike rajonale për drejtimin e vend depozitimit rajonal | NR |
| 5.5 | Transferimi i detyrave shtesë tek ndërmarrja rajonale | Q/B |
| **6** | **Planifikimi Vendor dhe Rajonal (Zonal) i Menaxhimit të Mbetjeve** | |
| 6.1 | Përgatitja dhe vënia në zbatim e Planeve Bashkiake për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve nga këshillat bashkiakë | B |
| 6.2 | Përgatitja dhe vënia në zbatim e Planit Rajonal (Zonal) të Menaxhimit të Mbetjeve | Q/B |
| 6.3 | Përgatitja e studimit të fizibilitetit për Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve Berat | Q/B |
| 6.4 | Vënia në zbatim e rregulloreve për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel bashkiak | B |
| **7** | **Financimi i shërbimeve MMN** | |
| 7.1 | Llogaritja e kostos së plotë të shërbimit dhe nevoja të tjera financiare | B |
| 7.2 | Llogaritja dhe caktimi i tarifës për mbulimin e plotë të shërbimit nga bashkitë | B |
| 7.3 | Rritje e fondeve të alokuara për shërbimet MMN në buxhetin bashkiak përfshi masat për rehabilitimin e vendgrumbullimeve | B |
| 7.4 | Krijimi i skemës së financimit për menaxhimin rajonal të mbetjeve | B |
| **8** | **Ndërgjegjësimi publik, pjesëmarrja e publikut dhe parandalimi i mbetjeve** | |
| 8.1 | Pjesëmarrja e aktorëve kryesorë vendorë në planifikimin vendor dhe rajonal të menaxhimit të mbetjeve | Q/B |
| 8.2 | Ndarja e përgjegjësive për ndërgjegjësimin publik dhe komunikimin në bashki | B |
| 8.3 | Ndarja e përgjegjësive për ndërgjegjësimin publik dhe komunikimin në ndërmarrjen rajonale | NR |
| 8.4 | Përgatitja dhe zbatimi I planit vjetor të veprimit për ndërgjegjësimin publik dhe komunikimin | B/NR |
| 8.5 | Fushata për ndërgjegjësimin publik rreth MIMN përfshi fushata vjetore pastrimi | B/NR |
| 8.6 | Zbatimi i kurrikulave arsimore dhe grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në shkolla | MASR/B |




(B – Bashkitë, Q – Qarku Berat, NR – Ndërmarrja rajonale MM, M – Prodhuesit e mbetjeve, ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, MTM – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MASR – Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë)

## Plani i Veprimit të PRMM të Qarkut Berat (Faqe 3/3)

| Nr. | Masat | Përgjegjësi a kryesore |
|---|---|---|
| **9** | **Menaxhimi i mbetjeve nga ndërtimet** | |
| 9.1 | Përcaktimi i vendeve për ndërtimin e vend depozitimeve për mbetjet inerte | B |
| 9.2 | Ngritja e impianteve (të trajtimit) për MNP të grumbulluara veçmas | B |
| 9.4 | Monitorimi i zbatimit të rregulloreve ekzistuese sa i përket grumbullimit të diferencuar, transportimit dhe depozitimit të MNP | B |
| **10** | **Menaxhimi i rrymave të tjera të mbetjeve** | |
| 10.1 | Ngritja e qendrave pritëse për materialet e ripërdorshme dhe të ricikluеshme | B |
| 10.2 | Raportimi vjetor i të dhënave për mbetjet, përfshi mbetjet e rrezikshme | M |
| 10.3 | Bashkëpunimi midis skemave grumbulluese të PZP dhe bashkive | M/B |
| **11** | **Monitorimi, raportimi dhe rishikimi** | |
| 11.1 | Monitorimi i performancës së zbatimit të PRMM | B/NR |
| 11.2 | Raportimi vjetor rreth zbatimit të planit | B/NR |
| 11.3 | Rishikimi i PRMM (të paktën në vitin e 6-të prej fillimit të tij) | B/NR |

Timeline: Faza I (2019–2022), Faza II (2023–2027), Faza III (2028–2033); each year divided into T1, T2, T3, T4.

Note on 10.3: Depending on the establishment of EPR schemes at national level

Q - Qarku Berat
B - Bashkitë
**NR** - Ndërmarrje rajonale publike për MMN
**ASPA** - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
PZP - Aktorë përgjegjës sipas rregullave për PZP
M - Prodhuesit e mbetjeve
**MTM** - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
**MASR** - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## 1 Informacion i përgjithshëm

Pesë bashkitë e Qarkut Berat janë duke zbatuar një Projekt për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (MIMN) të financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) me një kontribut grant prej 2.2 milion franga zvicerance. Zbatimi i projektit po mbështetet nga INFRASTRUKTUR & UMWELT, në partneritet me FLAG dhe SEHLHOFF.

Projekti mbështet zbatimin e rregulloreve shqiptare për mbetjet (përkatësisht përputhshmërinë me direktivat e BE për menaxhimin e mbetjeve) në bashkitë e Qarkut Berat. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur një Plan Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve (PRMM), si një element i rëndësishëm për të udhëhequr zhvillimin e ardhshëm të menaxhimit të mbetjeve.

Sipas Nenit 12 të Ligjit Nr. 10463, datë 22/09/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, secila administratë rajonale (Qark) do të përgatisë një plan rajonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve për territorin që ka në juridiksion, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit (SKMIM) dhe me kërkesat e Nenit 10 të ligjit.

Ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” aktualisht është në proces amendimi. Draft amendimi i ligjit (versioni korrik 2019) parashikon ndryshime thelbësore për planifikimin e MM, p.sh sa i përket procedurave për miratimin e planeve zonale të MM dhe planeve vendore MM), synimeve për ripërdorimin dhe riciklimin, detajimit të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, etj.

Bazuar në versionet më të fundit të draft Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit, kufijtë e zonave të ardhshme të mbulimit të bashkëpunimeve ndërbashkiake për menaxhimin e mbetjeve mund të devijojnë nga kufijtë e qarqeve përkatëse. Për këtë arsye, në përputhje me amendimin e draft ligjit për MIM, planet *rajonale* të menaxhimit të mbetjeve do të zëvendësohen nga planet *zonale* të menaxhimit të mbetjeve. Sidoqoftë, në draft Master Planin[3] për menaxhimin e mbetjeve (quajtur më poshtë: Master Plani), bashkitë dhe kufijtë e Zonës së Mbetjeve Berat janë identike me ato të Qarkut Berat. Për rrjedhojë, praktikisht ndryshimi nga plan rajonal në plan zonal nuk ka ndonjë ndikim për Qarkun Berat.

---

3 Master Planit për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake i referohet në draft Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit si dokumenti i cili do të përcaktojë Zonat e Menaxhimit të Mbetjeve.

Në pjesën e parë të planit, përshkruhet gjendja e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat. Pjesa e dytë përshkruan supozimet ku bazohet planifikimi, përcakton objektivat dhe përcakton masat për të arritur këto objektiva. Bazuar në dakordësinë për PRMM hapi i mëtejshëm është përgatitja e një Studimi Fizibiliteti për masat prioritare afatshkurtër investimit që janë identifikuar, si edhe e studimeve që lidhen me të (si Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social, Studime të Veçanta).

## 1.1 Fushëveprimi i Planit

Ky plan mbulon territorin në juridiksionin e Qarkut Berat, të përcaktuar si Zona e Menaxhimit të Mbetjeve Berat në Master Planin për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Bashkiake, i cili është aktualisht në fazë miratimi (shihni kapitullin 1.3.3.2 për më shumë detaje). Territori përbëhet nga pesë bashki: Bashkia Berat, Bashkia Kuçovë, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Poliçan dhe Bashkia Skrapar.

Kohështrirja është në përputhje me periudhën e zbatimit të draft Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit (versioni i Korrik 2019), përkatësisht nga 2019 deri në 2033 e ndarë në tri faza:

Faza I Afatshkurtër: 2019 – 2023

Faza II Afatmesme: 2023-2028

Faza III Afatgjatë: 2028 - 2033

Ky PRMM paraqet kuadrin e politikave për menaxhimin e mbetjeve të ngurta brenda territorit ku bëhet planifikimi. Në këtë plan përfshihet gjithë rryma e mbetjeve të ngurta bashkiake, si edhe mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet. Në përputhje me dispozitën e Direktivës Kuadër për Mbetjet, ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet, si edhe mbetjet bashkiake të biodegradueshme (MBB) janë trajtuar në kapituj të veçantë.

## 1.2 Përmbledhje e sfidave kryesore sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat

Aktualisht, aktivitetet kryesore që lidhen me MMN në Qarkun Berat konsistojnë në grumbullimin, transportin dhe hedhjen e mbetjeve në mënyrë pothuajse të pakontrolluar; vetëm pak aktivitete riciklimi janë ndërmarrë nga sektori privat dhe informal. Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve në përgjithësi nuk është i përshtatshëm për t'iu përgjigjur kërkesave dhe sfidave ekzistuese; performanca dhe monitorimi i kostos mund të përmirësohen ndjeshëm.

Pas reformës territoriale administrative në 2015, bashkitë janë përballur me sfida për shtrirjen e shërbimeve bazë të MMN, në veçanti grumbullimin dhe transportin në zonat rurale malore të rajonit. Problemet e hasura kanë ardhur për shkak të terrenit të vështirë, gjendjes së keqe të rrugëve që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin dhe me zonën urbane, si edhe numri i vogël i popullsisë që jeton në vendbanime të vogla të shpërndara në zonat malore, çka rezulton në kosto specifike MMN më të larta.

Gjithashtu, praktikat aktuale të depozitimit të mbetjeve paraqesin risqe të larta mjedisore meqë dy vendgrumbullimet më të mëdha bashkiake të qarkut ndodhen në brigjet e lumit dhe asnjë nga vendgrumbullimet nuk funksionon sipas standardeve të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, bashkitë janë penalizuar nga MTM me anë të vendosjes së gjobave për mungesën e rehabilitimit dhe mosfunksionimin e duhur të vendgrumbullimeve. Nga ana tjetër, bashkitë kanë mungesa në kapacitetet financiare dhe teknike për të përmbushur standardet e caktuara në VKM 389/2018 për standardet e rehabilitimit dhe funksionimit të vend depozitimeve.

## 1.3 Kuadri rregullator dhe i politikave

### 1.3.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar për mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti ka përparuar nëpërmjet transpozimit të direktivave të BE. Gjatë pak viteve të fundit vendi ka përparuar ndjeshëm në përafrimin ligjor. Kuadri është forcuar dhe bashkërendimi i politikave në nivel qendror është përmirësuar.

Legjislacioni shqiptar me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbetjeve është si më poshtë:

#### Ligjet

Ligjet që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbetjeve janë:

- “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011)
- “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ligji nr. 32, datë 14.02.2013)
- “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Projekt Ligj nr. 92, datë 22.09.2016)
- “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ligji nr. 156, datë 10.10 2013)

- "Për largimin publik të mbeturinave" (Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996)

Ligjet që lidhen me mbrojtjen mjedisore janë:

- "Për mbrojtjen e mjedisit" (Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011)
- "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011)
- "Për lejet e mjedisit" (Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011)
- "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10448 datë 14.7.2011, Për lejet e mjedisit" (Ligji nr. 44, datë 14.02. 2013)

Ligje të tjera që lidhen me këtë fushë:

- "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017)
- "Për vetëqeverisjen vendore" (Ligji nr. 139, datë 17.12.2015)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013, Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" (Ligji nr. 77, datë 16.07.2015)
- "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014, Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (Ligji nr. 73, datë 09.07.2015)
- "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (Ligji nr. 129, datë 02.10.2014)
- "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (Ligji nr. 115, datë 31.07.2014)
- "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (Ligji nr. 107, datë 31.07.2014)
- "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" (Ligji nr. 125, datë 25.04.2013)
- "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" (Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006, Për koncesionet" (Ligji nr. 10157, datë 15.10.2009)
- "Për planifikimin e territorit" (Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009)
- "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008)
- "Për ankandin publik" (Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008)
- "Për një shtesë në Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (Ligji nr. 9797, datë 23.07.2007)

- "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (Ligji nr. 9561, datë 12.06.2006)
- "Për një ndryshim në Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001, Për pronat e paluajtshme" (Ligji nr. 9558, datë 08.06.2006)
- "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001)
- "Për pronat e paluajtshme të shtetit" (Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001)

### Akte nënligjore (kryesisht Vendime të Këshillit të Ministrave, VKM)

Akte nënligjore që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbetjeve:

- "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve" (VKM nr. 319, datë 31.05.2018)
- "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve" (VKM nr. 431, datë 11.7.2018)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave "Për lendfillet"" (VKM nr. 389, datë 27.6.2018)
- "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të vend depozitimeve të mbetjeve" (VKM nr. 428 datë 8.6.2016)
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 641 datë 1.10.2014 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte" (VKM Nr. 94 datë 14.2.2018)
- "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve" (VKM nr. 687, datë 29.07.2015)
- "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" (VKM nr. 575, datë 24.06.2015)
- "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura" (VKM nr. 387, datë 06.05.2015)
- "Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve dhe modelin e autorizimit për kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte" (Urdhër nr. 1957 datë 6.11.2014)

- "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte" (VKM nr. 641, datë 01.10.2014)
- "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre" (VKM nr. 608, datë 17.09.2014)
- "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" (VKM nr. 418, datë 25.06.2014)
- "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" (VKM nr. 371, datë 11.06.2014)
- "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme" (VKM nr. 229, datë 23.04.2014)
- "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 117 datë 13.02.2013 të Këshillit të Ministrave "Për Kriteret që përcaktojnë kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje"" (VKM nr. 52, datë 05.02.2014)
- "Për miratimin e modelit të regjistrave për operatorët që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura" (Urdhër nr. 893 i vitit 2013)
- "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje" (VKM nr. 117, datë 13.02.2013)
- "Për mbetjet elektrike dhe elektronike" (VKM nr. 957, datë 19.12.2012)
- "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre" (VKM nr. 866, datë 04.12.2012)
- "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura" (VKM nr. 765, datë 07.11.2012)
- "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës" (VKM nr. 705, datë 10.10.2012)
- "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 825 datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për përdorim, përpunim dhe riciklim"" (VKM nr. 550, datë 22.08.2012)
- "Për landfill-et e mbetjeve" (VKM nr. 452, datë 11.07.2012)
- "Për incinerimin e mbetjeve" (VKM nr. 178, datë 06.03.2012)
- "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre" (VKM nr. 177, datë 06.03.2012)

- “Për heqjen e mjeteve motorike, të rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare” (Akt normativ nr. 3, datë 07.09.2011)
- “Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane” (VKM nr. 333, datë 26.01.2011)
- “Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve” (VKM nr. 175, datë 19.01.2011)
- “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”” (VKM nr. 798, datë 29.09.2010)
- “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” (VKM nr. 1189, datë 18.11.2009)
- “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” (VKM nr. 99, datë 18.02.2005)

### Udhëzime

- “Për kriteret e studimit të projekteve për mbylljen dhe rindërtimin e vend depozitimeve për mbetjet e ngurta urbane” (Udhëzim nr. 1250, datë 23.02.2009 dhe nr. 406/1, datë 03.03.2009, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta” (Udhëzim nr. 6, datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave)

### Rregullore

- “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre” (Rregullore nr. 1, datë 30.03.2007, e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Rregullore higjieno-sanitare për pastrimin në zonat urbane dhe rurale, për administrimin dhe trajtimin e mbeturinave” (Rregullore nr. 376, datë 17.11.1997, e Ministrisë së Shëndetësisë)

Ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017) futi për herë të parë konceptin e mbulimit të kostove nëpërmjet tarifave. Bazuar në këtë ligj niveli i tarifave

është i orientuar drejt mbulimit të kostove të shërbimeve publike që ofrohen nga NJQV. Qeveritë vendore mund të përcaktojnë tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit ose përfituesit nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të posaçme për të siguruar qasje ndaj tyre, cilësi, sasi dhe kosto të përballueshme nga cilido.

Në Ligjin nr. 125, datë 25.04.2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" ( të ndryshuar me Ligjin nr. 77, datë 16.07.2015), citohet se mund të jepen koncesione dhe partneritete publike-private (PPP) për kryerjen e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve ndër të tjera edhe për menaxhimin e mbetjeve, përfshi mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre (Neni 4ç). Ky amendim tregon se bashkëpunimi midis sektorëve publik dhe privat formon një pjesë të politikës së qeverisë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve.

Ligji nr. 107, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar me Ligjin nr. 73, datë 09.07.2015), përkufizon me infrastrukturë publike tërësinë e rrjeteve, instalimeve dhe ndërtimeve, ekzistuese ose të parashikuara në territor, si edhe hapësirat publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë, administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e kundër zjarrit, si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike ose private. (Neni 3.11)

### 1.3.2 Politikat dhe standardet

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) shpreh ambicjen e Shqipërisë për t'u integruar në BE dhe përcakton objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për qendrueshmërinë mjedisore të vendit. Arritja e këtyre synimeve raportohet nëpërmjet një sërë raportesh vjetore të BE për Shqipërinë. Në raportin për vitin 2018, mbetjet trajtohen në kapitullin 27, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike: Ka pasur një farë arritjeje në përqasjen e politikave dhe legjislacionit, veçanërisht nëpërmjet rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Në raport vijon të citohet se "*nevojiten përpjekje të mëtejshme:*

- *për të mbyllur më shumë se 300 vend depozitime jashtë standardeve,*
- *për të rritur grumbullimin e diferencuar të rrymave të ndryshme të mbetjeve dhe*
- *për të reduktuar mbetjet bio.*"

### 1.3.3 Strategjitë dhe Planet

#### 1.3.3.1 Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit

Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta Bashkiake në Shqipëri udhëhiqet kryesisht nga detyrimet që bazohen në synimet dhe afatet kohore të përcaktuara në direktivat e BE (si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit) si edhe në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Versioni draft i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit është punuar nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Objektivat specifike të strategjisë janë të ofrojë zgjidhje praktike:

- Për të përmbushur detyrimet specifike të legjislacionit të KE për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Për të zbatuar Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) që lidhen me sektorin e mbetjeve.
- Për të trajtuar në mënyrë të bashkërenduar dhe integruar problematikat madhore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat përballet vendi.

Pesë qëllimet strategjike të strategjisë synojnë:

- Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit
- Përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve
- Financimin e qendrueshëm të menaxhimit të mbetjeve
- Burimet njerëzore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjen e popullatës në menaxhimin e mbetjeve
- Të ngrihen instrumente ligjore, institucionale dhe financiare për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme

Draft SKMIM i parashikon sistemet e MIMN në bazë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve:

> "Një Zonë e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM) është një territor që mbulon juridiksionin e një ose më shumë bashkive që kanë një tipologji gjeografike të ngjashme dhe ofron një komunikim të pandërprerë të rrjetit rrugor, gjë e cila

lehtëson grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve drejt destinacioneve për para-trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin përfundimtar."

Standardet minimale dhe aktivitetet prioritare më poshtë që lidhen me rrymën e mbetjeve bashkiake janë të përcaktuara në draft SKMIM:

1. 100% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat urbane (Prioriteti 1)
2. Mbetjet të depozitohen në një vend depozitim të autorizuar dhe të kontrolluar (Prioriteti 1)
3. 90% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale (Prioriteti 2)
4. Ndarja e mbetjeve për të vijuar më tej me riciklimin (Prioriteti 3)

Gjithashtu versioni i përgatitur përcakton synimet për zbatimin e praktikave të përmirësuara të MMN. Synimet që kanë të bëjnë me menaxhimin rajonal dhe vendor të mbetjeve të ngurta janë listuar në kapitullin 3.2.

#### 1.3.3.2 Master Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake

Master Plani për Menaxhimin e Mbetjeve Bashkiake (Master Plani) është një instrument planifikues i nivelit të dytë për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Meqë disa elementë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë në mënyrë që funksionimi të kryhet me efiçencë kostoje dhe shumica e bashkive në Shqipëri janë të vogla për të siguruar funksionimin efiçent të impianteve të mëdha, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive, përkatësisht procesi i ashtuquajtur "rajonalizim" ose ndarja në Zona të Menaxhimit të Mbetjeve. Master Plani përcakton kufijtë paraprakë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe paraqet kuadrin e planifikimit për investime në infrastrukturën e MMN në secilën ZMM. Master Plani është përgatitur në 2018 si një Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri dhe aktualisht është në fazën e miratimit.

Master Plani ka këto objektiva specifikë:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin e MMN,
- të përcaktojë kostot përkatëse dhe nivelet e tarifave në të ardhmen,
- të mundësojë një sistem objektiv, të verifikueshëm dhe transparent për caktimin e prioriteteve për investime në infrastrukturën e MIMN,
- të paraqesë një plan investimesh për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN, të ndarë në faza afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, që të sigurojë

grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin, si dhe impiantet e trajtimit dhe/ose depozitimit të mbetjeve,

- të propozojë ndryshime të nevojshme ligjore dhe institucionale,
- të propozojë masa të tjera shoqëruese.

Master Plani propozon ta ndajë Shqipërinë në 10 Zona të Menaxhimit të Mbetjeve. Njëra prej tyre është Zona e Mbetjeve Berat, e cila përfshin territorin e Qarkut Berat, të përbërë nga Bashkia Berat, Bashkia Kuçovë, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Poliçan dhe Bashkia Skrapar. Master Plani propozon që Zona e Mbetjeve Berat të ketë zgjidhjen e vet rajonale për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve.

#### 1.3.3.3 Planet Rajonale dhe Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve

Procedurat për hartimin dhe miratimin e Planeve Rajonale dhe Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve rregullohen nga Ligji "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011). Këshillat e qeverisjes rajonale dhe vendore miratojnë planet përkatëse rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve. Planet rajonale të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë miratim nga Këshilli i Ministrave, ndërsa planet vendore të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë miratim nga Këshilli i Qarkut. Procedura zbatohet gjithashtu për versionet e rishikuara të planeve. Planet vendore dhe rajonale për menaxhimin e mbetjeve duhet të rishikohen të paktën çdo gjashtë vjet dhe të raportohet çdo vit lidhur me statusin e zbatimit të tyre, përkatësisht në Këshillin e Qarkut për planet vendore dhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për planet rajonale.

Një version draft i amendimit të Ligjit nr. 10463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" është aktualisht në fazë konsultimi. Draft amendimi e zëvendëson planin rajonal të menaxhimit të mbetjeve me planin zonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe rishikon procedurat e miratimit dhe raportimit për planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve. Sipas këtij drafti, planet vendore të menaxhimit të mbetjeve do të hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga këshilli bashkiak dhe gjithashtu nga MTM. Bashkive gjithashtu u kërkohet të raportojnë çdo vit në MTM dhe në MIE.

Përpara reformës territoriale administrative në 2015, Bashkia Berat dhe Bashkia Kuçovë kishin përgatitur Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve (PVMM) që mbulonin vetëm territorin e mëparshëm të bashkive, pra qytetin e Beratit dhe qytetin e Kuçovës, secila me një kohështrirje planifikimi së cilës i ka kaluar afati. Bashkitë e tjera në qark nuk kanë hartuar Plane Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve. Paralelisht me përgatitjen e këtij PRMM, gjithashtu janë duke u përgatitur dhe miratuar Planet Vendore të Menaxhimit të

Mbetjeve për Bashkinë Berat, Bashkinë Kuçovë, Bashkinë Skrapar dhe Bashkinë Ura Vajgurore, me një kohështrirje planifikimi për 4-7 vitet e ardhshme. Tabela e mëposhtme paraqet situatën rreth PVMM.

**Tabela 1 Statusi i Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve (PVMM) të bashkive në Qarkun Berat**

| Bashkia | Statusi i Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Disponueshmëria | Njësitë administrative të mbuluara | Versioni më i fundit | Data e përgatitjes | Kohështrirja e planifikimit |
| Berat | ✓ | njësia administrative Berat | draft i brendshëm | 2012 | 2012-2016 |
| | (✓) | të gjitha njësitë administrative | draft, në fazë konsultimi | 2019 | 2019-2024 |
| Kuçovë | ✓ | njësia administrative Kuçovë | draft i brendshëm | Qershor 2013 | 2013-2017 |
| | ✓ | të gjitha njësitë administrative | miratuar nga Këshilli Bashkiak | 2019 | 2019-2023 |
| Poliçan | - | - | - | | - |
| Skrapar | (✓) | të gjitha njësitë administrative | draft, në fazë konsultimi | 2019 | 2019-2024 |
| Ura Vajgurore | -(✓) | të gjitha njësitë administrative | draft, në fazë konsultimi | 2019 | 2019-2026 |

## 1.4 Objektivat e përcaktuar në dokumentet ligjore dhe të politikave

Një nga objektivat specifike të draft Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është të ofrojë zgjidhje praktike për të përmbushur detyrimet specifike që imponohen nga legjislacioni i KE për menaxhimin e mbetjeve dhe nga ligji kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Sipas Nenit 6 të Direktivës për Mbetjet (2008/98/EC), objektivi i parë i çdo politike për mbetjet duhet të jetë të minimizojë efektet negative të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis. Sipas Nenit 13, do të merren të gjitha masat për të garantuar që menaxhimi i mbetjeve po kryhet pa vënë në rrezik shëndetin e njerëzve, pa dëmtuar mjedisin dhe veçanërisht:

a) pa rrezikuar ujin, ajrin, tokën, bimët ose kafshët;

b) pa shkaktuar prishje të qetësisë publike nëpërmjet zhurmave apo aromave të rënda; dhe

c) pa ndikuar negativisht në peizazhin jashtë qendrave të banuara ose në vendet me interes të veçantë.

Politikat e mbetjeve po ashtu duhet të synojnë reduktimin e përdorimit të burimeve dhe të favorizojnë zbatimin praktik të hierarkisë së mbetjeve. Marrja në konsideratë e hierarkisë së mbetjeve gjatë hartimit të politikave dhe planifikimit është specifikuar në Nenin 6 të Ligjit nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.




**Figura 1 Hierarkia e mbetjeve në përputhje me Direktivën Kuadër të BE**

Gjatë zbatimit të hierarkisë së mbetjeve të paraqitur më sipër, do të merren masa për të nxitur e mbështetur ato alternativa që sjellin rezultatet më të mira mjedisore në tërësi. Kjo mund të kërkojë që rryma specifike të mbetjeve të shkëputen nga hierarkia në rastet kur cikli i jetës është i argumentuar me ndikimet e përgjithshme të prodhimit dhe menaxhimit të këtyre mbetjeve.

Objektiva të tjera kyçe, të cilët parashtrohen në Nenet 20 deri 22 të Ligjit për MIM, janë zbatimi i parimeve të mëposhtme:

- Vetë-mjaftueshmëria: rrjeti i impianteve për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve të përziera bashkiake të grumbulluara nga familjet plotëson të gjitha nevojat.
- Afërsia: rrjeti do të bëjë të mundur që mbetjet të asgjësohen ose të rikuperohen në një nga impiantet e përshtatshme më të afërta, me anë të metodave dhe teknologjive më të përshtatshme, për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

- Ndotësi paguan: kostot e menaxhimit të mbetjeve do të mbulohen nga krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve ose nga zotëruesi aktual i tyre.

Versioni draft i rishikuar i SKMIM (Korrik 2019) përcakton synimet për zbatimin e praktikave të përmirësuara për MMN. Synimet që kanë të bëjnë me menaxhimin rajonal dhe vendor të mbetjeve të ngurta paraqiten në kapitullin 3.2. Figurat e mëposhtme paraqesin një përmbledhje të synimeve, objektivave ligjore dhe të politikave për menaxhimin e mbetjeve të ngurta siç parashikohet në ligjet kombëtare, VKM-të dhe draft Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, si edhe në Direktivat e BE. Ndërsa objektivat dhe synimet e përcaktuara nëpër VKM janë të vjetëruara, synimet në draft SKMIM qëndrojnë brenda afateve kohore aktuale. Bazuar në këshillën e MTM, ky PRMM është hartuar në përputhje me objektivat dhe synimet e përcaktuara në draft SKMIM.



Shërbimi MMN
2018
2023
2028
2033
Grumbullimi i mbetjeve
Mbulimi i popullsisë
80%
90%
95%
Norma e grumbullimit (bazuar në sasinë e mbetjeve)
70%
90%
95%
Grumbullimi i diferencuar
Mbulimi i popullsisë me shërbimin MMN
20% (10% në zonat urbane)
25% (20% në zonat urbane)
30% (30% në zonat urbane)
Mbetje bio
Mbetje tekstile & të rrezikshme
Grumbullimi i diferencuar i letrës, kartonit, metalit, plastikes dhe qelqit
Për të gjitha NJQV
Për bashkitë e kategorisë së 1-rë
Për bashkitë e tjera
Për bashkitë që janë qendra rajonale (të qarkut)
Për bashkitë e tjera
tani
Strategjia Kombetare MIM (Draft 2019)
Direktiva Kuadër e BE për Mbetjet
Ligji 10463/2011 Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
VKM 418/2014 Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve
VKM 608/2014 Për grumbullimin & trajtimin e mbetjeve bio




Përgatitje për ripërdorim, riciklim, reduktim të mbetjeve
2012
2017
2020
2023
2025
2028
2030
2033
2035
Përgatitje për ripërdorim dhe riciklim
50%
55%
60%
65%
Për secilën rrymë mbetjesh
20%
30%
49%
50%
E sasisë së mbetjeve të prodhuara në 2014
Ripërdorim dhe riciklim
Letër dhe karton
60%
Metal
50%
Plastikë
22.5%
Qelq
60%
Sasia e mbetjeve që shkon në vend depozitim
≤10%
Sasia (e reduktuar) e mbetjeve të biodegradueshme që shkon në vend depozitim
50%
35%
E sasisë së prodhuar të mbetjeve të biodegradueshme në 2014
75%
55%
35%
E sasisë së prodhuar të mbetjeve të biodegradueshme në 2010
Sasia në 2016
75%
55%
35%
Sasia e depozituar/ grumbulluar
ton / vit
75%
55%
35%
Ndalimi i përdorimit në treg të qeseve plastike të lehta dhe jo rezistente
tani
Direktiva BE për Mbetjet & Draft (2019) Amendimi i Ligjit 10463/2011
Strategjia Kombëtare MIM (Draft 2019)
VKM 418/2014 Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve
Direktiva BE për Vend depozitimet
VKM 608/2014 Për grumbullimin & trajtimin e mbetjeve bio
VKM 452/2012 Për lendfillet e mbetjeve
VKM 177/2012 (amendimi 2018)




**Figura 2 Synimet për MMN në politikat dhe rregulloret shqiptare dhe direktivat e BE**

## 1.5 Konsultime me aktorët kryesorë për përgatitjen e PRMM

Përgatitja e PRMM të Qarkut Berat u realizua në kuadër të Projektit “Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Shqipëri, Faza I”, të mbështetur nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, nëpërmjet SECO. Projekti synon të krijojë bazën për investime të ardhshme në infrastrukturën rajonale.

Procesi i hartimit të PRMM filloi në gjysmën e dytë të 2018 me krijimin e ekipit të kompetencave dhe analizën e situatës aktuale. Ekipi i kompetencave konsiston në zëvendës kryetarë dhe specialistë nga secila bashki (specialistë mjedisorë, specialistë finance dhe përfaqësues të Qarkut Berat). Përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) janë përfshirë gjithashtu dhe kanë mbështetur procesin e hartimit të PRMM. Skema e mëposhtme paraqet hapat kryesorë për përgatitjen e PRMM dhe të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) që e shoqëron atë.




**Figura 3 Hapat kyç për përgatitjen e PRMM dhe VSM përfshi procesin e konsultimit**

Bazuar në Analizën e status-quo, u hartua një koncept për menaxhimin rajonal të mbetjeve të ngurta në të ardhmen. U prezantuan alternativat teknike dhe organizative për sistemin e ardhshëm rajonal të MMN dhe skenarët e parapëlqyer janë diskutuar në dy seminare në Prill dhe Maj 2019 me ekipin e kompetencave dhe përfaqësues të MTM dhe MIE. Draft PRMM u përpilua në Gusht 2019.

Objektivat dhe alternativat e parashtruara në këtë PRMM janë diskutuar gjithashtu me përfaqësues të autoriteteve rajonale përkatëse, përfshirë Drejtorinë Rajonale të Mjedisit dhe Prefektin.

Grupet e interesit dhe aktorët kryesorë janë konsultuar në lidhje me draft planin. Komentet e marra janë përfshirë në versionin përfundimtar të PRMM. Ky PRMM duhet të miratohet nga secili prej Këshillave Bashkiakë në Qarkun Berat dhe nga Këshilli i Qarkut dhe t'i nënshtrohet miratimit nga Komiteti Ndër-Ministror.

VSM përkatëse është përgatitur njëkohësisht me procesin e hartimit të PRMM. Ai filloi me një njoftim dërguar MTM nga Qarku në cilësinë e autoritetit propozues në Korrik 2019. Rezultatet e konsultimit janë bërë pjesë e raportit përfundimtar të VSM dhe janë marrë në konsideratë për finalizimin e PRMM.

# 2 Analiza e Status-Quo

## 2.1 Kuadri i përgjithshëm

Qarku Berat është një nga dymbëdhjetë qarqet e Shqipërisë, i cili ndodhet në Shqipërinë jug-qendrore. Qendra administrative e qarkut ndodhet në qytetin e Beratit. Qarku ka një sipërfaqe në total prej 1,806 km². Pas Reformës Territoriale Administrative (RTA) në 2015, Qarku i Beratit tani konsiston në pesë bashki të cilat ndahen më tej në 25 njësi administrative, siç paraqiten në hartën e mëposhtme.




**Figura 4 Pamje e përgjithshme e Qarkut Berat**

Qarku Berat rrethohet nga qarqe të tjera të Shqipërisë, përkatësisht Qarku Elbasan në veri, Qarku Korçë në lindje, Qarku Gjirokastër në jug dhe Qarku Fier në perëndim. Qendra e Qarkut, qyteti i Beratit, ndodhet në bregun e djathtë të lumit Osum, i vendosur në tarraca në faqet e malit të Tomorrit. Në Korrik 2008, qyteti i vjetër i Beratit (lagjja Mangalem) u listua në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Siç është karakteristike në pjesën më të madhe të territorit të vendit, Qarku Berat ka një klimë mesdhetare. Ndikimi i klimës mesdhetare ndjehet në gjithë territorin dhe në rrjetin hidrografik.

Pjesa më e madhe e territorit të qarkut karakterizohet nga relievi malor, në veçanti pjesa juglindore e rajonit, ndërsa pjesa veriperëndimore konsiston pjesërisht në pllajën e Myzeqesë, një zonë në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë qendrore, e cila është e njohur për potencialin e saj bujqësor.

Ky qark lidhet me rrugën nacionale nëpërmjet rrugës rajonale SH72, e cila kalon përmes Luginës së Osumit dhe funksionon si një korridor kryesor transporti për vendbanimet e qarkut. Zonat rurale janë të lidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet rrugëve urbane dytësore sipas kodit rrugor kombëtar. Rrugët në pjesën më të madhe të zonave dhe vendbanimeve të largëta janë të pashtruara dhe në gjendje të keqe, veçanërisht në Bashkitë malore të Poliçanit dhe Skraparit, por edhe në zonat malore të bashkive të tjera.

Prodhimi i brendshëm bruto (çmime aktuale) në Qarkun Berat për vitin 2016 ishte 58 miliardë Lekë (423 milion EUR), me një rritje prej 5.1% krahasuar me vitin 2015. PBB për person në Qarkun Berat në vitin 2016 ishte rreth 434 mijë Lekë (3,500 EUR) ose 15% më pak se mesatarja kombëtare.

Qendrat urbane në rajon ofrojnë një ndërthurrje të shërbimeve dhe funksioneve ekonomike dhe kanë infrastrukturë më të mirë se sa zonat rurale. Zonat rurale janë të specializuara në bujqësi, kryesisht në kultivimin e tokës dhe më pak në përpunim. Përveç sektorit të agrikulturës, turizmi si pjesë e vizionit të Qarkut Berat është forca kryesore që mbështet zhvillimin ekonomik në të gjithë rajonin. Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, këto dy fusha të zhvillimit, turizmi dhe bujqësia, janë sektorët kyç që ofrojnë mundësi për rritje për rajonin. Në 2017, 8,763 biznese ishin të regjistruara në gjithë qarkun, shumica prej të cilave me vendndodhje në Bashkinë Berat (3,663).

Përveç bujqësisë, në rajon janë shumë të pranishme edhe aktivitetet e minierave dhe guroreve. Ushtrohet aktivitet në gurore për nxjerrjen e mermerit dhe gurit gëlqeror dhe

numri i puseve të naftës në Bashkinë Kuçovë është më i larti nga të gjitha zonat naftëmbajtëse në Shqipëri. Gjithashtu, një zonë tjetër me potencial të madh naftëmbajtës është zbuluar në malin Shpirag, i cili është në fazë testimi të prodhimit dhe nuk është komercializuar ende. Testi i parë i shpimit të pusit Shpiragu 2, me vendndodhje në Njësinë Administrative Sinjë të Bashkisë Berat ka dhënë rezultate premtuese dhe pritet që të zgjerohet zona e kërkimit.

Sipas Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës në Shqipëri (INSTAT, 2012, e rishikuar në 2015), Qarku Berat ka një nivel varfërie prej 12.3%, e cila është më e ulët se mesatarja kombëtare (14.3%).

## 2.2 Demografia & zhvillimi i popullsisë

Popullsia e Qarkut Berat ka pësuar një rënie konstante që prej vitit 2001, siç tregohet në grafikun më poshtë. Zonat rurale në veçanti, të cilat dominojnë territorin e secilës bashki të qarkut, kanë pasur rënie drastike të popullsisë për shkak të migrimit të brendshëm dhe të jashtëm. Shumë banorë nga fshatrat në zonat rurale kanë migruar drejt zonave urbane. Krahas migrimit të brendshëm midis zonave rurale dhe urbane, migrimi i jashtëm drejt rajoneve të tjera ose jashtë vendit gjithashtu ka qenë një faktor kyç për pakësimin e popullsisë. Kjo situatë është reflektuar në strukturën dhe gjendjen ekonomike dhe të mirëqenies, e cila është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në territorin e qarkut.




**Figura 5 Rënia e numrit të popullsisë së Qarkut Berat gjatë viteve të kaluara[4]**

[4] Të dhënat nga INSTAT: Popullsia sipas qarqeve 1 Janar, me të dhëna mbi popullsinë, sipas gjinive, të paraqitura sipas viteve për çdo qark, (stand: 21 Nëntor 2018)

Përveç shifrave të popullsisë të nxjerra nga INSTAT, bashkitë i regjistrojnë popullsitë përkatëse në zyrat e tyre të gjendjes civile. Megjithatë, midis këtyre dy burimeve të të dhënave ka mospërputhje të konsiderueshme. Sipas të dhënave të regjistrit civil, popullsia e Qarkut Berat ishte rreth 221,569 në 2017 dhe kjo shifër është pothuajse 50% më e lartë se shifra e dhënë nga INSTAT.

Si pjesë e përgatitjes së Master Planit për Menaxhimin e Mbetjeve Bashkiake, Konsulenti në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Ministritë e tjera të linjës/ Grupin e Punës për MMN dhe KfW, ka hartuar metodologjinë për parashikimin e numrit të popullsisë dhe sasisë së mbetjeve. Llogaritja ka përdorur për bazë të dhënat e popullsisë nga INSTAT (bazuar në Census) dhe Regjistrin Civil dhe ka zbatuar faktorin e korrigjimit të përgatitur nga Ministria e Financave e Shqipërisë: Census + (Regjistri Civil – Census) * 30 %.

Sipas kësaj përllogaritjeje, popullsia e Qarkut Berat ishte gjithsej 161,688 banorë në 2017 dhe 159,629 banorë në 2018. Në vitin 2018 rreth 43% e popullsisë të gjithë Qarkut jetonte brenda kufijve të Bashkisë Berat. Bashkia e dytë më e populluar është Bashkia Kuçovë. Popullsia e secilës bashki paraqitet në figurën e mëposhtme.




| Municipality | Population |
|---|---|
| Berat | 68,090 |
| Kuçovë | 36,557 |
| Poliçan | 12,306 |
| Skrapar | 13,275 |
| Ura Vajgurore | 29,401 |
| **Total** | **159,629** |

**Figura 6 Popullsia e përllogaritur e bashkive të Qarkut Berat në 2018 bazuar në të dhënat e INSTAT, të regjistrit civil dhe faktorit të korrigjimit të MF**

## 2.3 Karakteristikat e mbetjeve bashkiake në Qarkun Berat

Një analizë e mbetjeve bashkiake në drejtim të përbërjes së tyre dhe të sasisë së tyre të përgjithshme përbën një bazë si për hartimin e koncepteve të menaxhimit të mbetjeve ashtu edhe për planifikimin e impianteve të riciklimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve.

### 2.3.1 Përbërja e mbetjeve

Drafti i PRMM i vitit 2014 ka përdorur të dhënat nga një studim i kryer në kuadër të projektit INPAEL të mbështetur nga BE në 2009 për të përllogaritur përbërjen e mbetjeve në bashkitë e veçanta të Qarkut Berat si edhe në gjithë Qarkun. Rezultatet paraqiten në figurën e mëposhtme.







**Figura 7 Përbërja e mbetjeve urbane e përllogaritur nga projekti SELEA**

Pothuajse gjysma e sasisë së mbetjeve është e përbërë nga mbetjet organike, çka pasqyron një situatë të ngjashme me mesataren kombëtare.

### 2.3.2 Sasitë e mbetjeve

Aktualisht në asnjë nga bashkitë e qarkut Berat nuk ka një sistem monitorimi për sasitë e grumbulluara të mbetjeve. Pra, sasitë e mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara mund të përllogariten vetëm mbi bazën e disa parametrave, si norma specifike e gjenerimit të mbetjeve, numri dhe distancat e rrugëve që përshkojnë mjetet e grumbullimit, etj. Në

Master Planin për Menaxhimin e Mbetjeve Bashkiake (Master Plani), është përgatitur një përllogaritje e sasive të mbetjeve që prodhohen dhe grumbullohen në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, përfshirë edhe bashkitë e Qarkut Berat. Gjatë fazës fillestare të Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Shqipëri, janë mbledhur të dhënat aktuale nga bashkitë nëpërmjet një pyetësori dhe përllogaritja është përshtatur paksa. Për të qenë në përputhje me të dhënat kombëtare të planifikimit, shifrat e përshtatura të mbetjeve nga Master Plani janë përdorur si bazë për planifikimin e mëtejshëm dhe llogaritjet e bëra për këtë plan.

Sasitë e mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara në qarkun Berat janë përllogaritur si më poshtë vijon.

**Tabela 2 Sasitë e mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara në Qarkun Berat në 2018**

| | Berat | Kuçovë | Poliçan | Skrapar | Ura Vajgurore | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Të prodhuara [t/vit]** | 21,090 | 9,154 | 2,062 | 2,477 | 4,719 | **39,503** |
| **Të grumbulluara [t/vit]** | 18,311 | 7,676 | 1,482 | 1,332 | 3,774 | **32,574** |
| **Norma e grumbullimit** | 87% | 84% | 72% | 54% | 80% | **82%** |

Sipas kësaj përllogaritjeje, mbi 50% e sasisë së mbetjeve prodhohet dhe grumbullohet në Bashkinë Berat (qyteti Berat). Sasia e mbetjeve të grumbulluara në bashkitë Berat dhe Kuçovë është e barabartë me 80% të mbetjeve të grumbulluara në të gjitha bashkitë.

Sasitë e mbetjeve të grumbulluara janë të ndryshme nga sasitë që prodhohen, sepse shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk i mbulojnë të gjitha zonat, veçanërisht në zonat bujqësore (rurale). Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve raportohet të ofrohet plotësisht në qendrat bashkiake dhe pjesërisht në shumicën e njësive të tjera administrative. Përveç kësaj, nuk ofrohen shërbime të MMN në njësitë administrative Zhepë, Leshnjë, Potom dhe Tërpan. Sipas gjetjeve të Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Shqipëri, normat e grumbullimit të mbetjeve në qendrat bashkiake dhe njësitë administrative janë përkatësisht rreth 90% dhe 75%. Gjithashtu, supozohet që në të gjitha njësitë administrative ku nuk ofrohet shërbim MMN, norma e grumbullimit të mbetjeve është 0%. Përkatësisht, është mbledhur rreth 82% e mbetjeve të prodhuara në gjithë Qarkun e Beratit në 2018.

Meqë zonat e aktivitetit të bizneseve janë të shpërndara në të gjitha vendbanimet, mbetjet shtëpiake dhe mbetjet nga bizneset të ngjashme me ato shtëpiake grumbullohen së

bashku. Për rrjedhojë, mbetjet nga aktiviteti i bizneseve nuk janë të regjistruara si një rrymë e ndarë e mbetjeve dhe për këtë arsye nuk është e mundur të bësh dallime midis llojeve të ndryshme të mbetjeve nga bizneset. Këto mbetje të ngjashme me ato shtëpiake janë pjesë e mbetjeve që grumbullohen çdo ditë.

## 2.4 Organizimi institucional

### 2.4.1 Niveli kombëtar

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri ndahen midis nivelit kombëtar, rajonal dhe atij vendor. Këto përgjegjësi funksionale janë duke u rishikuar në kuadër të politikave kyç që po hartohen, pra në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit dhe të ndryshimeve të propozuara në Ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Ligji nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është legjislacioni kyç që përcakton përgjegjësitë institucionale në fushën e menaxhimit të mbetjeve në organizmat e qeverisë qendrore, përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë e varura prej saj, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Detyrat specifike u caktohen këtyre ministrive nëpërmjet vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave (Shtator 2017), të ndjekura nga një VKM tjetër që i cakton një rol specifik për menaxhimin e mbetjeve Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, një agjenci në varësi të MIE.

MTM ka rolin drejtues në kuadrin e përgjithshëm rregullator dhe të politikave për të gjitha llojet e mbetjeve dhe mbikëqyr plotësisht administrimin e mbetjeve të rrezikshme. MTM është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit. Së bashku me institucione të tjera në varësi të saj, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ministria mban përgjegjësinë për ngritjen dhe monitorimin e një sistemi për menaxhimin e mbetjeve.

MIE mbulon investimet për infrastrukturën dhe hartimin e standardeve dhe teknikave më të mira për menaxhimin e mbetjeve bashkiake dhe të mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet, si edhe ciklin e projektit për ndërtimin (planifikim, projektim dhe zbatim projekti) e vend depozitimeve rajonale. MIE është i vetmi institucion i qeverisë qendrore që ka një program buxhetor për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane, në buxhetin e vet afatmesëm. Ministria gjithashtu koordinon dhe monitoron aktivitetet për vendgrumbullimet e mbetjeve,

përdorimin e vend depozitimeve rajonale dhe incineratorëve, përcakton kriteret teknike për studimin dhe përgatit mbylljen e vendgrumbullimeve urbane.

Për shumë vjet MIE ka qenë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet bashkiake dhe mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet duke krijuar kështu një burim të vetëm kryesor informacioni mbi sasitë e mbetjeve të gjeneruara në vend.

### 2.4.2 Niveli rajonal

Këshillat e qarkut janë niveli i dytë i qeverisjes vendore në Shqipëri, të cilët nuk janë drejtpërdrejt përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, por ligjërisht ata kanë për detyrë të krijojnë kuadrin rajonal të politikave nëpërmjet planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Sidoqoftë, këshillat janë përgjegjës për miratimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve para hyrjes së tyre në fuqi (Neni 13, Ligji nr. 10463/2011). Funksioni i këshillave të qarkut është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat kombëtare. Këshillat hartojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe raportojnë tek MTM çdo vit mbi zbatimin e tyre (neni 13, Ligji nr. 10463/2011). Roli i këshillave të qarkut është rishikuar gjatë pak viteve të fundit, ndërsa draft SKMIM sugjeron një rol të reduktuar për Këshillat e Qarkut në menaxhimin e mbetjeve.

### 2.4.3 Niveli vendor

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e NJQV në drejtim të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Konkretisht, grumbullimi, transporti, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përkufizohet si një funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të menaxhojnë ofrimin e shërbimeve në mënyrën që i përshtatet më mirë kushteve të tyre specifike dhe të bashkëpunojnë me bashki të tjera, të caktojnë tarifat e shërbimit dhe një mekanizëm për mbledhjen e të ardhurave, si dhe të ndërtojnë dhe administrojnë impiantet për trajtimin e mbetjeve. Ende i bëhet referencë Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, në lidhje me kontraktimin e palëve të treta për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve dhe standardet moderne mbeten ende për t’u vënë në zbatim nga të gjitha bashkitë.

Është tipike që në bashkitë shqiptare, funksioni i shërbimeve publike, rrjedhimisht edhe i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, është përgjegjësi e njërit prej zëvendës kryetarëve të bashkisë. Ndër bashkitë e Qarkut Berat, situata paraqitet e tillë vetëm në Berat dhe Skrapar, ndërkohë që bashkitë e tjera kanë drejtori që mbulojnë një gamë të gjerë përgjegjësish, përfshi menaxhimin e mbetjeve. Përveç kërkesës për ta mbuluar këtë funksion tërësisht, duke i grupuar ato përgjegjësi bazuar në programet qeverisëse

rrallëherë ka një njësi organizative të dedikuar për këtë funksion që të mbulojë gjithë gamën e funksioneve që u janë caktuar bashkive.

Po ashtu, është tipike në bashkitë shqiptare, që ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve të tenderohet tek kompanitë private që zbatojnë detyrat, teksa stafi i bashkisë monitoron performancën e kompanisë (megjithëse kjo është vetëm një nga shumë detyrat e listuara më sipër). Është për t'u theksuar fakti që ndër bashkitë e Qarkut Berat, Kuçova ka punësuar një specialist për shërbimet publike dhe menaxhimin e mbetjeve. Ky funksion nuk është i mbuluar në ndonjë prej bashkive të tjera me një specialist të punësuar posaçërisht me qëllimin që të planifikojë menaxhimin e mbetjeve në NJQV. Përmbushja e këtij funksioni ende ka nevojë për plotësimin me staf në të gjitha bashkitë e tjera të qarkut.

Në **Bashkinë Berat**, Zëvendës Kryetari (njëri nga tre zëvendës kryetarët) është përgjegjës për të mbuluar menaxhimin e integruar të mbetjeve në bashki, ndërsa në nivel Drejtorie, ajo e Shërbimeve Publike, Transportit, Emergjencave dhe Pronave Publike është përgjegjëse edhe për menaxhimin e mbetjeve. Nuk ka sektorë apo ndonjë njësi tjetër organizative brenda drejtorisë, por një ekip i përbërë nga 9 punonjës, përfshirë drejtorin, një shef për pronat publike, një specialist transporti, specialist për emergjencat, dy supervizorë të ndërmarrjes së pastrimit, njëri për zonat urbane dhe tjetri për zonat rurale dhe një supervizor për shërbimet funerale, një topograf dhe një punëtor për kontrollin e parazitëve dhe dizinfektimin. Në strukturën e vitit 2019, inxhinieri i mjedisit, aktualisht në Sektorin e Planifikimit Urban, Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit Urban, do t'i bashkohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Në **Bashkinë Poliçan**, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve është përgjegjëse edhe për menaxhimin e mbetjeve. Sërish kjo është një strukturë me një gamë të gjerë përgjegjësish. Kjo drejtori përfshin një drejtor dhe tre specialistë mbështetës, si edhe një supervizor, i cili monitoron performancën e kompanisë së pastrimit, por mbulon gjithashtu shërbime të tjera publike që lidhen me gjelbërimin, dekorin dhe varrezat. Drejtoria e Planifikimit Urban ka një specialist për agro-mjedisin.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në **Bashkinë Ura Vajgurore** është i organizuar brenda Drejtorisë së Planifikimit Urban, Investimeve, Projekteve Shërbimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, e cila konsiston në dy sektorë. Sektori përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe nëntë punonjës, nga të cilët shtatë janë nëpunës civilë, përfshirë një specialist mjedisi me një funksion të drejtpërdrejtë në menaxhimin e mjedisit urban, përfshirë menaxhimin e mbetjeve. Ndërkohë, sektori i shërbimeve publike përbëhet nga 93 punonjës dhe merret me shërbimet e drejtpërdrejta, si gjelbërimi dhe mirëmbajtja e

rrugëve, për këtë arsye pjesa më e madhe e punonjësve nuk janë pjesë e shërbimit civil, por të punësuar me kontratë pune, përveç përgjegjësit të sektorit.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në **Bashkinë Skrapar** është përgjegjësi dhe drejtohet nga zëvendës kryetari (njëri nga dy zëvendës kryetarët e bashkisë), megjithëse, përsëri nuk ka një njësi organizative brenda administratës së bashkisë të dedikuar në mënyrë specifike për menaxhimin e mbetjeve, por një ndërmarrje në pronësi të bashkisë. Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Planifikimit Urban konsiston në tre specialistë, ku përfshihet një specialist mjedisi, me një funksion të drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe monitorimin e territorit, përfshi aspektet mjedisore. Ndërmarrja Bashkiake e Shërbimeve Publike përbëhet nga 3 sektorë, përkatësisht përgjegjës për gjelbërimin dhe dekorin (përfshin 29 punëtorë), sektori i ndërtimeve (12 punëtorë) dhe sektori i pastrimit (26 punëtorë), i cili kryen grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve. Përveç sektorëve përgjegjës për shërbime publike specifike, ndërmarrja ka administratën dhe stafin e saj mbështetës. Njësia Administrative Bogovë ka një inspektor për shërbimet. Megjithatë, kjo është e vetmja njësi që përfshin një pozicion të tillë, për shkak të numrit të lartë të bizneseve dhe turistëve dhe të pozicionit gjeografik në hyrje të qytetit nga rruga nacionale.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit në **Bashkinë Kuçovë** është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në të gjitha njësitë administrative të bashkisë dhe përfshin monitorimin e performancës së shërbimit të ndërmarrjes së pastrimit. Drejtoria e shërbimeve publike është e mirorganizuar dhe përbëhet nga dy sektorë që monitorohen nga drejtori. Sektori i shërbimeve publike përbëhet nga dy specialistë (1 për shërbimet publike dhe menaxhimin e mbetjeve dhe 1 supervizor të ndërmarrjes së shërbimeve publike). Stafi përbëhet nga 47 punonjës, të cilët u ofrojnë qytetarëve shërbime të drejtpërdrejta, përfshi 33 punonjës të përfshirë në pastrim dhe grumbullimin e mbetjeve në të gjitha njësitë administrative. Sektori i shërbimeve komunale, ujësjellësit dhe transportit përbëhet nga 2 specialistë (1 për transportin dhe 1 për shërbimet komunale dhe ujësjellësin dhe 132 punëtorë në shërbimet e drejtpërdrejta).

Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në shumicën e bashkive në qarkun Berat ofrohen nga sektori privat. Vetëm Bashkia Skrapar u ofron banorëve shërbimet MMN drejtpërdrejt (ndërmarrje e sektorit publik). Në përgjithësi, kompanitë private që ofrojnë shërbimet MMN lidhin kontrata me bashkitë nëpërmjet prokurimit publik për një periudhë prej pesë vjetësh. Tabela e mëposhtme përmbledh informacion mbi përfshirjen e operatorëve privatë të shërbimit nëpër bashki.

**Tabela 3 Përfshirja e sektorit privat në shërbimet bashkiake të MMN**

| Bashkia | Ofruesi MMN | Ofrimi i MMN nga Sektori Privat | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Kompania | Kohëzgjatja e Kontratës | Shërbimet MMN |
| Berat | sektori privat | Ante –group shpk (për zonat urbane)<br>Saimiri Grup 1981 shpk (për zonat rurale) | 2014 – 2019<br>2017 – 2019 | pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve, të tjera |
| | | Ante –group shpk | 2019-2024 | |
| Kuçovë | sektori privat | Higjena<br><br>Ed Construction | 2011 – Nëntor 2018<br><br>Nëntor – Dhjetor 2018 | Pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve, pastrimi i banjove publike, larja e kontenierëve, largimi i mbetjeve inerte, depozitimi i mbetjeve |
| | | Viola Green sh.pk | Shkurt 2019 – Shkurt 2023 | |
| Poliçan | sektori privat | Cottoni Center | 2016 – 2021 | pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve |
| Skrapar | sektori publik | | | |
| Ura Vajgurore | sektori privat | Ed Construction | 2016 – 2021 (rinovim çdo vit) | pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve, depozitimi |

Instrumentet e planifikimit në nivel vendor përfshijnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të jenë në përputhje me planet përkatëse kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Në nivel vendor, shërbimet MMN kryhen ose nga personeli me mjetet e bashkisë ose nga kontraktorë privatë.

## 2.5 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve

### 2.5.1 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve bashkiake të përziera

Shërbimet e grumbullimit të mbetjeve mbulojnë gjithë territorin bashkiak vetëm në Bashkinë Ura Vajgurore. Në bashkitë e tjera, shërbimet e grumbullimit ofrohen plotësisht vetëm në qendrat e bashkive dhe pothuajse plotësisht (90-95%) në njësitë administrative Kozarë dhe Perondi. Në njësitë e tjera administrative të qarkut, shërbimet MMN ofrohen vetëm pjesërisht ose nuk ofrohen. Vështirësia kryesore me të cilën përballen bashkitë për shtrirjen e shërbimit të grumbullimit në zonat rurale është gjendja e keqe e rrugëve, e cila bën të pamundur që kamionët e zakonshëm të grumbullimit të mbetjeve të shkojnë nëpër

fshatra. Harta e mëposhtme paraqet në formë pamore mbulimin e shërbimeve MMN përfshirë grumbullimin e mbetjeve në njësitë administrative të Qarkut Berat.




**Figura 8 Ofrimi i shërbimeve MMN në njësitë administrative të Qarkut Berat**

Grumbullimi i mbetjeve në Qarkun Berat praktikohet përgjithësisht duke përdorur pika grumbullimi ku mbetjet e familjeve, të subjekteve të biznesit dhe institucioneve mblidhen së bashku në të njëjtët kosha publikë ose pika grumbullimi të hapura prej betoni. Koshat publikë janë kryesisht prej metali me një vëllim prej 1,100 litra, të pajisur me rrota dhe të vendosur përgjatë rrugëve kryesore në qytete.

Krahas grumbullimit të mbetjeve, kontratat e shërbimit me kompanitë private përfshijnë gjithashtu fshirjen e rrugëve, larjen e kontenierëve dhe pastrimin e rrugëve dhe shesheve. Kontenierët ose koshat pastrohen me pluhur gëlqereje dhe klor. Fshirja e rrugëve bëhet në mënyrë manuale dhe gjithashtu me makineri për fshirjen e rrugëve.

Pas grumbullimit, mbetjet transportohen direkt në vendgrumbullimet lokale. Aktualisht nuk ka ndonjë stacion transferimi në rajon.

### 2.5.2 Grumbullimi i materialeve të riciklueshme

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve në qark ndodh vetëm në formën e nismave të vogla. Shumica e aktiviteteve për grumbullimin e materialeve të riciklueshme realizohet nga sektori informal, përkatësisht komunitetet Rom dhe Egjiptian.

Në Berat, komunitetet Rom dhe Egjiptian banojnë në lagjet “Kushtrim” dhe “Donika Kastrioti”. Këto lagje gjithashtu janë strehë e banorëve që nxjerrin materialet e riciklueshme nga vendgrumbullimi i mbetjeve në Berat, nga kontenierët publikë në Berat dhe gjithashtu në rrugën nacionale Berat - Ura Vajgurore. Gjithsej 45 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian raportohet se janë të përfshira në mbledhjen e mbetjeve. Në zonën Stan Morava, të gjithë banorët e këtij komuniteti janë të përfshirë. Gjatë analizës së status-quo u intervistuan tridhjetë e pesë persona (20 gra), që përbëjnë 21 familje të angazhuara në nxjerrjen e materialeve të riciklueshme nga mbetjet, në zona të ndryshme të kësaj lagjeje të njohura si Moravë, Orizaj, Zagore dhe Vakëf. Duhet të evidentohet që edhe disa persona të tjerë që nuk i përkasin komunitetit Rom apo Egjiptian po përfshihen në grumbullimin e materialeve të riciklueshme dhe numri i tyre po vjen duke u rritur kohën e fundit.

Bashkia Kuçovë ka deklaruar se 22 persona të komunitetit Rom dhe Egjiptian zhvillojnë në mënyrë informale grumbullimin e materialeve të riciklueshme në territorin e bashkisë. Në Bashkinë Ura Vajgurore, aktivitetet informale të grumbullimit të materialeve të riciklueshme kryhen nga komuniteti Rom në fshatin Pashalli. Pesëmbëdhjetë familje të mirorganizuara grumbullojnë fletë plastmasi nga serrat, përveç shisheve plastike dhe metalit, nëpër të gjithë fshatrat e bashkisë Ura Vajgurore. Një numër i vogël i tyre grumbullojnë mbetje nga kontenierët në qytet.

Ndërsa, sipas informacionit të Bashkisë Skrapar nuk ka riciklues informalë brenda territorit të bashkisë. Grumbulluesit informalë mbledhin materiale të riciklueshme si nga koshat publikë edhe nga vendgrumbullimet e mbetjeve. Alumini dhe hekuri janë materialet e riciklueshme më të parapëlqyera tek të gjithë grumbulluesit informalë për shkak të vlerës së tyre.

## 2.6 Trajtimi i mbetjeve

Kompania e vetme e përpunimit për materialet e riciklueshme në qark është B-RECYCLE, një kompani që kryen ndarjen sipas llojit të materialeve plastike të riciklueshme, e cila

ndodhet në Njësinë Administrative Otllak, Bashkia Berat, ngjitur me vendgrumbullimin e mbetjeve të bashkisë. Ky impiant furnizohet me mbetje plastike nga e gjithë Shqipëria dhe - pas ndarjes sipas llojit, pastrimit, coptimit, ngjeshjes dhe paketimit – i shet tek kompanitë vendase dhe të huaja.

Gjithashtu një qendër e vogël kompostimi për mbetjet e gjelbra ka qenë në punë për disa vite (2003 – 2010) në Kuçovë, e drejtuar nga një kompani private; megjithatë, tani ky vend është i braktisur.

Nuk zhvillohen aktivitete të tjera për trajtimin e mbetjeve bashkiake apo mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet.

## 2.7 Depozitimi i mbetjeve

Pasi merren nga pikat e grumbullimit, mbetjet transportohen dhe depozitohen në vendgrumbullimet e bashkive. Në gjysmën e parë të vitit 2018, u krye një studim për “Zbutjen e riskut në vend depozitime” nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kuadër të programit DLDP të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC). Ky studim identifikoi dhe analizoi vendgrumbullimet ekzistuese dhe gjendjen e tyre të tanishme, si edhe propozoi masa për ndërhyrjen në secilin vendgrumbullim të identifikuar. Harta e mëposhtme jep një pamje të vendgrumbullimeve ekzistuese të identifikuara nga studimi në Qarkun Berat sipas llojit të mbetjeve të depozituara.




**Figura 9 Vendndodhja e vendgrumbullimeve ekzistuese në Qarkun Berat**

Secila bashki ka një vend depozitim zyrtar ku depozitohen mbetjet bashkiake të grumbulluara. Përveç kësaj, ka edhe vend depozitime zyrtare për depozitimin e mbetjeve inerte në Bashkinë Kuçovë, Bashkinë Ura Vajgurore dhe Bashkinë Poliçan. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të vend depozitimeve të identifikuara dhe rekomandimet e përfshira në Studimin për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime.

**Tabela 4 Lista e vend depozitimeve të identifikuara nga Nisma e Zbutjes së Riskut në Vend depozitime[5]**

| Nr. | Emri | Bashkia | Statusi | Lloji i mbetjeve të depozituara | Rekomandime në Raportin e Zbutjes së Riskut në Vend depozitime |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Vend depozitim 1 Dushnik | Berat | Ekzistues | Mbetje urbane | Mbyllje |
| 2 | Vend depozitim 2 Lagjja "Çlirim" | Berat | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 3 | Vend depozitim 3 Qendra "Lira" | Berat | Ekzistues | Mbetje urbane dhe inerte | Mbyllje |
| 4 | 1 – ish-ferma "Partizani" | Kuçovë | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 5 | 2 - Gropat e bitumit, ish-UPN | Kuçovë | Ekzistues | Mbetje inerte | Rehabilitim |
| 6 | Vend depozitim 1 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje urbane | Largimi i mbetjeve |
| 7 | 2 - Lagjja PLIREZ | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Rehabilitim |
| 8 | 3 - Lagjja PLIREZ | Poliçan | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 9 | Vend depozitim 4 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 10 | Vend depozitim 5 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 11 | Vend depozitim 6 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 12 | Vend depozitim 7 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 13 | Vend depozitim 8 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 14 | Vend depozitim Bogovë 1 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 15 | Vend depozitim Bogovë 2 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 16 | Vend depozitim Çorovodë 1 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 17 | Vend depozitim Çorovodë 2 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 18 | Çerenisht | Skrapar | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 19 | 1 – fshati Vokopolë | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 20 | 2 – fshati Sqepur | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje urbane | Largimi i mbetjeve |
| 21 | 3 – fshati Kuç | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje urbane | Largimi i mbetjeve |
| 22 | 4 – vend depozitim i mëparshëm | Ura Vajgurore | I mbyllur | Mbetje urbane | Mbjellje pemësh |
| 23 | 5 – Lagjja "28 Nëntori" | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje inerte | Rehabilitim |

Ndër vend depozitimet e identifikuara dy prej tyre kanë përmasat më të mëdha, përkatësisht ai i Bashkisë Berat dhe Bashkisë Kuçovë të cilat janë të shënuara me rreth

[5] [5] Source: Dumpsite Risk Mitigation Final Report (June 2018)

në hartën e Figura 9. Së bashku me vend depozitimin e Bashkisë Ura Vajgurore, ato janë planifikuar të rehabilitohen në kuadër të Projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Shqipëri.

Vend depozitimet bashkiake të Bashkisë Ura Vajgurore, si për mbetjet bashkiake (11- fshati Vokopolë) dhe për mbetjet inerte (5- Lagjja "28 Nëntori"), janë miratuar me Vendime të Këshillit Bashkiak përkatësisht nr. 30 dhe nr. 31 datë 17.05.2016, të cilat janë konfirmuar edhe nga Prefektura e Qarkut Berat me letrën nr. 1096, datë 07.06.2016 "Për verifikimin e ligjshmërisë së akteve ". Gjithashtu, ka një studim gjeologjik-inxhinierik dhe raport për vlerësimin mjedisor për vend depozitimin e mbetjeve bashkiake. Ky vend depozitim do të përdoret deri sa të vendoset për një koncept rajonal për depozitimin e mbetjeve. Krahas kësaj, vend depozitimi i mbetjeve inerte bashkiake ndodhet në një gurore të vjetër.

Vend depozitimi bashkiak i Bashkisë Skrapar për mbetjet bashkiake (Vend depozitimi Çorovodë 1) ka qenë në përdorim që nga vitet 1990 dhe është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak në 1998. Në 2007, u krye një Studim Fizibiliteti për menaxhimin e mbetjeve në Çorovodë dhe në 2014 vend depozitimi u rehabilitua. Sidoqoftë, kapaciteti i vend depozitimit të rehabilituar nuk është i mjaftueshëm për sasinë e mbetjeve që grumbullohet në bashki pas reformës territoriale. Për këtë arsye në 2016 u hap një vend depozitim tjetër (Vend depozitimi Çorovodë 2) për depozitimin e mbetjeve bashkiake në një distancë prej rreth 300 m nga vendgrumbullimi i vjetër. Megjithatë, vend depozitimi i ri nuk i përmbush kërkesat minimale teknike. Grupi i punës i studimit të Zbutjes së Riskut në Vend depozitime propozoi që vend depozitimi të rehabilitohet dhe të përdoret deri sa të zbatohet koncepti rajonal për depozitimin e mbetjeve.

Vend depozitimet bashkiake të Bashkisë Poliçan, si për mbetjet bashkiake (3- Lagjja PLIREZ) dhe për mbetjet inerte (2- Lagjja PLIREZ), janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak përkatësisht në 2012 dhe 2016. Grupi i punës i studimit për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime propozoi që vend depozitimet të rehabilitohen dhe të përdoren deri sa të vendoset për një koncept rajonal për depozitimin e mbetjeve.

## 2.8 Kostot dhe financimi

### 2.8.1 Kostot e shërbimeve MMN

Buxheti për shërbimet MMN të bashkive në zonën e projektit përbëjnë 4 – 10 % të totalit të buxhetit bashkiak. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të përmbledhur buxhetet bashkiake për shërbimet MMN në 2018 në raport me totalin e buxhetit bashkiak.

**Tabela 5 Buxheti bashkiak (2018) për shërbimet MMN**

| Bashkia | Totali i buxhetit bashkiak (2018) | Buxheti total për shërbimet MMN (2018) | |
|---|---|---|---|
| | Lekë | Lekë | Përqindja në buxhetin total |
| Berat | 1,164,990,000 | 61,629,800 | 5% |
| Ura Vajgurore | 210,000,000 | 20,802,000 | 10% |
| Kuçovë | 643,427,075 | 38,585,808 | 6% |
| Skrapar | 368,285,877 | 14,067,000 | 4% |
| Poliçan | 167,680,000 | 15,266,000 | 9% |

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet vjetore të bashkisë për shërbimet MMN në 2017, si edhe kostot specifike të llogaritura bazuar në shifrat e përllogaritura të sasisë së mbetjeve. Kostot specifike në Bashkinë Skrapar dhe Bashkinë Poliçan janë më të larta krahasuar me bashkitë e tjera, çka reflekton vështirësinë e tyre në grumbullimin e mbetjeve për shkak të sasisë së vogël dhe të vendbanimeve të shpërndara nëpër zonat malore.

**Tabela 6 Shpenzime për MMN dhe kostot specifike në 2017**

| Bashkia | Shpenzimet për MMN në 2017 | Sasia e grumbulluar e mbetjeve në 2017 | Kostot specifike të MMN në 2017 |
|---|---|---|---|
| | Lekë/vit | t/vit | Lekë/t |
| Berat | 59,569,192 | 18,530 | 3,215 |
| Ura Vajgurore | 20,802,000 | 3,820 | 5,446 |
| Kuçovë | 32,009,495 | 7,768 | 4,121 |
| Skrapar | 13,869,000 | 1,315 | 10,551 |
| Poliçan | 15,000,200 | 1,505 | 9,967 |

Tabela e mëposhtme përmban ndarjen e kostos totale për MMN në 2017 sipas komponentëve të veçantë të MMN.

**Tabela 7 Alokimi i buxhetit për shërbimet MMN (2017)**

| Bashkia | Fshirja e rrugëve (2017) | Grumbullimi i mbetjeve (2017) | Depozitimi i mbetjeve (2017) | Të tjera (2017) |
|---|---|---|---|---|
| | %/vit | %/vit | %/vit | %/vit |
| Berat | 19% | 49% | | 33% |
| Ura Vajgurore | 22% | 65% | 3% | 9% |
| Kuçovë | 21% | 60% | 3% | 16% |
| Skrapar | 79% | 20% | 1% | |
| Poliçan | Nuk ka informacion të saktë në dispozicion | | | |

### 2.8.2 Financimi i shërbimeve MMN

Për financimin e shërbimeve MMN, përdoren kryesisht tre burime: tarifat nga familjet, tarifat nga subjektet e biznesit dhe institucionet dhe buxheti i përgjithshëm bashkiak. Tarifa nga familjet mblidhet së bashku me faturën e ujit dhe pagesa për shërbime të tjera. Gjithashtu, tarifa nga bizneset mblidhet së bashku me pagesa për shërbime të tjera të ndryshme nga fatura e ujit, me përjashtim të rastit në Bashkinë Berat ku tarifa mblidhet veçmas nga ato të shërbimeve të tjera. Tabela e mëposhtme paraqet tarifat për MMN që zbatohen për familjet në Njësitë Administrative të çdo bashkie.

**Tabela 8 Tarifat për shërbimet MMN për familje**

| Bashkia | Njësia Administrative | Tarifa e MMN për familjet | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 2018 | 2019 | 2020 | |
| | | Lekë/ muaj/familje | Lekë/ muaj/familje | Lekë/ muaj/familje | |
| Berat | Berat | 108 | 108 | | |
| | Velabisht | 100 | 100 | | |
| | Otllak | 100 | 100 | | |
| | Sinjë | 100 | 100 | | |
| | Roshnik | 100 | 100 | | |
| Ura Vajgurore | Ura Vajgurore | 200 | 200 | 200 | |
| | Poshnjë | 83 | 83 | 100 | |
| | Kutalli | 83 | 83 | 100 | |
| | Cukalat | 83 | 83 | 100 | |
| Kuçovë | Kuçovë | 142 | 150 | 167 | |
| | Kozarë | 83 | 92 | 100 | |
| | Perondi | 83 | 92 | 100 | |
| | Lumas | 42 | 50 | 67 | |
| Skrapar | Çorovodë | 100 | 100 | 116 | |
| | Qendër Skrapar | 108 | 108 | | Vetëm disa fshatra |
| | Bogovë | 100 | 100 | | Vetëm fshatrat Bogovë dhe Kakrukë |
| | Vendreshë | 100 | 100 | | Vetëm për fshatin Therepel |
| | Çepan | 100 | 100 | | Vetëm për fshatin Çepan |
| | Potom | 100 | 100 | | |
| | Leshnjë | 108 | 108 | | |
| | Gjerbës | 100 | 100 | | Vetëm për fshatin Gjerbës |
| | Zhepë | | | | |
| Poliçan | Poliçan | 25 | 25 | 25 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Tërpan | 0 | 0 | 0 | |
| | Vërtop | 25 | 25 | 25 | |

Tarifat për shërbimet MMN që u tarifohen subjekteve të biznesit variojnë sipas llojit dhe përmasave të bizneseve nga 83 në 42,000 Lekë në muaj për biznes. Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat e tarifave për MMN për subjektet e biznesit në secilën bashki në 2018.

**Tabela 9 Niveli i tarifave për shërbimet MMN që u tarifohen bizneseve**

| Bashkia | Tarifa për MMN [Lekë / muaj/ njësi] |
|---|---|
| Berat | 83 – 6,708 |
| Ura Vajgurore | 100 – 19,158 |
| Kuçovë | 183 – 5,500 |
| Skrapar | 125 – 6,667 |
| Poliçan | 833 – 41,667 |

Shuma totale e tarifave të mbledhura nga burime të ndryshme në 2017 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 10 Të ardhurat nga tarifat MMN të mbledhura në 2017 sipas burimit**

| Bashkia | Të ardhurat MMN 2017 | | | Të ardhurat MMN 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Familje [Lekë] | Biznese [Lekë] | Institucione [Lekë] | Familje [%] | Biznese [%] | Institucione [%] |
| Berat | 19,420,771 | 49,693,229 | 1,275,000 | 28% | 71% | 2% |
| Ura Vajgurore | 3,368,000 | 12,766,000 | 1,703,000 | 19% | 72% | 10% |
| Kuçovë | 6,503,000 | 16,847,000 | 7,058,000 | 21% | 55% | 23% |
| Skrapar | 1,369,000 | 3,479,000 | 570,000 | 25% | 64% | 11% |
| Poliçan | 414,000 | 12,145,500 | 680,000 | 3% | 92% | 5% |

Kostot për standardin e shërbimeve MMN të ofruara në 2017 janë mbuluar me sukses nga ardhurat e përfituara nga mbledhja e tarifave në dy bashkitë më të populluara të qarkut: Bashkinë Berat dhe Bashkinë Kuçovë. Në Bashkinë Berat, të ardhurat nga tarifat aktualisht i tejkalojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve me 31 %, ndërsa të ardhurat në Bashkinë Kuçovë i mbulojnë pothuajse plotësisht kostot MMN, përkatësisht 95%. Po kështu, Bashkia Poliçan dhe Bashkia Ura Vajgurore kanë arritur gjithashtu një nivel të lartë rikuperimi të kostove me anë të të ardhurave në 2017, përkatësisht 88% dhe 86%. Situata paraqitet krejt ndryshe në Bashkinë Skrapar ku kostot MMN mbulohen vetëm në masën 39% në të njëjtin vit.

Tabela e mëposhtme paraqet të ardhurat dhe shpenzimet për shërbimet MMN në 2017 si edhe nivelin e mbulimit të kostove, të llogaritur për bashkitë në Qarkun Berat.

**Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet për MMN në 2017 në bashkitë e Qarkut Berat**

| Bashkia | Të ardhurat nga mbledhja e tarifave | Shpenzime vjetore për shërbimet MMN | Mbulimi i kostos nga tarifat |
|---|---|---|---|
| | Lekë | Lekë | % |
| Berat | 70,389,000 | 59,569,192 | 118% |
| Ura Vajgurore | 17,837,000 | 20,802,000 | 86% |
| Kuçovë | 30,408,000 | 32,009,495 | 95% |
| Skrapar | 5,418,000 | 13,869,000 | 39% |
| Poliçan | 13,239,500 | 15,000,200 | 88% |

Pas shqyrtimit të të dhënave të 2018, mund të thuhet se mbulimi i kostove aktuale është i kënaqshëm dhe ofron një perspektivë premtuese për përmirësimin e ardhshëm të shërbimeve. Megjithatë, ka disa çështje që duhet të merren parasysh:

- Pjesa më e madhe e kostove mbulohet me tarifat e bizneseve (nga 55% deri në 92%); ndërsa përqindja e pagesave nga familjet është e ulët dhe nuk arrin të mbulojë kostot.
- Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet për funksionimin / përmirësimin e vend depozitimeve.
- Në Bashkinë Skrapar mbulimi i kostove nga tarifat është më pak se 40%. Kjo vjen pjesërisht për shkak të kushteve të vështira për grumbullimin e mbetjeve (në zonat malore me popullsi të vogël), por gjithashtu për shkak të kostove të larta (dhe numrit të lartë të stafit) për fshirjen e rrugëve.

### 2.8.3 Vlerësimi i përballueshmërisë financiare

Duke qenë se nuk ka të dhëna zyrtare për të ardhurat / shpenzimet e familjeve në nivel bashkie, janë përdorur të dhënat statistikore të shpenzimeve mesatare për familje në nivel rajoni për të vlerësuar përballueshmërinë financiare të popullatës për të paguar tarifat për shërbimet MMN. Sipas Sondazhit për Buxhetin e Familjeve të kryer nga INSTAT, shpenzimet mesatare të konsumit për familje në Qarkun Berat në 2017 ishin 69,948 Lekë në muaj (INSTAT, 2018).

Për një vlerësim fillestar të përballueshmërisë, janë marrë parasysh nivelet e përballueshmërisë që janë të pranuara ndërkombëtarisht për tarifat MMN. Siç është deklaruar nga Banka Botërore niveli nga 0.7 – 2.5% e të ardhurave për familje konsiderohet si e përballueshme për MMN. Për këtë arsye, kufiri më i lartë i përballueshmërisë për të paguar tarifën e shërbimeve MMN mund të llogaritet sa 1% e shpenzimeve familjare në 2017, përkatësisht 699 Lekë (5.69 EUR) për familje në muaj. Aktualisht, bashkitë i mbledhin tarifat e MMN nga familjet, që variojnë nga 25 – 200

Lekë/familje/muaj, nivel i cili është brenda kufirit të përballueshmërisë financiare për të paguar. Megjithatë, shifra mesatare e shpenzimeve për familjet dhe përballueshmëria për shërbimet MMN mund të variojnë në masë të madhe edhe midis bashkive për shkak të karakteristikave të tyre të ndryshme ekonomike.

## 2.9 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet

Menaxhimi i mbetjeve inerte dhe mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet (MNP) është një sfidë për Qarkun Berat. MNP shpesh hidhen në vende të papërshtatshme, përfshirë trupat ujorë, duke i shkaktuar ndikime negative mjedisit dhe popullatës vendase. Krahas depozitimit pa dallim të mbetjeve të ndërtimit, praktika të ngjashme mund të shihen me mbetjet nga përpunimi i gurit gëlqeror dhe mermerit. Hedhja e MNP në shtretërit e lumenjve rrit rrezikun e përmbytjeve, për shembull për shkak të bllokimit të rrjedhës së ujit. Përveç kësaj , megjithëse mbetjet inerte përfshirë mbetjet e ndërtimit nuk lejohet të hidhen në koshat e mbetjeve, MNP shpesh gjenden në kontenierët publikë të bashkisë. Për këtë arsye, është i nevojshëm përmirësimi i menaxhimit të MNP në rajon në të ardhmen.

Ashtu si për mbetjet e ngurta bashkiake, nuk ka të dhëna zyrtare as për sasinë e mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet (MNP) të prodhuara në Qarkun Berat. Pasiguria është edhe më e madhe, pasi më së shumti MNP depozitohen nga individët ose kontraktorët privatë në mënyrë të pakontrolluar përgjatë rrugëve, brigjeve të lumenjve, ose në tokat bujqësore të pambjella.

Në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake (Master Plani), është bërë një përllogaritje e mbetjeve inerte të gjeneruara në Shqipëri, duke marrë për bazë sasitë specifike të mbetjeve të marra nga vendet e BE me anë të proceseve të rregullta të monitorimit dhe raportimit (p.sh. Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda dhe Luksemburgu). Meqë situata ekonomike dhe aktivitetet e ndërtimit në Shqipëri janë të ndryshme krahasuar me vendet e Evropës Qendrore, sasitë e mbetjeve inerte janë përllogaritur në bazë të raportit midis gjenerimit specifik të mbetjeve bashkiake dhe gjenerimit të mbetjeve inerte në këto vende. Bazuar në këtë krahasim për Shqipërinë supozohet një normë gjenerimi e MNP prej 289 kg/person/vit. Sipas përllogaritjeve rreth 80 për qind e mbetjeve është inerte dhe pjesa tjetër janë mbetje të tjera nga ndërtimet dhe prishjet që mund të riciklohen ose depozitohen së bashku me mbetjet e ngurta bashkiake.

Të dhënat e INSTAT për popullsinë në Berat gjatë viteve të kaluara tregon që ka pasur një rënie të numrit të popullsisë në qark. Me uljen e numrit të popullsisë, ndërtimet e reja do të kufizohen dhe supozohet që sasia e mbetjeve nga gërmimet do të jetë po ashtu e ulët.

Duke marrë për bazë normën specifike të gjenerimit të mbetjeve për secilën bashki, sasitë e mbetjeve inerte në Qarkun Berat për vitin 2018 janë përllogaritur dhe paraqiten në figurën e mëposhtme. Sasia totale e mbetjeve inerte nga ndërtimet dhe prishjet llogaritet të ketë qenë 31,603 tonë në 2018.




**Figura 10 Sasitë e mbetjeve inerte nga ndërtimet dhe prishjet në bashkitë e Qarkut Berat, të përllogaritura për vitin 2018**

Këtu vlen të përmendet se për shkak të projekteve të mëdha individuale të ndërtimit, sasia e mbetjeve inerte mund të ndryshojë ndjeshëm. Krahas kësaj, sasi të mëdha mbetjesh inerte prodhohen gjatë përpunimit të mermerit dhe gurit gëlqeror.

Në përgjithësi, prodhuesi i mbetjeve (pra, ndërtuesi ose kompania e ndërtimit) është përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet (MNP) të prodhuara nga aktivitetet private të ndërtimit. Ndërmarrjet private janë të detyruara t'i transportojnë MNP në një vend depozitim të caktuar ose të kontraktojnë një operator privat për ta përmbushur këtë detyrim. Bashkitë mbledhin vetëm MNP që prodhohen nga projektet publike të ndërtimit dhe janë përgjegjëse të sigurojnë vende për mbajtjen e tyre dhe vend depozitime për mbetjet inerte. Para se të marrë lejen e ndërtimit, subjekti privat duhet të depozitojë një garanci financiare, e cila do t'i kthehet nëse mbetjet inerte nga aktivitetet e ndërtimit janë depozituar ashtu siç duhet në vendet e përcaktuara.

Bashkitë në Qarkun Berat kanë përcaktuar vendndodhjet për depozitimin e mbetjeve inerte, siç listohen në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 12 Vendndodhjet e vend depozitimeve për mbetjet inerte të përcaktuara nga bashkitë**

| Bashkia | Vend depozitim për mbetjet inerte | Sipërfaqe | Statusi |
|---|---|---|---|
| Berat | (408801.94 m E, 4511081.33 m N) | ~2,000 m² | Nuk është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. |
| Kuçovë | Lagjia nr.1 Blloku “11 Janari”<br>Gropat e bitumit, ish-Uzina e Përpunimit të Petrolit<br>(E 34T0407860; S UTM 4818183) | 17,200 m² | Krijuar në 2000 me urdhër të brendshëm të kryetarit të bashkisë<br>Nuk ka leje mjedisore |
| Poliçan | Lagjja PLIREZ<br>(422400.00 m E; 4496630.00 m N) | 1,926 m² | Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 45 datë 21.09.2016 |
| Skrapar | Përroi i Pilipizgës<br>(E 517185.35, N 5586205.74) | ~10,000 m² | Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 64, datë 16.12.1998 |
| Ura Vajgurore | Lagjja "28 Nëntori"<br>(E 405745 N 4513670) | ~4,000 m² | Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak No.31, dated 17.05.2016, konfirmuar nga Prefektura Berat nr. 1096 prot, datë 07.06.2016 |

# 3 Planifikimi i menaxhimit rajonal të mbetjeve

## 3.1 Supozimet bazë për planifikimin

### 3.1.1 Aktivitete rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve

Në përgjithësi, bashkitë janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë disa elementë të menaxhimit të përparuar të mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë për të funksionuar me efiçencë kostoje. Për rrjedhojë, është i nevojshëm bashkëpunimi midis bashkive në një formë të ashtuquajtur "rajonalizim". Dallimi midis aktiviteteve rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve, i paraqitur më poshtë, është identifikuar në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake dhe është rikonfirmuar gjatë diskutimeve me Ekipin e Kompetencave:

- Rajonale:
    - Transferimi dhe transporti në distancë të largët (pas transferimit)
    - Trajtimi kompleks i mbetjeve të paricikluеshme fundore (p.sh. TMB dhe incinerim)
    - Vend depozitimet sanitare
- Vendore:
    - Fshirja e rrugëve dhe grumbullimi i mbetjeve
    - Grumbullimi i diferencuar dhe përpunimi i materialeve të riciklueshme dhe mbetjeve organike
    - Vend depozitimet për mbetjet nga ndërtimet (mbetje inerte)
    - Rehabilitimi i vendgrumbullimeve

Ky PRMM krijon një koncept për komponentët e ardhshëm rajonalë të MMN dhe ofron udhëzime për komponentët vendorë. Koncepti i detajuar dhe plani i zbatimit për aktivitetet vendore janë pjesë e Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve të bashkive.

Detajet e masave rajonale do të shtjellohen më tej në një Studim Fizibiliteti pasi të merret miratimi i këtij PRMM.

### 3.1.2 Bashkëpunimi me Zonat e tjera të Mbetjeve për menaxhimin rajonal të mbetjeve

Master Plani për Menaxhimin e Mbetjeve Bashkiake (shihni kapitullin 1.3.3.2) propozon që territori i Qarkut Berat të jetë një Zonë e Menaxhimit të Mbetjeve më vete me zgjidhjen e

vet rajonale të asgjësimit të mbetjeve, përkatësisht një vend depozitim sanitar rajonal. Për shkak të distancave të largëta të transportit, përveç vend depozitimit sanitar janë planifikuar dy stacione transferimi, një në Çorovodë dhe një tjetër në Poliçan. Pas ngritjes së një sistemi rajonal për menaxhimin e mbetjeve, propozohet që në fazën e ardhshme të zbatohet një impiant trajtimi mekanik-biologjik me teknologji kompostimi.

Sidoqoftë, përveç realizimit të impianteve për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve në Qarkun Berat, një alternativë tjetër është transportimi i mbetjeve në një impiant trajtimi/ asgjësimi në Zonat e tjera të mbetjeve, si psh në Zonën e Mbetjeve Fier (incineratori i Fierit), Zona e Mbetjeve Elbasan (incineratori i Elbasanit) ose në Zonën e Mbetjeve Vlorë Veri (vend depozitimi i Sherishtës). Harta e mëposhtme paraqet distancat e transportit nga qendrat e bashkive deri në impiantet e tjera alternative për trajtimin/ asgjësimin e mbetjeve jashtë qarkut. Distancat e transportit dhe kohëzgjatjet përkatëse të listuara në tabelën në hartë janë përllogaritur nga qyteti i Beratit, duke qenë se është prodhuesi më i madh i mbetjeve në rajon.




**Figura 11 Distancat e transportit drejt impianteve të trajtimit/ asgjësimit të mbetjeve jashtë Qarkut Berat**

Siç shfaqen në hartën e distancave të transportit, Incineratori i Fierit ndodhet rreth 57 km nga qyteti i Beratit, ndërsa incineratori i Elbasanit dhe vend depozitimi i Sherishtës (Vlorë) janë pothuajse dy herë më larg nga qyteti i Beratit krahasuar me incineratorin e Fierit. Meqë distancat më të largëta sjellin kosto transporti më të larta, nga këto alternativa jashtë qarkut, dërgimi i mbetjeve në incineratorin e Fierit do të ishte më pak e kushtueshme (sa i përket kostove të transportit) krahasuar me incineratorin e Elbasanit dhe vend depozitimin e Sherishtës në Vlorë.

Incineratori i Fierit është ndërtuar dhe funksionon me një kontratë koncesioni, të financuar nga qeveria shqiptare për një periudhë koncesioni prej 7 vjetësh, e vlefshme deri në 2023. Aktualisht nuk është e qartë se si dhe me çfarë kushte do të vazhdojë funksionimi pas periudhës së koncesionit. Për rrjedhojë, kostot e ardhshme (tarifa hyrëse) për trajtimin në incineratorin e Fierit nuk dihen.

Përveç kësaj, Incineratori i Fierit është projektuar për sasitë e mbetjeve që prodhohen në bashkitë e Qarkut Fier. Tani nuk është e qartë nëse do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të pranuar edhe mbetjet nga Qarku Berat.

Për shkak të këtyre pasigurive dhe kostove të larta të transportit, është parashikuar një zgjidhje e pavarur për Qarkun Berat, e cila sërish u rikonfirmua nga Ekipi i Kompetencave për Projektin e MIMN në Berat (me praninë e MTM dhe MIE) në Prill 2019.

Gjithsesi, trajtimi i mbetjeve të Qarkut Berat në incineratorin e Fierit mund të jetë një alternativë në të ardhmen, për shembull në rast se do të jetë e pamundur të zbatohen zgjidhje të pavarura brenda Qarkut Berat.

### 3.1.3 Parashikimi i numrit të popullsisë

Siç është përmendur më lart në kapitullin 2.2, në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake (draft), është zhvilluar një metodologji për parashikimin e numrit të popullsisë dhe sasisë së mbetjeve. Grafiku i mëposhtëm përmban rezultatet e parashikimit të popullsisë për bashkitë e Qarkut Berat deri në vitin 2042.




| | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 | 2031 | 2032 | 2033 | 2034 | 2035 | 2036 | 2037 | 2038 | 2039 | 2040 | 2041 | 2042 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Berat | 6809 | 6729 | 6651 | 6575 | 6501 | 6429 | 6358 | 6289 | 6222 | 6156 | 6092 | 6029 | 5968 | 5909 | 5851 | 5794 | 5738 | 5684 | 5632 | 5580 | 5530 | 5481 | 5433 | 5387 | 5342 |
| Kuçovë | 3655 | 3612 | 3570 | 3529 | 3489 | 3450 | 3412 | 3374 | 3338 | 3302 | 3267 | 3233 | 3200 | 3167 | 3135 | 3104 | 3074 | 3044 | 3015 | 2987 | 2959 | 2932 | 2905 | 2880 | 2854 |
| Poliçan | 1230 | 1211 | 1193 | 1174 | 1156 | 1139 | 1122 | 1105 | 1088 | 1072 | 1056 | 1040 | 1025 | 1010 | 9957 | 9812 | 9670 | 9531 | 9394 | 9259 | 9128 | 8998 | 8871 | 8746 | 8624 |
| Skrapar | 1327 | 1302 | 1278 | 1254 | 1230 | 1207 | 1185 | 1163 | 1141 | 1120 | 1099 | 1079 | 1059 | 1039 | 1020 | 1001 | 9828 | 9646 | 9468 | 9294 | 9123 | 8955 | 8790 | 8629 | 8470 |
| Ura Vajgurore | 2940 | 2905 | 2871 | 2838 | 2806 | 2774 | 2744 | 2714 | 2685 | 2657 | 2629 | 2602 | 2576 | 2550 | 2525 | 2501 | 2478 | 2455 | 2432 | 2410 | 2389 | 2369 | 2349 | 2329 | 2310 |

**Figura 12 Parashikimi i popullsisë për Qarkun Berat (2018 – 2042)**

Duke pasuar numrin në rënie të popullsisë gjatë viteve të kaluara, parashikimi i popullsisë për vitet e ardhshëm paraqitet me një rënie, nga 159,629 banorë në vitin 2018 në 122,169 banorë në 2042.

### 3.1.4 Parashikimi i sasisë së mbetjeve

Në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake, është përgatitur një parashikim për sasitë e mbetjeve që do të prodhohen dhe grumbullohen në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, përfshi edhe bashkitë e Qarkut Berat.

Parashikimi i prodhimit dhe grumbullimit të mbetjeve bazohet në shifrat e parashikimit të popullsisë. Në llogaritje, merren për bazë sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve për lloje të ndryshme vendbanimesh në tabelën e mëposhtme. Përkufizimi i llojeve të vendbanimeve për secilën njësi administrative është në përputhje me publikimin: Shqipëria – Tipologjia e komunave dhe bashkive (INSTAT, 2014).

**Tabela 13 Sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit**

| Njësia Administrative | Llojet e vendbanimeve[6] | Lloji N° | Gjenerimii mbetjeve [kg/pers/d] |
|---|---|---|---|
| **Urbane** | | | |
| Berat | Kryeqytete me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, > 35,000 banorë) | 12 | 1.1 |
| Çorovodë, Kuçovë | Qendër lokale, (qendra e rrethit, jo bashkime qendrash, < 20,000 banorë) | 14 | 0.7 |
| Otllak, Perondi | Suburban (jashtë zonës metropolitane Tiranë-Durrës) | 23 | 0.55 |
| Ura Vajgurore | | 24 | 0.55 |
| **Rurale** | | | |
| Bogovë, Poliçan | Njësi vendore jo urbane me aktivitete miniera ose energji | 32 | 0.55 |
| Velabisht, Poshnjë | Zona fushore të përziera bujqësore | 41 | 0.4 |
| Cukalat, Kozarë, Kutalli, Lumas | Bujqësore në zona fushore | 43 | 0.4 |
| Çepan, Roshnik, Sinjë, Gjerbës, Leshnjë, Potom, Qendër Skrapar, Tërpan, Vendreshë, Vërtop, Zhepë | Ekonomi bujqësore në zonat malore | 44 | 0.4 |

6 Llojet e vendbanimeve bazohen në Tipologjia e Komunave dhe Bashkive, të publikuar nga INSTAT. Shihni INSTAT: Tipologjia e Komunave dhe Bashkive Shqiptare; Maj 2014.

Meqë sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve të supozuara për person në ditë janë tashmë në kufirin më të lartë të sasive specifike mesatare krahasuar me vende të tjera të krahasueshme, pritet që të mos ketë ndryshime ose vetëm ndryshime të vogla në sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve për kohështrirjen e planit. Për të thjeshtuar llogaritjen është supozuar që sasitë specifike të mbetjeve në secilin tip strukture të vendbanimit do të mbeten të pandryshuara.

Bazuar në gjenerimin specifik të mbetjeve të supozuar dhe në zhvillimin e supozuar të popullsisë janë llogaritur sasitë e mbetjeve që do të prodhohen. Në tabelën e mëposhtme, paraqitet parashikimi i gjenerimit të mbetjeve për secilën bashki në Qarkun Berat. Sipas parashikimit, mbi 50% e sasisë së mbetjeve do të prodhohet në Bashkinë Berat (qyteti i Beratit).

**Tabela 14 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve për Qarkun Berat (2018 – 2042)**

| Viti | Sasia e mbetjeve të prodhuara [t/vit] | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | B. Berat | B. Kuçovë | B. Poliçan | B. Skrapar | B. Ura Vajgurore | Total |
| **2018** | 21,090 | 9,154 | 2,062 | 2,477 | 4,719 | **39,503** |
| **2019** | 20,843 | 9,047 | 2,030 | 2,431 | 4,663 | **39,015** |
| **2020** | 20,603 | 8,942 | 1,999 | 2,385 | 4,609 | **38,538** |
| **2021** | 20,367 | 8,839 | 1,969 | 2,341 | 4,556 | **38,072** |
| **2022** | 20,138 | 8,739 | 1,939 | 2,297 | 4,504 | **37,616** |
| **2023** | 19,914 | 8,640 | 1,909 | 2,254 | 4,454 | **37,171** |
| **2024** | 19,695 | 8,544 | 1,881 | 2,212 | 4,405 | **36,736** |
| **2025** | 19,481 | 8,451 | 1,852 | 2,171 | 4,357 | **36,312** |
| **2026** | 19,273 | 8,359 | 1,825 | 2,130 | 4,310 | **35,897** |
| **2027** | 19,069 | 8,270 | 1,797 | 2,091 | 4,265 | **35,491** |
| **2028** | 18,871 | 8,182 | 1,771 | 2,052 | 4,220 | **35,095** |
| **2029** | 18,677 | 8,097 | 1,744 | 2,014 | 4,177 | **34,709** |
| **2030** | 18,488 | 8,013 | 1,719 | 1,976 | 4,135 | **34,331** |
| **2031** | 18,303 | 7,932 | 1,693 | 1,940 | 4,094 | **33,962** |
| **2032** | 18,123 | 7,852 | 1,669 | 1,904 | 4,054 | **33,601** |
| **2033** | 17,947 | 7,774 | 1,644 | 1,868 | 4,015 | **33,249** |
| **2034** | 17,776 | 7,698 | 1,621 | 1,834 | 3,977 | **32,905** |
| **2035** | 17,608 | 7,624 | 1,597 | 1,800 | 3,940 | **32,570** |
| **2036** | 17,445 | 7,551 | 1,574 | 1,767 | 3,905 | **32,242** |
| **2037** | 17,286 | 7,480 | 1,552 | 1,734 | 3,870 | **31,921** |
| **2038** | 17,130 | 7,411 | 1,530 | 1,702 | 3,836 | **31,609** |
| **2039** | 16,979 | 7,343 | 1,508 | 1,671 | 3,803 | **31,303** |
| **2040** | 16,831 | 7,277 | 1,487 | 1,640 | 3,770 | **31,005** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2041** | 16,687 | 7,212 | 1,466 | 1,610 | 3,739 | **30,714** |
| **2042** | 16,546 | 7,149 | 1,445 | 1,581 | 3,709 | **30,430** |

Si rezultat i rënies së pritshme të numrit të popullsisë, do të zvogëlohen edhe sasitë e mbetjeve që do të prodhohen gjatë këtyre viteve. Mesatarisht, sasitë e mbetjeve do të ulen me 1% në vit, pra pritet që në fund të kohështrirjes së planit të prodhohen rreth 20% më pak mbetje.

Sasitë e mbetjeve që do të grumbullohen përllogaritet të jenë si në grafikun më poshtë. Aktualisht (2018), shërbimi i grumbullimit të mbetjeve nuk arrin në të gjithë fshatrat e njësive administrative të qarkut. Si rezultat i përmirësimit dhe shtrirjes së mbulimit me shërbime MMN në vitet e ardhshëm, pritet të rritet sasia e mbetjeve të grumbulluara në zonat malore. Në përgjithësi, parashikohet që sasia e mbetjeve të grumbulluara të ulet paksa për shkak të prirjes së popullsisë për të emigruar në rajonet e tjera të vendit ose jashtë vendit.




**Figura 13 Parashikimi i sasive të mbetjeve që do të grumbullohen deri në 2033**

Duke marrë në konsideratë përbërjen e mbetjeve të paraqitur në kapitullin 2.3.1, në grafikun e mëposhtëm është paraqitur një përllogaritje se si do të zhvillohen sasitë e fraksioneve potenciale të mbetjeve të grumbulluara.




**Figura 14 Parashikimi i sasive të mbetjeve të grumbulluara sipas materialeve përbërëse**

## 3.2 Përcaktimi i objektivave

Në pajtueshmëri me planifikimin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë siç paraqiten në Kapitullin 1.4, objektivi kyç për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Berat është caktuar si më poshtë:

**Minimizimi i efekteve negative të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis**

Në këtë aspekt, menaxhimi i mbetjeve do të kryhet pa vënë në rrezik shëndetin e njerëzve dhe pa dëmtuar mjedisin dhe në veçanti:

d) Pa rrezikuar ujin, ajrin, tokën, bimët ose kafshët;

e) Pa shkaktuar prishje të qetësisë publike me anë të zhurmave ose aromave të rënda; dhe

f) Pa ndikuar negativisht peizazhin jashtë qendrave të banuara ose vendeve me interes të veçantë.

Brenda territorit të qarkut Berat do të ngrihet një rrjet objektesh për menaxhimin e mbetjeve, në të cilat do të trajtohen dhe depozitohen të gjitha mbetjet e prodhuara në

qark. Ky rrjet objektesh do të sigurojë kapacitete të mjaftueshme për asgjësimin e mbetjeve në periudhë afatgjatë.

Në fazën e parë të PRMM, duhet t'i jepet prioritet sigurimit të kushteve higjienike bazë, pra një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për popullatën. Për këtë arsye, prioriteti më i lartë duhet t'i jepet përmirësimit të grumbullimit dhe depozitimit të sigurt, të ndjekur nga përmirësimi i riciklimit dhe kompostimit dhe më pas nga realizimi i impianteve komplekse të trajtimit.

Menaxhimi rajonal i mbetjeve do të zhvillohet në faza; investimet madhore në fazat më të avancuara duhet të merren vetëm pasi të jenë zbatuar me sukses fazat më të hershme. Kjo qasje e ndarë në faza propozon tre faza të njëpasnjëshme:

Faza 1: grumbullimi i mbetjeve, transporti dhe depozitimi i sigurt; ndërmarrja e nismave për angazhimin e bashkive në riciklim

Faza 2: sisteme gjithëpërfshirëse për riciklimin dhe kompostimin

Faza 3: impiante komplekse për trajtimin e mbetjeve.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të përmbledhura objektivat e draft SKMIM (korrik 2019) të marrë në konsideratë për përgatitjen e PRMM për periudhat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

**Tabela 15 Objektivat e draft SKMIM (Korrik 2019) ku është bazuar përgatitja e PRMM**

| Objektivat | | Synimet | Afatshkurtër 2019-2023 | Afatmesme 2023-2028 | Afatgjatë 2028-2033 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit** | | | | | |
| OS 1 | Planifikimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet në bazë të zonave të mbetjeve duke ofruar shërbim për të gjithë popullatën | Ngritja e sistemit për dokumentimin, menaxhimin dhe raportimin e të dhënave mbi menaxhimin e mbetjeve | ✓ | ✓ | ✓ |
| | | Studim Fizibiliteti për ZMM Berat | ✓ | | |
| | | Hartimi dhe miratimi i Planeve të Bashkive për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve[7] | ✓ (të gjitha bashkitë) | ✓ (përditësim) | ✓ (përditësim) |
| OS 2 | Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve ka mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në mënyrë të integruar në përputhje me standardet e BE | Mbulimi me shërbimin e grumbullimit (i popullsisë) | 80% | 90% | 95% |
| | | Norma e grumbullimit (të mbetjeve të prodhuara) | 70% | 90% | 95% |
| | | Mbulimi me shërbimin MIMN[8] (total)<br>(në zonat urbane >100,000 banorë) | 20%<br>10% | 25%<br>20% | 30%<br>30% |
| | | % e sasisë së mbetjeve (për secilën rrymë) që shkon për riciklim/ sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara | 20% | 30% | 49% |
| | | Sasia e mbetjeve të biodegradueshme reduktohet (krahasuar me sasinë në 2016) | to 75% | to 55% | to 35% |
| | | % e sasisë së mbetjeve që depozitohen në vend depozitim sanitar ose vendgrumbullime / sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara | 75% | 55% | 35% |
| | | Impiante të ngritura për grumbullimin e diferencuar të MNP[7] | 1 | 3 | 5 |

[7] Këto synime janë nxjerrë nga synimet e përcaktuara në draft SKMIM, por të konvertuara në nivel rajonal dhe të përshtatura me situatën e Qarkut Berat.

[8] Menaxhimi i integruar i mbetjeve përkufizohet në draft amendimin (Korrik 2019) të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 si grumbullimi, transporti, rikuperimi (përfshirë ndarjen) dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikqëyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit

| Objektivat | | Synimet | Afatshkurtër 2019-2023 | Afatmesme 2023-2028 | Afatgjatë 2028-2033 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ngritja e sistemit (rajonal) për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve në zbatim të hierarkisë së mbetjeve[7] | ✓ | | |
| | | Rehabilitimi dhe mbyllja e vendgrumbullimeve[7] | 3 | 12 | 23 |
| | | Fondi vjetor për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve i alokuar në buxhetin bashkiak për MMN | >5% | | |
| OS 3 | Krijimi i një sistemi për menaxhimin e integruar të rrymave të tjera të mbetjeve jo-bashkiake, i cili bazohet në hierarkinë e mbetjeve | % e mbetjeve inerte të grumbulluara që kalojnë në impiantet e trajtimit dhe ripërdoren | 30% | 50% | 80% |
| | | Ngritja e qendrave pritëse për materialet e riciklueshme dhe të ripërdorshme nga bashkitë | 5 | | |
| **Qëllimi strategjik 2: Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve** | | | | | |
| OS 4 | Kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është përmirësuar dhe harmonizuar me Direktivat Evropiane dhe është ngritur një sistem institucional efikas në nivel kombëtar | Rregulloret e menaxhimit të integruar të mbetjeve miratohen në nivel bashkiak | ✓ | | |
| **Qëllimi strategjik 3: Financimi i qendrueshëm i menaxhimit të mbetjeve** | | | | | |
| OS 5 | Burimet financiare për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikohen në planifikimin buxhetor afatmesëm të miratuar me ligj | Përllogaritje e kostos së plotë të shërbimit, nevojave të tjera financiare dhe tarifës për gjithë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve nga ana e bashkive | ✓ | | |
| | | Tarifimi i kostos së plotë të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve | ✓ | ✓ | ✓ |
| | | Përcaktimi i sistemit të tarifave nga bashkitë | | ✓ | |
| | | Buxheti bashkiak i alokuar/ nevojat për financim | 80% | 90% | 95% |

| Objektivat | | Synimet | Afatshkurtër 2019-2023 | Afatmesme 2023-2028 | Afatgjatë 2028-2033 |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Të ardhurat nga mbledhja e tarifave / totali i kostove të shërbimit | 80% | 90% | 100% |
| | | Tarifat e mbledhura / shuma e faturuar | 80% | 90% | 100% |
| | | Mbulimi i kostove për transferimin e mbetjeve dhe trajtimin e tyre në qendrat e trajtimit përfundimtar & depozitimit nga ana e bashkive | 30% | 50% | 80%/100% |
| **Qëllimi strategjik 4: Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve** | | | | | |
| OS 7 | Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të bashkive dhe institucioneve qendrore të mandatuara me MIM | Ngritja e njësive mjedisore (MMN) me staf prej 3 anëtarësh në secilën bashki | ✓ | | |
| | | Trajnim për stafin bashkiak të njësisë për MMN | ✓ | ✓ | ✓ |
| OS 8 | Qytetarët përdorin dhe respektojnë infrastrukturën e mbetjeve dhe bëhen pjesë e masave për përmbushjen e objektivave të planeve vendore | Planet hartohen nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje | 100% | 100% | 100% |
| | | % e numrit të banorëve që ndan mbetjet në burim / % e popullsisë që mbulohet me grumbullimin e diferencuar | 30% | 50% | 80% |
| | | Bashkitë ndërmarrin çdo vit fushata pastrimi | 5 | 5 | 5 |
| | | Shkollat zbatojnë kurrikula edukimi për mbetjet | 100% | 100% | 100% |
| | | Shkollat zbatojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve | 50% | 70% | 95% |
| **Qëllimi strategjik 5: Janë ngritur instrumentet ligjorë, institucionalë dhe financiarë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme** | | | | | |
| OS 9 | Janë identifikuar të gjitha rrymat e mbetjeve të rrezikshme që janë prodhuar apo prodhohen në territorin e vendit nga sektori publik dhe ai privat | Bashkitë raportojnë mbi rrymat e mbetjeve të rrezikshme | | >70% | |
| | | % e MNP që shmangen nga depozitimi në vend depozitim | >30% | >50% | >70% |
| | | Sasia e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të grumbulluara nga familjet veçmas | | | >4 kg/person/vit |

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare, do të zbatohet në mënyrë progresive parimi "ndotësi paguan" për të arritur një mbulim të plotë të kostos me anë të tarifave të përdoruesve në periudhë afatgjatë. Gjithashtu, siç planifikohet në draft SKMIM, nën sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (PZP) që do të ngrihet për disa nga rrymat e mbetjeve që i përkasin rrymës së MNB, një pjesë e barrës financiare do të transferohet nga bashkitë dhe taksapaguesit në përgjithësi tek prodhuesit dhe konsumatorët e produkteve. Meqë sistemet PZP ka më shumë mundësi të ngrihen në nivel kombëtar, sistemet rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve do të mbështetin, sa më shumë të jetë e mundur, përshtatjen e këtyre sistemeve në Qarkun Berat.

Për të arritur këto objektiva dhe synime, janë përcaktuar planet e veprimit duke marrë parasysh hierarkinë e mbetjeve.

## 3.3 Teknologjitë dhe metodat e planifikuara për menaxhimin e ardhshëm rajonal të mbetjeve

Minimizimi i efekteve negative të prodhimit dhe menaxhimit të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis është synimi kryesor i këtij Plani Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve. Alternativat teknike dhe organizative për të arritur këtë qëllim mund të ndahen më tej në parandalimin dhe reduktimin e mbetjeve, grumbullimin, transportimin dhe transferimin, trajtimin dhe riciklimin, depozitimin e mbetjeve dhe rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve. Masa shoqëruese si fushatat e ndërgjegjësimit publik janë përfshirë në nënkapitujt përkatës.

### 3.3.1 Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve

Parandalimi i mbetjeve qëndron në krye të hierarkisë së mbetjeve pasi ai është çelësi për një menaxhim të qendrueshëm të mbetjeve, si një nga objektivat e këtij plani, nëpërmjet ruajtjes së burimeve natyrore dhe energjitike si edhe minimizimit të kostove dhe ndikimeve mjedisore të menaxhimit të mbetjeve.

Siç paraqitet në figurën e mëposhtme, parandalimi i mbetjeve mund të realizohet në faza të ndryshme. Nga njëra anjë, parandalimi i mbetjeve mund të arrihet nëpërmjet reduktimit të sasisë së materialit që përdoret për krijimin e produkteve dhe rritjes së efiçencës me të cilën përdoren këto produkte, pasi krijohen. Siç specifikohet në draft SKMIM, kjo lloj ndërhyrjeje do të realizohet sapo të ngrihen sistemet e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit.




**Figura 15 Ilustrimi i përkufizimit të parandalimit të mbetjeve[9]**

Në nivel vendor, konsumatorët publikë dhe privatë do të ndihmojnë në parandalimin e mbetjeve me anë të ndryshimit të zakoneve të tyre të konsumit dhe me anë të ripërdorimit të produkteve.

Plani i parandalimit të mbetjeve për Qarkun Berat parashikon veprimet e mëposhtme:

- **Ofrimin e programeve të trajnimit për autoritetet kompetente**: Para zhvillimit të aktiviteteve për parandalimin e mbetjeve, do të garantohet që stafet përkatëse të operatorëve publikë dhe privatë të shërbimit kanë marrë trajnimin e duhur dhe të mjaftueshëm si personat përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e programeve të parandalimit të mbetjeve dhe si përhapës të tyre. NJQV-të e Qarkut Berat do të përfitojnë nga mundësitë e krijuara nëpërmjet zbatimit të projekteve të financuara nga donatorët. Ato do të vënë në dispozicion stafin për programet e trajnimit dhe do të garantojnë që njohuritë e fituara të përcillen tek brezat e ardhshëm.
- **Zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit:** me fushata intensive ndërgjegjësimi, vëmendja e publikut do të tërhiqet tek ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve.

[9] Përgatitja e një programi për parandalimin e mbetjeve, Dokument udhëzues, EC DG Environment, 2012

Fushatat do të fokusohen në rryma specifike mbetjesh dhe do të ofrojnë udhëzime praktike dhe të thjeshta se si të zbatohen veprimet për parandalimin e mbetjeve. Duke qenë se ndërgjegjësimi mjedisor i popullatës në qark është relativisht i ulët, fushatat do të japin informacion mbi rreziqet që shkakton keqmenaxhimi i mbetjeve (situata ekzistuese) si edhe mbi përfitimet e sistemeve moderne të menaxhimit të mbetjeve.

- **Dhënia e informacionit për teknikat e parandalimit të mbetjeve**: bashkitë e qarkut së bashku me ndërmarrjen e ardhshme rajonale të menaxhimit të mbetjeve do të vënë në dispozicion informacion kushtuar teknikave të parandalimit të mbetjeve për grupe specifike përdoruesisht, si p.sh. bizneset, industritë, familjet dhe institucionet. Metodat për shpërndarjen e informacionit për parandalimin e mbetjeve do të përfshijnë ndër të tjera edhe portalet informative online (faqet elektronike të NJQV dhe kompanive të menaxhimit të mbetjeve, faqe elektronike specifike për llogaritjen ose mjetet e planifikimit) dhe/ose qendra informacioni (linjë telefonike, konsultime individuale, konsultime në terren, etj.)
- **Promovimi i ripërdorimit dhe riparimeve**: NJQV do të inkurajojnë ripërdorimin dhe riparimin e orendive apo pajisjeve shtëpiake duke ngritur qendra ripërdorimi dhe riparimi në territorin e tyre. Kjo përfshin edhe krijimin e qendrave për dhurimin e objekteve dhe organizimin e qendrave çlodhëse të kombinuara me shërbime riparimi.
- **Zbatimi i politikave të gjelbra të prokurimeve publike**: NJQV dhe njësitë e qeverisë do të marrin në konsideratë përfshirjen e kriterit të parandalimit të mbetjeve në thirrjet e tyre për tendera dhe kontrata, sa më shumë të jetë e mundur brenda rregullave kombëtare të prokurimeve publike. Në këtë aspekt, aty ku është e mundur, duhet të theksohet zgjatja e jetëgjatësisë dhe riparimi i produkteve të blera dhe të merret parasysh si mundësi blerja e mallrave të përdorur.

Meqë bashkitë e vogla mund të mos kenë fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e një programi për parandalimin e mbetjeve, do të ngrihet një qendër e specializuar për parandalimin e mbetjeve, p.sh. nën varësinë e ndërmarrjes së ardhshme rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Vëllimi dhe sasia e mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet është e barabartë me sasinë e të gjithë mbetjeve të tjera bashkiake. Meqë sasia e MNP për pikë prodhimi është shumë më e lartë se sasia e mbetjeve bashkiake për pikë prodhimi, masat parandaluese mund të zbatohen më lehtësisht dhe në mënyrë më efektive. Duke e integruar parandalimin e mbetjeve që në fillim të planifikimit të një ndërtimi ose prishjeje, sasitë e MNP mund të reduktohen në masë të konsiderueshme. Në këtë drejtim, bashkitë do të inkurajojnë projekte me jetëgjatësi më të madhe dhe përdorimin e materialeve të ndërtimit që mund të

zëvendësohen dhe/ose të riciklohen pasi plotësohet koha e përdorimit të tyre. Gjithashtu gjatë punimeve të ndërtimit, ripërdorimi i mjeteve ndihmëse të ndërtimit si kallëpët e betonit ose mbulesat, do të ndihmonin në shmangien e prodhimit të MNP. Ri-përdorimi i materialeve mbron burimet dhe përmirëson efiçencën ekonomike të punimeve të ndërtimit. Gjatë prishjes së godinave, materialet duhet të grumbullohen veçmas, në mënyrë që materialet e ricikluеshme të mund të ndahen nga materialet e tjera të paricikluеshme dhe në këtë mënyrë të ketë sa më pak nevojë për të depozituar mbetje.

### 3.3.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve

#### 3.3.2.1 Grumbullimi i mbetjeve të ngurta bashkiake të përziera

Për të siguruar një standard minimal bazë të shërbimeve MMN, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve duhet të përmirësohen. Kjo do të ketë fokusin kryesor gjatë fazës së parë të zbatimit/ afatshkurtër. Një nga synimet kryesore të draft SKMIM është shtrirja e shërbimeve të grumbullimit deri në:

- 80% e popullsisë ose grumbullimi i 70% të mbetjeve të prodhuara në periudhën afatshkurtër (deri në 2023);
- 90% e popullsisë ose grumbullimi i 90% të mbetjeve të prodhuara në periudhën afatmesme (deri në 2028); dhe
- 95% e popullsisë ose grumbullimi i 95% të mbetjeve të prodhuara në periudhën afatgjatë (deri në 2033).

Megjithëse norma e përgjithshme e grumbullimit të mbetjeve në qark është relativisht e lartë, në zonat rurale, veçanërisht ato malore, shërbimet e grumbullimit të mbetjeve hasin pengesa për shkak të gjendjes së keqe të rrugëve që nuk lejon qarkullimin e kamionëve të grumbullimit për të arritur tek fshatrat e largët. Për këtë arsye, së bashku me përmirësimin e kushteve të infrastrukturës së transportit, bashkitë do të shtrijnë shërbimet e grumbullimit në fshatrat ku qarkullimi i këtyre mjeteve është i mundur.

Metodat për grumbullimin e mbetjeve duhet të marrin për bazë kushtet lokale, si prodhimin e mbetjeve, strukturën e vendbanimeve dhe gjendjen e rrugëve. Metodat e mundshme për grumbullimin e mbetjeve paraqiten në figurën e mëposhtme.




**Figura 16 Metodat e mundshme të grumbullimit**

Në grumbullimin derë-më-derë, mbetjet mblidhen direkt nga ambientet e prodhuesit të mbetjeve. Kjo metodë grumbullimi krijon një pronësi të qartë për mbetjet dhe paraqet mundësinë më të mirë për të aplikuar tarifimin individual (sipas parimit ndotësi paguan). Megjithatë, kjo metodë kërkon që të ketë më shumë hapësirë në ambientet e prodhuesve dhe mund të mos jetë e përshtatshme për zonat e vendbanimeve me shumë ndërtesa të larta, si në qendrat urbane. Për më tepër, kostoja operative është më e lartë për shkak të të pasurit më shumë kontenierë/ mbajtëse më të vogla që duhen zbrazur dhe të distancave më të mëdha që duhet të përshkojnë mjetet e grumbullimit të mbetjeve.

Metoda e grumbullimit në një pikë është praktika më e përhapur në Qarkun Berat. Mbetjet çohen nga prodhuesit tek pikat e grumbullimit që janë kryesisht kontenierë 1.1 m³. Kjo metodë nuk tregon pronësinë e mbetjeve, megjithatë, kërkon më pak hapësirë dhe ka kosto operative më të ulëta sesa grumbullimi derë-më-derë.

Sisteme të ndryshme grumbullimi mund të nevojiten për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike dhe materialeve të riciklueshme. Veçanërisht për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike nga familjet dhe restorantet do të nevojitej grumbullimi derë-më-derë. Për këtë arsye, sistemi më i përshtatshëm për grumbullimin e diferencuar duhet të përcaktohet sipas rastit.

Përzgjedhja e mjeteve të grumbullimit të mbetjeve duhet bërë sipas metodës, sasisë së mbetjeve dhe karakteristikave të tyre, sipas strukturës së vendbanimeve, hapësirës në

dispozicion, gjendjes së rrugëve dhe sipas teknologjisë së përdorur dhe mundësive që ka në qark për mirëmbajtjen e pajisjeve të veçanta.

Për kamionë kompaktorë (teknologjikë) të grumbullimit të mbetjeve zakonisht përdoren mekanizma ngritës. Një kamion kompaktor mund të arrijë norma të larta ngjeshjeje dhe për rrjedhojë mund të grumbullojë më shumë mbetje gjatë një rruge krahasuar me p.sh. kamionët me karroceri të sheshtë.




**Figura 17 Kamion kompaktor me vëllim 7 m³**

Sidoqoftë mund të ketë kushte ku kamionët kompaktorë nuk janë të përshtatshëm, p.sh. në rrugët në gjendje të keqe të zonave malore. Në këtë rast një zgjidhje më e mirë do të ishte me kamionët vetëshkarkues. Ka kamionë vetëshkarkues të pajisur me mekanizëm ngritës, të cilët gjithashtu mund të gjenden të tipit me katër rrota aktive, të përshtatshme për gjendjen e rrugëve në zonat malore.



**Figura 18 Shembull i një kamioni vetëshkarkues me shasi 8.5 t (i mundshëm edhe si 4x4)**

Sipas kërkesave lokale, sistemet e paraqitura më sipër mund të zbatohen edhe në kombinim me njëri-tjetrin.

Kërkesat e një sistemi modern për menaxhimin e mbetjeve do të jenë më të larta se kërkesat e sistemit të tanishëm. Për këtë arsye, është thelbësore që shërbimet e grumbullimit të planifikohen në një mënyrë të qendrueshme me efiçencë dhe efektivitet të lartë, jo vetëm në zonat ku do të shtrihet shërbimi, por edhe në të gjitha zonat ekzistuese. Për këtë qëllim, bashkitë e qarkut:

- Do të bëjnë një analizë të alternativave për të përcaktuar zgjidhjen më të përshtatshme për secilën zonë grumbullimi bazuar në kushtet lokale,
- Do të përgatitin plane të detajuara për grumbullimin e mbetjeve dhe pastrimin e rrugëve,
- Do të përcaktojnë standardet për të siguruar efiçencë financiare dhe operative,
- Do të përcaktojnë rregullat për mbikëqyrjen, monitorimin dhe raportimin,
- Do të përllogaritin burimet e nevojshme (stafi, mjetet, kontenierët, etj.) dhe kostot në bazë të planit të detajuar dhe rregulloreve kombëtare,
- Do të ngrejnë sistemet e monitorimit financiar dhe të performancës,
- Do të ngrejnë sistemet e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe do të garantojnë që pajisjet të jenë gjithmonë në gjendje pune,

- Do të përgatitin kontrata shërbimi duke pasur parasysh hapat e lartpërmendur, në rastin e kontraktorëve privatë,
- Do të monitorojnë në mënyrë aktive aktivitetet operative dhe do të rishikojnë planin e grumbullimit, nëse është e nevojshme ose të paktën një herë në vit,
- Do të ndërmarrin fushata ndërgjegjësimi për të motivuar banorët që të marrin pjesë në mënyrë aktive në sistemin e grumbullimit të mbetjeve (shfrytëzimi i kontenierëve, oraret e grumbullimit të mbetjeve, shmangia e përhapjes së mbetjeve në hapësirat publike, etj.),
- Do të caktojnë një përgjegjës për marrëdhëniet me publikun për të mbajtur kontakte të përhershme me qytetarët dhe bizneset.

Duke marrë parasysh projektet që janë duke u zbatuar për infrastrukturën rajonale të menaxhimit të mbetjeve, kontratat e shërbimit duhet të përpilohen me një farë fleksibiliteti për të mundësuar përshtatjen e tyre pasi të vendosen në punë qendrat e ardhshme rajonale.

### 3.3.2.2 Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të thata të riciklueshme përfshirë mbetjet nga ambalazhet

Zbatimi i sistemeve të grumbullimit të diferencuar është një nga masat e parashikuara në draft SKMIM (Korrik 2019) për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve në mënyrë të integruar në përputhje me standardet e BE. Draft SKMIM (Korrik 2019) ka përcaktuar synimet e mëposhtme në lidhje me grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme dhe riciklimin:

**Tabela 16 Synimet kombëtare për rikuperimin e mbetjeve (Draft SKMIM, Korrik 2019)**

| Treguesit e matjes | Synimet | | |
|---|---|---|---|
| | 2023 | 2028 | 2033 |
| % e popullsisë që mbulohet me shërbimin e MIM | 20% | 25% | 30% |
| % e popullsisë në qytetet me më shumë se 100,000 banorë (zonat urbane) që mbulohen me shërbimin MIM | 10% | 20% | 30% |
| % e sasisë së mbetjeve (për secilën rrymë) që shkon për riciklim / sasia totale e mbetjeve të prodhuara në ton në vit | 20% | 30% | 49% |
| % e mbetjeve të rikuperuara nga mbetjet bashkiake kundrejt totalit të mbetjeve nga paketimet të rikuperueshme | 10% | 28% | 57% |
| % e sasisë së mbetjeve nga ambalazhet që rikuperohen në nivel bashkie kundrejt prodhimit total | Jo më pak se 10% | Jo më pak se 30% | Jo më pak se 60% |

Për të realizuar synimet e paraqitura në tabelën më sipër dhe në pajtim me objektivat e këtij plani (angazhimi i bashkive për riciklimin dhe sisteme gjithëpërfshirëse për riciklimin dhe kompostimin), bashkitë do të fillojnë t'i grumbullojnë veçmas materialet e thata të riciklueshme me disa projekte pilot në fillim të periudhës së zbatimit, do të testojnë modele të ndryshme për grumbullimin e diferencuar dhe do ta shtrijnë skemën e suksesshme në një territor më të madh.

Për grumbullimin e diferencuar të materialeve të thata të riciklueshme duhet të merren në konsideratë metodat e mëposhtme:

- Ngarkimi i kontraktorëve privatë me përgjegjësinë për të zbatuar grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme.
  Meqë katër bashki i ofrojnë shërbimet MMN nëpërmjet kontraktorëve privatë, përgjegjësia për të zbatuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme mund të përfshihet në kontratat e shërbimit, ndërkohë që bashkitë janë përgjegjëse për zhvillimin e konceptit, lehtësimin e komunikimit midis aktorëve kryesorë dhe monitorimin e zbatimit të skemës së grumbullimit të diferencuar. Në kontratë, kontraktorëve gjithashtu mund t'u lihet mundësia të caktojnë kompani të tjera për të kryer aktivitetin e grumbullimit të diferencuar.
- Bashkëpunimi me bizneset private ricikluese
  Bizneset e riciklimit janë gjithashtu të interesuara të mbledhin materialet e thata të riciklueshme të ndara në burim me qëllim që të rritet sasia dhe cilësia e tyre. Bashkitë mund të ndërtojnë bashkëpunime me biznesin privat të riciklimit dhe të diskutojnë për rolin dhe kontributin e bizneseve të riciklimit në skemën e grumbullimit të diferencuar.
- Grumbullimi i diferencuar i materialeve të riciklueshme në bashkëpunim me sektorin informal dhe/ose OJF
  Bashkitë ku tashmë është i pranishëm sektori informal për grumbullimin e materialeve të thata të riciklueshme do të diskutojnë mundësitë e bashkëpunimit. Për shembull, bashkitë mund të instalojnë mbajtëse me rrjetë teli në qytet për mbledhjen e shisheve PET dhe kanaçeve dhe sektori informal mund t'i marrë materialet e grumbulluara. Bashkitë gjithashtu do të shqyrtojnë mundësinë e bashkëpunimit me organizata aktive në veprimtaritë mjedisore për masat e grumbullimit të diferencuar dhe në organizimin e fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit për t'i informuar dhe për t'i motivuar banorët të marrin pjesë në mënyrë aktive në skemat e grumbullimit të diferencuar. Gjithashtu, OJQ mund të jetë një partner i rëndësishëm bashkëpunimi për të mbështetur integrimin e sektorit informal të mbetjeve në skemën bashkiake të grumbullimit të diferencuar.
- Qendrat e grumbullimit
  Në skemat e veçanta me qendra grumbullimi, prodhuesit e mbetjeve i çojnë

materialet e riciklueshme tek qendra dhe marrin një shumë të caktuar si shpërblim bazuar në sasinë e materialeve të dorëzuara. Kjo metodë është tërheqëse për prodhuesit e mbetjeve pasi përfitimi i drejtpërdrejtë mund t'i motivojë ata t'i ndajnë mbetjet në burim. Megjithatë, ky sistem rrezikon të mos funksionojë në mënyrë ekonomike për shkak të varësisë nga vlera e tregut e materialeve të riciklueshme dhe reduktimi i të ardhurave nga shitja e materialeve mund të reduktojë fondet për programin e shpërblimeve. Për rrjedhojë, ky sistem kërkon planifikim të kujdesshëm sidomos lidhur me mundësitë e financimit. Subvencionimi i vazhdueshëm nëpërmjet buxhetit bashkiak ose fondeve të donatorëve / kompanive private (fondi i Përgjegjësisë Sociale të Kompanisë) janë shpesh elementë të qenësishëm të këtyre programeve.

- Impiantet e Rikuperimit të Materialeve (IRM) / Impiante për ndarjen e mbetjeve
  Ndarja sipas llojit e materialeve të riciklueshme nëpërmjet skanimit dhe teknikave të ndarjes është një alternativë tjetër për të rikuperuar materialet e riciklueshme. Teknologjitë variojnë nga ndarja e thjeshtë me dorë deri në teknologjitë komplekse të mekanizuara. Do të ishte më e preferueshme që bashkitë të ndërtonin qendra për ndarjen e mbetjeve në bashkëpunim me sektorin privat.

Duke pasur parasysh situatën aktuale në qark ku grumbullimi i diferencuar dhe riciklimi zhvillohen kryesisht në formën e nismave të vogla dhe ende nuk është krijuar kultura e riciklimit, synimet e BE për grumbullimin e diferencuar do të arrihen mbase brenda një periudhe më të gjatë kohore. Për këtë arsye, bashkitë:

- Do të fillojnë në periudhën afatshkurtër me **projekte fillestare pilot** për mbledhjen e materialeve të thata të riciklueshme të ndara dhe do të testojnë modele të ndryshme të grumbullimit të diferencuar. Një koncept zbatimi përfshirë një analizë financiare do të përgatiten paraprakisht ndërkohë që shqyrtohen strukturat ekzistuese të riciklimit dhe praktika të mira nga projekte të tjera në Shqipëri. Koncepti do të jetë realist, do të marrë në konsideratë aspektet socio-ekonomike dhe fizibilitetin sa i përket nivelit të ndërgjegjësimit të banorëve, por veçanërisht edhe tregun ekzistues për materialet e riciklueshme të mbledhura veçmas.
- Do të inkurajojnë integrimin dhe formalizimin e sektorit informal në skemën e grumbullimit të diferencuar.
- **Do të vlerësojnë** skemën e shpërndarjes së projekteve pilot dhe nëse është e nevojshme ta rishikojnë atë.
- **Do të shtrijnë** hap pas hapi në një zonë më të madhe skemat e zbatuara me sukses duke synuar mbulimin e plotë të të gjitha familjeve në zonat urbane në skemën e grumbullimit të diferencuar në periudhën afatmesme (deri në 2028).

- Do të përfshijnë institucionet arsimore, si shkollat, për zbatimin e aktiviteteve pilot për grumbullimin e diferencuar si edhe zbatimin e masave për rritjen e ndërgjegjësimit.

Masat për grumbullimin e diferencuar do të jenë pjesë e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve.

Mbetjet nga ambalazhet janë pjesë e mbetjeve të thata të ricikluesh me. Sipas draft SKMIM, industria e ambalazheve do të propozojë një Master Plan për Mbetjet e Ambalazheve deri në vitin 2020, i cili të specifikojë se si do të merret përsipër organizimi dhe përgjegjësia financiare për menaxhimin e mbetjeve nga ambalazhet. Gjithashtu në draft SKMIM përcaktohet se do të duhet të ngrihet një sistem për transfertat financiare midis industrisë së ambalazheve dhe bashkive. Kështu në varësi të realizimit të këtij sistemi të PZP në Shqipëri, bashkitë do të bashkëpunojnë edhe me sektorin privat të përfshirë në sistemin e ardhshëm të PZP për t'i mbledhur mbetjet e ambalazheve brenda të njëjtës skemë grumbullimi të diferencuar për materialet e thata të ricikluesh me.

### 3.3.2.3 Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të biodegradueshme

Mbetjet e biodegradueshme përfshijnë çdo lëndë organike që gjendet në mbetjet e ngurta bashkiake si mbetjet e gjelbra (nga kopshtet) dhe mbetjet ushqimore.

Draft SKMIM përcakton si synim që deri në 2023, 20% e sasisë së mbetjeve të çdo rryme të shkojë për riciklim, 30% deri në 2028 dhe 49% deri në 2033, e cila ka të bëjë edhe me rrymën e mbetjeve të biodegradueshme.

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike dhe marketimi i produkteve është një nga aktivitetet më sfiduese të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, sidomos lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve në ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar dhe pranimin e kompostit nga përdoruesit e fundit. Duke marrë parasysh synimet kombëtare dhe këtë sfidë, synimi për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të biodegradueshme është përcaktuar në masën 10% të mbetjeve të mbledhura deri në 2023 dhe 15% deri në 2028. Kjo sasi duhet të rritet deri në 25% në të gjitha bashkitë, deri në 2032. Për t'i arritur këto objektiva, bashkitë do të fillojnë të zbatojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të biodegradueshme fillimisht me projekte pilot dhe më pas ta zgjerojnë skemën gradualisht në një shkallë më të madhe.

Grumbullimi i diferencuar do të fillojë me materiale që janë më të thjeshta për t'u mbledhur, si mbetjet e gjelbra, e më pas do të përfshijë materialet e tjera.

Për të fituar eksperiencën e parë me grumbullimin e diferencuar dhe aktivitetet e kompostimit, bashkitë inkurajohen të fillojnë nisma të vogla në periudhën afatshkurtër, si p.sh projekte pilot për kompostimin e mbetjeve të gjelbra.

Krahas kësaj duhet të inkurajohet kompostimi vetjak në kopshtin e shtëpisë, veçanërisht në zonat rurale dhe popullata duhet të marrë udhëzime që mbetjet e gjelbra të mos i hedhë në kontenierët publikë të mbetjeve.

Si hap i parë, këshillohet grumbullimi i mbetjeve të gjelbra komunale dhe tregtare të prodhuesve të mëdhenj (kopshtarë, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra). Po ashtu, në dyqane duhet të vendosen kosha të veçantë për mbetjet organike. Më pas, grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike mund të shtrihet edhe në materiale e prodhues të tjerë, në bazë të eksperiencës së fituar.

Në secilën bashki do të ngrihet dhe mirëmbahet të paktën një vendndodhje për kompostimin e mbetjeve të gjelbra.

#### 3.3.2.4 Transporti i mbetjeve

Me ndërtimin e qendrave rajonale të trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve, mbetjet e mbledhura të përziera do të transportohen drejt tyre. Rrjedhimisht, për transportimin me efiçencë kostoje të mbetjeve të mbledhura deri në qendrën e trajtimit ose depozitimit përfundimtar, veçanërisht në rastin e distancave të largëta, mund të shqyrtohet mundësia e një stacioni për transferimin e mbetjeve. Kur distanca që përshkojnë kamionët e grumbullimit është më e madhe se 30 km, përdorimi i një stacioni transferimi ka avantazhe përkundër alternativës me transport të drejtpërdrejtë. Për mjetet më të vogla, ky kriter është edhe më i ulët. Harta e mëposhtme paraqet distancat e transportit midis bashkive në Qarkun Berat.




**Figura 19 Distancat e transportit midis bashkive**

Për të lehtësuar (optimizuar) transportimin, qendra rajonale e depozitimit duhet të ndodhet (afër) ose në qendrën e gjenerimit të mbetjeve (zonat me gjenerimin më të lartë të mbetjeve) siç tregohen në figurën e mësipërme.

Sipas propozimit të Master Planit për Menaxhimin e Mbetjeve Bashkiake, zbatimi i stacioneve të transferimit për distanca më të mëdha se 30 km mund të jetë i nevojshëm. Duke marrë parasysh këtë kriter, Master Plani propozon zbatimin e dy stacioneve të transferimit; një në Bashkinë Skrapar dhe një tjetër në Bashkinë Poliçan.

Studimi i Fizibilitetit që duhet të kryhet në kuadër të Projektit "Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Shqipëri, Faza I" do të vlerësojë nevojën për zbatimin e dy apo më shumë stacioneve të transferimit në varësi të vendndodhjes së përzgjedhur për vend depozitimin rajonal. Të gjitha stacionet e transferimit do të ngrihen deri në 2023 dhe do të jenë në punë në fazën e dytë të zbatimit/ afatmesme, duke filluar nga 2023, së bashku me vend depozitimin rajonal.

Alternativat më të zakonta dhe të mundshme të transportit në Shqipëri janë transporti i mbetjeve me kontenierë të mëdhenj të hapur nga sipër, pa ngjeshje, ose në kontenierë të mbyllur kompaktorë, me ngjeshjen e mbetjeve.

Ngarkimi direkt i mbetjeve pa ngjeshje



Ngarkimi direkt i mbetjeve me ngjeshje



**Figura 20 Parimet e stacioneve të transferimit me ngarkim direkt pa ngjeshje dhe me ngjeshje[10]**

Ngjeshja e mbetjeve mund të bëhet me presa të palëvizshme ose me njësi kompaktore që i ngjitet gjysëm-rimorkios ose kontenierit të transportueshëm (roll-on/off). Kontenierët e ndryshueshëm, si kontenierët e transportueshëm (roll-on/off) ofrojnë fleksibilitetin maksimal dhe janë një teknologji e testuar me kosto të ulëta investimi dhe operative. Avantazhi i këtij sistemi është që kamioni transportues mund të mbajë disa kontenierë dhe t'u shërbejë disa stacioneve të transferimit. Për shkak të dizenjos së tyre të përshtatshme, i njëjti kamion mund të transportojë kontenierë të përmasave dhe llojeve të ndryshme, p.sh. kontenierë për MNP. Nëse kushtet e rrugës janë të përshtatshme, këta kamionë mund të transportojnë edhe një kontenier shtesë mbi rimorkio.

Është e arsyeshme që mbetjet të ngjishen para se të transportohen, nëse dendësia fillestare e mbetjeve është e ulët. Për mbetjet fundore të paricikluesshme (ose mbetjet bashkiake të përziera) në Qarkun Berat, duhet llogaritur një dendësi e lartë, për shkak të pjesës së madhe që zënë mbetjet organike. Pra, nuk janë të nevojshme kostot shtesë të investimit dhe operative për ngjeshjen e mbetjeve. Veç kësaj, njësitë kompaktore shpesh

[10] https://www.zaoe.de

pësojnë defekte dhe kjo rrezikon punën në stacionin e transferimit krahasuar me një stacion transferimi pa njësi kompaktore.

Stacionet e transferimit mund të jenë pjesërisht ose plotësisht të mbyllura ose të funksionojnë në ambiente të hapura. Ndërtimi i godinave do të mundësonte kontrollin e emetimeve, por njëkohësisht do të shoqërohej me kosto më të larta investimi dhe operative.

Duke patur parasysh kushtet lokale në rajon, rekomandohet që në Qarkun Berat transferimi i mbetjeve të realizohet nëpërmjet stacioneve të transferimit me rampë, pa ngjeshje dhe pjesërisht të mbuluar për të shmangur lagien e mbetjeve gjatë procesit të transferimit në mot me rreshje. Në figurat më poshtë paraqitet shembulli i një stacioni transferimi me rampë, pa ngjeshje, në Ersekë, Qarku Korçë.



**Figura 21 Stacion transferimi me rampë në Ersekë, Qarku Korçë**

Koncepti i zbatimit të transferimit të mbetjeve për bashkitë e qarkut do të shtjellohet më tej në Studimin e Fizibilitetit për këtë PRMM.

### 3.3.3 Trajtimi i mbetjeve

#### 3.3.3.1 Synimet për trajtimin e mbetjeve

Qëllimi i trajtimit të mbetjeve është të reduktojë ndikimet mjedisore të mbetjeve dhe të reduktojë humbjen e materialeve të vlefshme dhe të dobishme. Trajtimi përfshin:

a) Ndarjen (dhe përpunimin) e materialeve të riciklueshme ose nga mbetjet e përziera ose nga ato të grumbulluara veçmas

b) Trajtimi i komponentëve organikë

Me anë të trajtimit të mbetjeve pas grumbullimit dhe para depozitimit mund të pakësohen sasitë e mbetjeve që duhet të shkojnë në vend depozitim. Draft SKMIM (Korrik 2019) përcakton këto synime për reduktimin e sasive të mbetjeve të grumbulluara që depozitohen:

- 70% e sasisë së mbetjeve të grumbulluara shkon në vend depozitim deri në vitin 2023
- 55% e sasisë së mbetjeve të grumbulluara shkon në vend depozitim deri në 2028
- 35% e sasisë së mbetjeve të grumbulluara shkon në vend depozitim deri në 2033

#### 3.3.3.2 Alternativat e trajtimit të mbetjeve

Për trajtimin e mbetjeve bashkiake, janë të mundshme alternativat më poshtë:

- **Impiant për rikuperimin e mbetjeve të përziera (IRM e papastër)**

Për trajtimin e mbetjeve të ngurta bashkiake mund të ndërtohet një impiant për rikuperimin e materialeve (IRM). Mund të dallohen dy lloje të IRM-ve, përkatësisht IRM e papastër për mbetjet e përziera dhe IRM e pastër për fraksionin e materialeve të thata të riciklueshme të grumbulluara veçmas (përzierje mbetje letre, kartoni, plastike, qelqi dhe metali).

Në IRM e papastër, përbërësit e rrymës së përzierë të mbetjeve ndahen me dorë dhe/ ose me teknika ndarjeje mekanike si sitja apo tërheqja me magnet. Rryma e mbetjeve ndahet në materiale të riciklueshme dhe mbetje fundore të paricklueshme për t'u asgjesuar ose përpunuar më tej. IRM e pastra përpunojnë vetëm mbetje të riciklueshme që janë ndarë që në burim. Këto materiale të riciklueshme mund të përmbajnë qelq, plastikë, letër dhe karton dhe metale. Në mënyrë të ngjashme me IRM e papastër, ato ndahen duke

përdorur makineri të ndryshme sipas rezultatit të kërkuar. Materiali i veçuar përpunohet më pas për riciklim të mëtejshëm në një impiant tjetër trajtimi.

Në IRM përdoret një gamë e gjerë teknologjish, nga ato më të thjeshtat deri në proceset tërësisht të mekanizuara. Me rritjen e nivelit të teknologjisë do të rriten kostot e investimit fillestar, ndërsa do të reduktohet numri i punëtorëve për ndarjen manuale. Për këtë arsye për të vendosur rreth teknologjive të preferuara duhet të merren në konsideratë kushtet kornizë, si sasitë dhe llojet e mbetjeve, materialet e riciklueshme që duam të veçojmë, kostot e krahut të punës, etj. Edhe kur projektet e IRM klasifikohen si teknologji bazë, ka nevojë për menaxhimin me përvojë, monitorimin dhe kontrollin e cilësisë për të garantuar një performancë të mirë. Funksionimi efiçent dhe tregtimi i suksesshëm i materialeve të riciklueshme të ndara kanë një ndikim të madh në bilancin e përgjithshëm të kostove të impiantit.

- **Kompostimi (Rikuperimi i materialit)**

Kompostimi është një proces stabilizimi aerobik i substancave organike. Ka disa teknologji të ndryshme kompostimi, duke filluar me kompostimin e thjeshtë në pirgje, në kavaleta të hapura me ajrosje pasive, në kavaleta ku kthimi i kompostit bëhet me makineri të posaçme ose fadromë, kompostimi me ajrosje aktive e deri në impiante të mbyllura krejtësisht të automatizuara.

Përmasat e rekomandueshme të impiantit (kapaciteti) dhe kostot përkatëse të stabilizimit aerobik varen nga lloji i teknologjisë që përdoret. Kompostimi i thjeshtë në kavaleta pa ajrosje aktive është zgjidhja më pak e kushtueshme e përshtatshme për impiante shumë të vogla kompostimi; kostot për sistemet e automatizuara plotësisht të mbyllura zakonisht janë disa herë më të larta. Për rrjedhojë, këto sisteme janë të rekomandueshme vetëm për një kapacitet të caktuar (> 10,000 tonë/vit). Këto të dytat, megjithatë kanë avantazhe të qarta sa i përket nevojës për hapësira dhe kontrollit të emetimeve. Nga ana tjetër, kompostimi me kavaleta të hapura nuk rekomandohet për trajtimin e mbetjeve ushqimore dhe të kuzhinës. Për të shmangur apo zvogëluar emetimet e aromave dhe lëngut kullues, si edhe përhapjen e mizave, shpendëve dhe brejtësve, preferohen zgjidhjet e mbuluara ose të mbyllura.

Një parakusht bazë për prodhimin e kompostit cilësor (i cili mund të tregtohet) është grumbullimi i diferencuar i bio-mbetjeve. Shpenzimet shtesë që nevojiten për këtë mund të kompensohen pjesërisht me anë të të ardhurave që do të nxirren nga shitja e kompostit.

- **Tretja anaerobike (Rikuperimi i materialit dhe energjisë)**

Tretja anaerobike (TA) është një proces stabilizimi i substancave organike. Sa i përket rikuperimit të energjisë dhe të materialit, synimet kryesore të TA të mbetjeve organike të grumbulluara veçmas janë prodhimi i biogazit (prodhimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë) dhe prodhimi i një plehu organik për të rritur pjellorinë e tokës. Synime të tjera janë stabilizimi i përmbajtjes organike të mbetjeve për të reduktuar si sasinë e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme që çohen në vend depozitim ashtu edhe emetimet që çlirohen si pasojë e tyre. Një parakusht bazë për arritjen e këtyre synimeve është grumbullimi i diferencuar i bio-mbetjeve. Shpenzimet shtesë që nevojiten për këtë mund të kompensohen pjesërisht nga të ardhurat që mund të fitohen nga shitja e energjisë dhe e kompostit.

- **Trajtimi mekanik-biologjik (TMB, Rikuperimi i materialit dhe/ ose energjisë)**

Siç kuptohet nga vetë emri, është një proces trajtimi mekanik dhe biologjik. Faza e trajtimit mekanik mund të ketë qëllime të ndryshme, si p.sh. largimi i materialeve inerte ose papastërtive dhe përgatitja më pas për trajtimin biologjik, ndarja e materialeve të riciklueshme dhe/ose përgatitja e lëndës djegëse me prejardhje nga mbetjet (LDPM). Në fazën e trajtimit biologjik biomasa ose fraksioni "i kompostueshëm" përpunohet nëpërmjet tretjes anaerobike, kompostimit ose sistemit të bio-tharjes me qëllim reduktimin e masës, prodhimin e materialit të ngjashëm me kompost plehu, të biogazit dhe/ose LDPM, si dhe/ose stabilizimin e mbetjeve fundore. Figura më poshtë pasqyron hapat e proceseve dhe produktet e impianteve TMB.




**Figura 22 Hapat e proceseve dhe produktet e impianteve TMB**

- ## Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)

Incinerimi i mbetjeve nënkupton trajtimin termik të mbetjeve në mënyrë që të reduktohet vëllimi dhe rrezikshmëria e tyre dhe në të njëjtën kohë të kapë ose shkatërrojë substancat e dëmshme, të cilat çlirohen ose mund të çlirohen gjatë incinerimit dhe për të rikuperuar energji, përmbajtje minerale dhe/ ose kimike nga mbetjet. Si rezultat i këtyre proceseve, një impiant incinerimi konsiston në një bashkësi komplekse komponentësh teknikë ndërveprues.

Ka teknologji të ndryshme për djegien e mbetjeve: me skarë të lëvizshme, furrë rrotulluese, shtrat i fluidizuar, etj. Teknologjia më e zakontë dhe e testuar është djegia e masës në një skarë të lëvizshme ku mbetjet digjen në temperaturën 1,000ºC ose më

shumë mbi një skarë me fryrje ajri nga poshtë. Në Europë rreth 90% e pajisjeve që trajtojnë mbetjet e ngurta bashkiake përdorin skara.




| Waste receiving and storage | Grate combustion and boiler | Flue gas treatment | Energy utilization | Residue handling |
|---|---|---|---|---|
| 1 Tipping hall | 4 Feed hopper | 14 Electrostatic precipitator | 23 Extraction-condensation turbine | 29 Bottom ash extractor |
| 2 Waste bunker | 5 Ram feeder | 15 Sodium bicarbonate injection | 24 Air cooled condenser | 30 Bottom ash bunker |
| 3 Waste crane | 6 Hitachi Zosen Inova grate | 16 Fabric filter 1 | 25 District heating heat exchanger | 31 Bottom ash crane |
| | 7 Four-pass steam boiler | 17 SCR DeNOx | 26 Process steam extraction | |
| | 8 External Economiser | 18 Heat exchanger 1 | 27 Trafo | |
| | 9 Secondary air injection | 19 Fabric filter 2 | 28 Electricity Export | |
| | 10 Secondary air fan | 20 Induced draft fan | | |
| | 11 Recirculated flue gas injection | 21 Heat exchanger 2 | | |
| | 12 Recirculated flue gas fan | 22 Stack | | |
| | 13 Primary air fan | | | |

**Figura 23 Komponentët e një impianti për incinerimin e mbetjeve**[11]

### 3.3.3.3 Krahasimi i alternativave të identifikuara të teknologjisë

Tabela 17 paraqet një krahasim kualitativ të alternativave teknologjike për trajtimin e mbetjeve të përziera. Shkalla e vlerësimit sa i përket karakteristikave përkatëse është si vijon:

- Kërkesat institucionale: gjithëpërfshirëse – të pakta
- Kriteret teknike: ambicioze (teknologji e lartë) – të thjeshta (teknologji bazë)
- Rëndësia social-ekonomike: shumë domethënëse – pak të rëndësishme

[11] System diagram: Hitachi Zosen INOVA, http://www.hz-inova.com

- Ndikimet mjedisore: shumë domethënëse – pak të rëndësishme
- Veçoritë financiare: kosto për njësi të larta – kosto për njësi të ulëta

**Tabela 17 Krahasimi i alternativave teknologjike të identifikuara për trajtimin e mbetjeve të përziera**

| Mënyra e trajtimit të mbetjeve | Kërkesa institucionale | Kritere teknike | Rëndësia socio-ekonomike | Ndikimet mjedisore | Karakteristika financiare |
|---|---|---|---|---|---|
| Impiant për rikuperimin e materialeve (IRM) | | | | | |
| IRM e papastër | + | 0 | + | + | + |
| IRM e pastër | 0 | + | 0 | ++ | 0 |
| Trajtimi mekanik biologjik (TMB) | | | | | |
| TMB me tretje anaerobike | - | - | + | ++ | 0 |
| TMB me tharje biologjike (prodhimi i LDPM) | 0 | 0 | 0 | ++ | 0 |
| TMB me kompostim | + | + | - | 0 | + |
| Kompostimi (rikuperimi i materialit) | | | | | |
| Qendër kompostimi me kavaleta | + | + | 0 | + | 0 |
| Impiant kompostimi i mbyllur i automatizuar | 0 | 0 | + | ++ | - |
| Tretje anaerobike (Rikuperim energjie) | | | | | |
| Tretje anaerobike | - | - | + | ++ | - |
| Incinerimi i mbetjeve (rikuperim energjie) | | | | | |
| Incinerim me skarë të lëvizshme | - | - - | 0 | + | - - |

Sa i përket rëndësisë së fizibilitetit financiar, në tabelën e mëposhtme është paraqitur një përmbledhje me specifikimet kryesore të alternativave të prezantuara më sipër. Përmbledhja merr në konsideratë detajet e mëposhtme për secilën alternativë teknologjike:

- Parakushtet,
- Sasinë që kalon në proces: sasia minimale për të pasur funksionim ekonomik,
- Llojet e mbetjeve,
- Kostot specifike të investimit fillestar: që lidhen me gjithë sasinë vjetore që kalon në proces,

- Kostot specifike neto: që lidhen me sasinë vjetore që kalon në proces dhe gjithashtu të konvertuara për një sistem reference ku sasia e mbetjeve të grumbulluara është 50,000 t/vit[12],
- Ekonominë e shkallës: efektet e rritjes së sasisë së materialit që futet në proces, dhe
- Vërejtje (shpjegime).

[12] Kjo sasi mbetjesh është e barabartë me sasinë e mbetjeve në një bashki në Shqipëri me rreth 150,000 banorë që jetojnë pjesërisht në zona urbane dhe pjesërisht në zona rurale.

## Tabela 18 Përmbledhje e specifikimeve kyç të alternativave për trajtimin e mbetjeve të përziera

| Mënyra e trajtimit të mbetjeve | Parakushte | Sasia minimale që duhet të futet në proces për të qenë ekonomike)<br>* Fleksibël: Teknologjia mund të përshtatet me sasinë që futet në | Llojet e mbetjeve | Kosto specifike të investimit fillestar (lidhur me sasinë vjetore që përpunohet) | Investimi fillestar | Kosto specifike neto ** përfshi të ardhurat | | Ekonomia e shkallës (efektet e sasisë që hyn në përpunim) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Lidhur me sasinë vjetore që përpunohet | Konvertuar për një sistem reference me 30,000 t/vit | e ulët<br>e lartë | |
| **IRM e papastër** | Treg për materialet e riciklueshme | Fleksibël* | Mbetje bashkiake të përzjera | 75 EUR/t (30,000 t/vit) | 2,250,000 EUR | 8 EUR/t** | 8 EUR/t** | | Cilësia e materialeve të ricikluеshme e ulët krahasuar me IRM e pastër |
| **IRM e pastër** | Treg për materialet e ricikluеshme | Fleksibël* | Materiale të ricikluеshme të mbledhura veçmas | 120 EUR/t (10,000 t/vit) | 1,200,000 EUR | 5 EUR/t** | 1.67 EUR/t** | | Kosto shtesë për grumbullimin e diferencuar |
| **Qendër kompostimi me kavaleta** | Grumbullim i diferencuar i mbetjeve organike, treg për kompostin | Fleksibël* | Mbetje organike të mbledhura veçmas | 120 EUR/t (10,000 t/vit) | 1,200,000 EUR | 15 EUR/t** | 5 EUR/t** | | Duhet të merren parasysh kostot shtesë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike |
| **Impiant kompostimi i mbyllur i automatizuar** | Grumbullim i diferencuar i mbetjeve organike, treg për kompostin | > 10,000 t/vit | Mbetje organike të mbledhura veçmas | 220 EUR/t (10,000 t/vit) | 5,500,000 EUR | 40 EUR/t** | 13 EUR/t** | | Duhet të merren parasysh kostot shtesë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike |
| **Tretje anaerobike** | Grumbullim i diferencuar i mbetjeve organike, treg për kompostin | Fleksibël* | Mbetje organike të mbledhura veçmas | 275 EUR/t (10,000 t/vit) | 6,875,000 EUR | 50 EUR/t** | 17 EUR/t** | | Duhet të merren parasysh kostot shtesë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike |
| **TMB me tretje anaerobike** | Treg për produktet (Biogaz/ energji) | > 10,000 t/vit | Mbetje bashkiake të përzjera | 230 EUR/t (30,000 t/vit) | 6,900,000 EUR | 60 EUR/t** | 60 EUR/t** | | Kërkesa të larta për trajtimin anaerobik të mbetjeve bashkiake të përzjera |
| **TMB me tharje biologjike (LDPM)** | Treg për produktet (Lëndë djegëse me prejardhje nga mbetjet) | > 25,000 t/vit | Mbetje bashkiake të përzjera | 220 EUR/a (30,000 t/vit) | 6,000,000 EUR | 50 EUR/t** | 50 EUR/t** | | E realizueshme vetëm nëse ka kërkesë për LDPM |
| **TMB me kompostim** | Treg për produktet (komposti) | >10,000 t/vit | Mbetje bashkiake të përzjera | 150 EUR/t (30,000 t/vit) | 4,500,000 EUR | 35 EUR/t** | 35 EUR/t** | | Nevojitet sipërfaqe e madhe |
| **Incinerator me skarë të lëvizshme** | Një sistem të mirëmenaxhuar monitorimi mjedisor dhe të menaxhimit të mbetjeve, blerës për produktet (energji, nxehtësi) | > 50,000 t/vit | Mbetje bashkiake të përzjera | 650 EUR/t (50,000 t/vit) | 32,500,000 EUR | 120 EUR/t** | nuk aplikohet | | Impiant incinerimi me trajtim të thjeshtë të gazit të djegies dhe shfrytëzim të kombinuar të nxehtësisë dhe energjisë. Kostot bazohen në: Dokumentin Reference BREF për Incinerimin e Mbetjeve, EC, 2006. |

### 3.3.3.4 Qasja konceptuale për trajtimin e mbetjeve në Qarkun Berat

Bazuar në vlerësimin e alternativave të paraqitura në kapitujt e mëparshëm, qasja konceptuale për trajtimin e mbetjeve paraqitet për tre rryma të ndryshme mbetjesh

- Mbetje të riciklueshme të thata të mbledhura veçmas
- Mbetje organike të mbledhura veçmas
- Mbetje bashkiake të përziera

Trajtimi i mbetjeve të riciklueshme të thata të mbledhura veçmas

Në të gjitha bashkitë e Qarkut Berat, grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme të thata do të organizohet sipas kërkesave ligjore. Edhe në rastin e zbatimit të suksesshëm të grumbullimit të diferencuar do të ketë nevojë për ndarjen dhe përpunimin e mbetjeve të mbledhura, me qëllim

- Largimin e papastërtive (p.sh. në rastin kur mbetjet e paricklueshme hidhen në koshin e gabuar)
- Ndarjen e mbetjeve të riciklueshme sipas fraksioneve të ndryshme (sipas kërkesave të tregut)
- Përpunimin dhe paketimin për transport dhe tregtim

Ky trajtim mund të zbatohet në një IRM të pastër (një impiant ndarje ku trajtohen vetëm mbetjet e riciklueshme të thata që grumbullohen veçmas) ose në një IRM të papastër ku materialet e ndara në burim trajtohen në mënyrë të pavarur nga mbetjet e përziera, me anë të përpunimit në sasi të ndara.

Gjithsesi, supozohet që subjektet e sektorit privat do të marrin përsipër të merren me materialet e riciklueshme të mbledhura veçmas dhe të kryejnë më tej ndarjen dhe përpunimin brenda ambienteve të tyre. Krahas kësaj, bashkitë mund të zbatojnë aktivitete të thjeshta për ndarjen e mbetjeve në bashkëpunim me sektorin privat ose informal.

Gjithashtu, në përputhje me skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit që duhet të zbatohen, trajtimi i mbetjeve nga ambalazhet duhet të jetë përgjegjësi e prodhuesve të ambalazheve. Meqë mbetjet nga ambalazhet përbëjnë një pjesë të mbetjeve bashkiake të riciklueshme të thata, bashkitë do të bashkëpunojnë me skemat PZP, nëse këto do të jenë formuar, për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e mbetjeve. Deri atëhere, bashkitë e Qarkut Berat do të nxitin aktivitetet e trajtimit të mbetjeve të ambalazheve që kanë filluar të ndërmerren nga sektori privat dhe informal.

## Trajtimi i mbetjeve të biodegradueshme të grumbulluara veçmas

Duke marrë parasysh situatën aktuale ku kryhen shumë pak veprimtari për trajtimin e mbetjeve të biodegradueshme, zbatimi i tij do të fillojë me nisma të vogla, të cilat më pas do të zhvillohen në shkallë më të gjerë:

- Bashkitë do të mbështetin kompostimin vetjak në shtëpi për fraksionet e mbetjeve organike (afatshkurtër: 2019-2023)
  Qytetarëve do t'u ofrohen trajnime për kompostimin në shtëpi dhe do të shikohet mundësia për incentiva, për shembull në formën e reduktimit të tarifës së pastrimit.
- Bashkitë do të vënë në dispozicion një tokë me sipërfaqe të mjaftueshme dhe ta përgatitin atë për aktivitetin e kompostimit (afatshkurtër: 2019-2023). Hollësitë për aktivitetet e kompostimit që duhet të kryhen nga bashkitë do të vlerësohen gjatë Studimit të Fizibilitetit.
- Rrymat e përzgjedhura të mbetjeve organike do të grumbullohen veçmas dhe do të trajtohen në impiantet e përbashkëta të kompostimit, duke filluar si projekte pilot për kompostimin e mbetjeve të gjelbra me teknologji të thjeshta (një makineri coptuese të lëvizshme dhe sitë, një pajisje përzierëse të tërhequr me traktor, pajisje për ujitje) në mënyrë që kostot të mbahen në minimum. Pasi këto aktivitete kompostimi të zbatohen me sukses, mund të zgjerohen gradualisht në të njëjtën kohë me shtrirjen e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të biodegradueshme. (afatshkurtër: 2019-2023, afatmesme: 2023-2028)
- Mbetjet e biodegradueshme që mblidhen bashkë me mbetjet e përziera do të trajtohen në impiantin TMB që do të ngrihet më vonë (në fazën afatmesme: deri në 2028).

## Trajtimi i mbetjeve bashkiake të përziera

Avantazhet dhe disavantazhet kryesore të alternativave për trajtimin e mbetjeve bashkiake të përziera janë paraqitur në kapitullin 3.3.3.2 dhe kapitullin 3.3.3.3. Për të arritur synimet e ardhshme për rikuperimin e mbetjeve si edhe për reduktimin e sasisë së mbetjeve organike që depozitohet, IRM duhet të zbatohet së bashku me një alternativë trajtimi biologjik për gjithë rrymën e mbetjeve organike. Meqë grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike është një detyrë mjaft sfiduese, arritja e synimeve për reduktimin e mbetjeve organike vetëm me anë të grumbullimit të diferencuar të tyre nuk është realiste, madje as në periudhën afatgjatë. Për këtë arsye, në përputhje me synimet kombëtare (shihni kapitullin 3.2) trajtimi i mbetjeve bashkiake të përziera parashikohet të zbatohet gjatë Fazës 2 (deri në 2028).

Në Master Planin për Menaxhimin e Mbetjeve Bashkiake është parë mundësia e një impianti për trajtimin mekanik-biologjik për Qarkun Berat. Siç është përmendur më lart, një impiant incinerimi për trajtimin e mbetjeve vetëm të Qarkut Berat nuk është i mundur, pasi nuk mund të ketë funksionim ekonomik me sasitë e mbetjeve që prodhohen këtu. Alternativa për t'i trajtuar mbetjet e Qarkut Berat në incineratorin e Fierit është diskutuar në kapitullin 3.1.2.

Bazuar në këto shqyrtime, një impiant TMB duket si alternativa më e mirë për të zbatuar një metodë trajtimi komplekse për mbetjet në Qarkun Berat. Në përputhje me objektivat e këtij PRMM, zbatimi i një impianti trajtimi të tillë kompleks do të jetë i mundur në një fazë të mëvonshme, pasi të jenë siguruar shërbimet bazë të MMN, të jenë ngritur sisteme gjithëpërfshirëse për riciklimin dhe kompostimin dhe të jetë ndërtuar një sistem rajonal për MMN (me vend depozitim rajonal).

Në përgjithësi, TMB përfshin ndarjen e materialeve të riciklueshme dhe trajtimin/ stabilizimin e komponentëve organikë – megjithatë, ka alternativa të ndryshme teknike (shihni kapitullin 3.3.3.2). Kushtet kornizë që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit mund të ndryshojnë brenda viteve të ardhshme, pra situata e tregut për lëndë djegëse me prejardhje nga mbetjet, kostot e teknologjisë, pranimi i teknologjive nga popullata dhe vendimmarrësit, etj. Për këtë arsye, vendimi lidhur me teknologjinë e parapëlqyer TMB duhet të merret në fillim të Fazës II bazuar në zhvillimin e kushteve të ndryshme kornizë.

### 3.3.4 Asgjësimi i mbetjeve

#### 3.3.4.1 Synimet dhe fazat për përmirësimin e asgjësimit të mbetjeve

Sipas draft SKMIM (Korrik 2019), në Qarkun e Beratit do të ngrihet një sistem për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve në pajtim me hierarkinë e mbetjeve deri në 2023. Gjithashtu të gjitha vendgrumbullimet e vjetra duhet të rehabilitohen dhe të mbyllen deri në 2033.

Në përputhje me draft SKMIM, janë caktuar këto synime për Qarkun Berat:

- Sistemi rajonal MMN do të jetë ngritur dhe të fillojë të funksionojë deri në 2023.
- Të gjitha mbetjet bashkiake do të depozitohen në vendgrumbullime të kontrolluara në të gjitha bashkitë (2019-2023)
- 50% e vendgrumbullimeve në qark do të mbyllen dhe rehabilitohen deri në 2028
- Të gjitha vendgrumbullimet e qarkut do të mbyllen dhe rehabilitohen deri në 2033.

#### 3.3.4.2 Depozitimi i mbetjeve bashkiake të përziera (mbetjet e paricikluesHme)

Pavarësisht nga ndonjë zgjidhje për shmangien e mbetjeve, riciklimin dhe/ ose trajtimin e mbetjeve, do të mbetet sërish një sasi e caktuar mbetjesh të paricikluesHme fundore, që do të duhet të depozitohen në mënyrë të sigurt. Ndaj, zbatimi i një vend depozitimi sanitar është një element qendror i sistemit rajonal të MIMN, pasi ai duhet të sigurojë depozitimin e sigurt dhe në përputhje me kërkesat mjedisore të mbetjeve të ngurta.

Meqë e gjithë sasia e mbetjeve të paricikluesHme në Qarkun Berat është në kufirin e pranueshëm për të pasur funksionim ekonomik të një vend depozitimi sanitar modern do të duhet një vend depozitim rajonal (në vend të disa vend depozitimeve më të vegjël). Kjo është edhe konform VKM nr. 333 “Për menaxhimin e vend depozitimveve rajonale të mbetjeve urbane” (datë 26.01.2011). Një mundësi tjetër për depozitimin e mbetjeve është bashkëpunimi me zonat e tjera të mbetjeve. Siç përshkruhet në kapitullin 3.1.2 është rënë dakord që në fokus të jetë një zgjidhje rajonale për qarkun. Për këtë arsye, në përputhje me objektivin e këtij plani për të ngritur një sistem rajonal MMN, do të ndërtohen dhe do të vihen në punë deri në 2023 një vend depozitim sanitar rajonal dhe stacion(e) transferimi.

Deri sa objektet rajonale të jenë ndërtuar dhe sipas objektivit të këtij plani të kenë siguruar standardet bazë minimale të shërbimeve MMN, mbetjet e mbledhura do të depozitohen në vendgrumbullimet ekzistuese të bashkive, të cilat do të rehabilitohen dhe do të funksionojnë si vend depozitime të kontrolluara (në përputhje me VKM nr. 389).

Paralelisht me punimet rehabilituese, do të fillojë planifikimi i vend depozitimit të ri.

Llogaritja e kapacitetit të nevojshëm të vend depozitimit dhe rrjedhimisht sipërfaqja e nevojshme e terrenit do të bazohen në sasinë e përllogaritur të mbetjeve që do të depozitohen në periudhën nga 2023 deri në 2042 (për një periudhë prej 20 vjetësh).

Duke marrë parasysh masat e planifikuara për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e mbetjeve, sasia që duhet të depozitohet do të jetë e ndryshme nga totali i sasisë së mbetjeve të grumbulluara. Draft SKMIM synon të arrihet reduktimi në masën 25% i mbetjeve të grumbulluara që shkojnë në vend depozitim deri në vitin 2023, 45% deri në 2028 dhe 65% deri në 2033. Megjithatë, duke marrë për bazë situatën e tanishme ku nuk zhvillohet asnjë aktivitet për grumbullimin e diferencuar dhe aktivitetet e riciklimit janë shumë të kufizuara, synimi mund të mos arrihet brenda afatit. Ndaj, për të garantuar kapacitetin e ardhshëm për depozitimin e mbetjeve në qark, janë bërë supozimet e mëposhtme për të përllogaritur kapacitetin e nevojshëm:

- Sasitë e mbetjeve që duhet të depozitohen do të reduktohen me 1.5% çdo vit si rezultat i ripërdorimit, riciklimit dhe trajtimit

Kjo nënkupton që vend depozitimi sanitar duhet të projektohet për të pritur mesatarisht 27,000 tonë mbetje në vit ose 540,000 tonë mbetje gjithsej. Sipërfaqja minimale që duhet të ketë vend depozitimi llogaritet të jetë 8 ha. Meqë do të ishte e preferueshme që vendndodhja e impiantit të ardhshëm të trajtimit të ishte ngjitur me vend depozitimin, sipërfaqja e zonës duhet të jetë të paktën 10 ha.

Janë shqyrtuar vendet e mundshme për ndërtimin e vend depozitimit sanitar rajonal dhe rezultatet do të dokumentohen në raportin e përzgjedhjes së vendndodhjeve. Studime të mëtejshme të vendeve do të kryhen gjatë Studimit të Fizibilitetit.

Vend depozitimi sanitar rajonal do të jetë një vend depozitim për mbetje jo të rrezikshme dhe do të ndërtohet dhe funksionojë sipas standardeve të vlefshme të përcaktuara nga legjislacioni vendas (VKM nr. 389 dhe 452). Elementët kyç të vend depozitimit sanitar do të jenë

- Një bazament i përshtatshëm dhe një shtresë sipërfaqësore,
- Një rrethim dhe një portë,
- Një peshore dhe një zyrë për komandimin e peshores,
- Një sistem për grumbullimin dhe trajtimin e lëngut kullues,
- Një sistem për grumbullimin dhe trajtimin e gazit të vend depozitimit,
- Një sistem për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore,
- Mjete të lëvizshme të përshtatshme me kapacitete të mjaftueshme,
- Ndërtesa për administratën, akomodimin e stafit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

Investimi fillestar për ndërtimin e objekteve infrastrukturore, faza e parë e ndërtimit e vend depozitimit dhe prokurimi i mjeteve të lëvizshme do të jetë rreth 4.5 milion EUR (549 milion Lekë), duke supozuar që nuk ka shpenzime të tjera jo të zakonshme (si punime masive për ndërtime rrugësh ose punime dheu).

Funksionimi i vend depozitimit do të organizohet sipas standardeve të Shqipërisë dhe BE për të lejuar reduktimin e ndikimeve mjedisore dhe rritjen e performancës operative. Vend depozitimi do të punojë sipas një plani operativ, i cili përfshin udhëzime për:

- Pranimin dhe regjistrimin e mbetjeve

- Depozitimin e mbetjeve
- Grumbullimin dhe trajtimin e lëngut kullues
- Grumbullimin dhe trajtimin e gazit të vend depozitimit
- Mirëmbajtjen e pajisjeve dhe infrastrukturës
- Monitorimin mjedisor
- Monitorimin e performancës
- Menaxhimin financiar
- Shëndetin dhe sigurinë në punë
- Rastet e emergjencave dhe mbrojtja kundër zjarrit
- Menaxhimin e burimeve njerëzore
- Mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së vend depozitimit.

Struktura funksionale për drejtimin e punës në vend depozitim do të paraqitet në kapitullin 3.4.6. Pasi të miratohet PRMM do të përgatitet një Studim Fizibiliteti për të detajuar masat e Fazës II si edhe një Vlerësim për Ndikimin në Mjedis.

#### 3.3.4.3 Mbyllja dhe rehabilitimi i vendgrumbullimeve ekzistuese

Në përputhje me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, i cili rregullon rehabilitimin e vendgrumbullimeve ekzistuese, bashkitë janë të detyruara të dorëzojnë planet e rehabilitimit për vendgrumbullimet e tyre ekzistuese bashkiake. Në kuadër të Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat, Faza I janë përgatitur konceptet për rehabilitimin e vendgrumbullimeve kryesore bashkiake të bashkisë Berat, Bashkisë Kuçovë dhe Bashkisë Ura Vajgurore sipas udhëzimeve të VKM nr. 389, të cilat janë miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në 30 Maj 2019.

Tre vendgrumbullimet më të mëdha të mbetjeve planifikohet të rehabilitohen deri në fund të 2020 dhe të përmirësohen për të qenë në përdorim deri sa të jetë ndërtuar dhe vënë në punë një vend depozitim sanitar rajonal. Deri atëhere, në fazën e parë të zbatimit, për të arritur objektivin për të siguruar shërbimet bazë MMN sipas standardeve minimale, vendgrumbullimet e përmirësuara do të funksionojnë si vend depozitime të kontrolluara.

Në periudhën afatmesme (2023-2028) 20% dhe në atë afatgjatë (2029-2033) të gjitha vendgrumbullimet e qarkut do të mbyllen dhe do të rehabilitohen. Të gjitha mbetjet

bashkiake do të depozitohen vetëm në vend depozitimin sanitar rajonal. Studimi "Zbutja e Riskut në Vend depozitime"[13], i kryer nën drejtimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të programit DLDP të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC), ka identifikuar dhe analizuar vendgrumbullimet ekzistuese dhe gjendjen e tyre aktuale, si edhe ka propozuar masa për ndërhyrje në secilin vendgrumbullim të identifikuar. Harta e mëposhtme paraqet një pamje të vendgrumbullimeve ekzistuese të identifikuara nga studimi në Qarkun Berat sipas llojit të mbetjeve të depozituara.




**Figura 24 Vendndodhja e vendgrumbullimeve ekzistuese në Qarkun Berat**

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të vendgrumbullimeve të identifikuara dhe rekomandimet e dhëna në Raportin e Zbutjes së Riskut në Vend Depozitime.

**Tabela 19 Lista e vendgrumbullimeve të identifikuara në Nismën e Zbutjes së Riskut në**

[13] Burimi: Raporti Përfundimtar i Zbutjes së Riskut në Vend depozitime (Qershor 2018)

**Vend depozitime**[14]

| Nr. | Emri | Bashkia | Statusi | Lloji i mbetjeve të depozituara | Rekomandime në Raportin e Zbutjes së Riskut në Vend depozitime |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Vend depozitim 1 Dushnik | Berat | Ekzistues | Mbetje urbane | Mbyllje |
| 2 | Vend depozitim 2 Lagjja "Çlirim" | Berat | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 3 | Vend depozitim 3 Qendra "Lira" | Berat | Ekzistues | Mbetje urbane dhe inerte | Mbyllje |
| 4 | 1 – ish-ferma "Partizani" | Kuçovë | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 5 | 2 - Gropat e bitumit, ish-UPN | Kuçovë | Ekzistues | Mbetje inerte | Rehabilitim |
| 6 | Vend depozitim 1 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje urbane | Largimi i mbetjeve |
| 7 | 2 - Lagjja PLIREZ | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Rehabilitim |
| 8 | 3 - Lagjja PLIREZ | Poliçan | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 9 | Vend depozitim 4 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 10 | Vend depozitim 5 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 11 | Vend depozitim 6 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 12 | Vend depozitim 7 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 13 | Vend depozitim 8 | Poliçan | Ekzistues | Mbetje inerte | Largimi i mbetjeve |
| 14 | Vend depozitim Bogovë 1 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 15 | Vend depozitim Bogovë 2 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 16 | Vend depozitim Çorovodë 1 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 17 | Vend depozitim Çorovodë 2 | Skrapar | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 18 | Çerenisht | Skrapar | Ekzistues | Mbetje inerte | Mbyllje |
| 19 | 1 – fshati Vokopolë | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje urbane | Rehabilitim |
| 20 | 2 – fshati Sqepur | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje urbane | Largimi i mbetjeve |
| 21 | 3 – fshati Kuç | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje urbane | Largimi i mbetjeve |
| 22 | 4 – vend depozitim i mëparshëm | Ura Vajgurore | I mbyllur | Mbetje urbane | Mbjellje pemësh |
| 23 | 5 – Lagjja "28 Nëntori" | Ura Vajgurore | Ekzistues | Mbetje inerte | Rehabilitim |

[14] [14] Source: Dumpsite Risk Mitigation Final Report (June 2018)

### 3.3.5 Përmbledhje e teknologjive dhe metodave të preferuara

Si rezultat i caktimit të prioriteteve dhe vlerësimit të alternativave, fushat në fokus të ndërhyrjeve gjatë Fazës I do të jenë:

1. Përmirësimi i depozitimit të mbetjeve, përfshirë:
   - Zbatimin e planeve të përmirësimit për vend depozitimet e bashkive Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore (masat afatshkurtra)
   - Ngritja e strukturave operacionale të nevojshme për një qendër rajonale të menaxhimit të mbetjeve;
   - Ngritja e skemave të financimit për të siguruar qendrueshëmëri në funksionimin dhe mirëmbajtjen e masave të investimit të kryer
   - Ndërtimi i një vend depozitimi sanitar rajonal
2. Zhvillimi i një sistemi të optimizuar për grumbullimin e mbetjeve, përfshirë:
   - Shtrirjen e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale dhe malore
   - Ngritjen e sistemeve të monitorimit financiar dhe të performancës
   - Rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve për t'i depozituar mbetjet në mënyrë të përgjegjshme
3. Angazhimi i bashkive në riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve, përfshirë
   - Identifikimin dhe testimin e qasjeve më premtuese për grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme dhe për trajtimin e mbetjeve organike
   - Krijimin e aleancave për riciklimin me sektorin privat dhe informal
   - Realizimin e impianteve të kompostimit të mbetjeve të gjelbra
   - Realizimin e impianteve për ndarjen dhe trajtimin e mbetjeve në bashkëpunim me sektorin privat dhe informal
   - Shtrirjen e sistemeve të riciklimit dhe trajtimit bazuar në eksperiencat e projekteve pilot
4. Zhvillimi i një sistemi të optimizuar për transferimin dhe transportimin e mbetjeve

- Ngritjen e stacioneve të transferimit për të siguruar transportin e mbetjeve me efiçencë kostoje drejt qendrave rajonale

Faza II do të fokusohet në realizimin e një impianti rajonal për trajtimin e mbetjeve që duhet të zbatohet deri në 2028.

Gjithashtu, bazuar në rezultatet/ përvojat e fazave të mëparshme, aktivitetet e rikuperimit të mbetjeve (skemat e grumbullimit të diferencuar, riciklimi, kompostimi) do të forcohen më tej. Ndërhyrjet kryesore gjatë të tria Fazave përmblidhen në figurën e mëposhtme.




**Figura 25 Ndërhyrjet kryesore për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun Berat gjatë të tria fazave**

Ndikimet në kosto të masave të ndryshme sipas fazave paraqiten në kapitullin 3.5.3.

## 3.4 Organizimi institucional për menaxhimin rajonal të mbetjeve

Aktualisht të gjitha shërbimet e menaxhimit të mbetjeve ofrohen nga bashkitë e veçanta, përkatësisht kompanitë private në emër të bashkive.

Sidoqoftë, disa elementë të një sistemi të integruar për menaxhimin e mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë për të funksionuar me efiçencë kostoje. Siç shtjellohet më tej n kapitullin 3.4.2 bashkëpunimi ndërbashkiak është parashikuar për elementët e mëposhtëm të sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

- Vend depozitimi rajonal
- Stacionet e transferimit dhe transporti në distancë të largët (pas transferimit)
- Impiante komplekse për trajtimin e mbetjeve

Teksa nëpër bashki duhet të forcohen kapacitetet institucionale për planifikimin dhe zbatimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, strukturat organizative për shërbimet rajonale duhet të ngrihen nga zeroja. Alternativat dhe zgjidhjet e parapëlqyera për strukturën institucionale dhe organizative paraqiten në nënkapitujt në vijim. Në nivel bashkie një vëmendje e veçantë do t’i jepet hartimit dhe zbatimit të instrumenteve për planifikimin dhe monitorimin e performancës.

### 3.4.1 Funksionet e Entit për drejtimin e objekteve rajonale MMN

Enti rajonal për menaxhimin e mbetjeve do të marrë funksionet që i delegohen nga bashkitë përkatëse, në përputhje me funksionet e caktuara të menaxhimit të mbetjeve me karakter rajonal.

Ndaj, enti do të jetë i autorizuar të administrojë dhe përpunojë mbetjet bashkiake në zonën e re që do të ndërtohet për depozitimin e mbetjeve, në të cilat përfshihen mbetjet shtëpiake, mbetje jo të rrezikshme nga aktiviteti tregtar, industrial dhe nga institucionet, që do të grumbullohen në 5 bashkitë e Qarkut Berat.

Enti gjithashtu do të jetë përgjegjës për të mbikëqyrur ndërtimin dhe vënien në punë të vend depozitimit të ri, i cili do të jetë në përputhje me Direktivën e BE për Mbetjet, me të gjitha ambientet dhe pajisjet e nevojshme. Po ashtu, enti do të sigurojë

1. drejtuesit dhe strukturat operative që do të nevojiten në të ardhmen për kryerjen e aktivitetit në vend depozitim dhe në objektet e tjera rajonale MMN;
2. kryerjen e aktivitetit në mënyrë efektive dhe efiçente në këto objekte MMN sipas ligjeve në fuqi dhe standardeve më të mira;
3. monitorimin dhe kontrollin e pranimit të mbetjeve, regjistrimit të të dhënave në peshore dhe menaxhimin e performancës së ofrimit të shërbimeve sipas planeve operative;

4. analiza të rregullta për standardet e sasisë dhe cilësisë së mbetjeve, dendësinë dhe sasinë e volumeve rajonale të mbetjeve;

5. marrjen e vendimeve të arsyeshme për kontraktimin në palë të treta të aktiviteteve të veçanta të vend depozitimit (e mundshme për drejtimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të veçanta).

6. financimin e qendrueshëm bazuar në marrëveshjet me njësitë e qeverisjes vendore dhe klientë të tjerë për nivelin e duhur të shërbimeve, për të garantuar mbulimin e plotë të kostove të shërbimeve që ofrohen në vend depozitim;

7. trajnimin efektiv dhe kualifikimin e stafit të përfshirë në ofrimin e shërbimit;

8. mbështetjen e programeve për ndërgjegjësimin e publikut dhe proceset e komunikimit mbi çështjet mjedisore dhe reduktimin e mbetjeve.

### 3.4.2 Alternativat institucionale dhe organizative për menaxhimin rajonal të mbetjeve

*Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", njeh nevojën që bashkitë të bashkëpunojnë kur ekonomia e shkallës kërkon një zonë mbulimi më të madhe se sa ajo e bashkive individuale*. Ky bashkëpunim krijohet për të kryer funksionet e veta bashkiake, si menaxhimi i mbetjeve dhe për të ofruar shërbime specifike për të mirën e përbashkët.

Ligji përcakton se dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që iu ngarkon ligji duke lidhur, ose zbatuar, marrëveshje të përbashkëta ose kontrata dhe duke ia deleguar fuqitë dhe përgjegjësitë specifike njëra-tjetrës ose një pale të tretë kontraktore.

Po kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje me njëra-tjetrën ose me institucionet e qeverisë qendrore për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit ato i japin autoritetin dhe pushtet të caktuar. Ky person juridik do të quhet Autoriteti i Kompetencave të Përbashkëta.

Alternativat që ofron kuadri aktual, i cituar më sipër, mundësojnë bashkëpunimin në forma të ndryshme për ofrimin e shërbimit:

1. Delegimi i funksionit specifik të menaxhimit të mbetjeve me karakter rajonal tek njëra nga bashkitë partnere

2. Delegimi i funksionimit të menaxhimit rajonal të mbetjeve tek Këshilli i Qarkut/ ose institucione të qeverisë qendrore

3. Krijimi i Autoritetit të Kompetencave të Përbashkëta, të cilit bashkitë anëtare i japin autoritetin për të kryer funksionet rajonale të menaxhimit të mbetjeve

Alternativat për bashkëpunimin ndërbashkiak, të ilustruar me shembuj dhe analiza nga bashkitë në Shqipëri, janë diskutuar me ekipin e kompetencave. Janë zhvilluar edhe vizita studimore për të parë shembuj bashkëpunimi ku funksioni i zbatimit i është deleguar Këshillit të Qarkut dhe një Autoriteti të Kompetencave të Përbashkëta, të krijuar në formën e një Shoqërie Aksionere me të gjitha bashkitë të përfshira si aksionerë.

Secila nga format e bashkëpunimit ndërbashkiak të përmendura më sipër, sipas *Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore",* me referencë të veçantë Nenet 32 dhe 33 u ofron NJQV-ve një spektër të gjerë mundësish për ofrimin e shërbimeve publike, si:

(1) Njësi organizative të brendshme si pjesë e strukturës së NJQV,

(2) Ndërmarrjet në pronësi të shtetit bazuar në legjislacionin në fuqi,

(3) Kontraktimi i palëve të treta për të vepruar në emër të tyre,

(4) Prokurimi i shërbimeve ose kontratat PPP, ose

(5) Krijimi i kompanive ku bashkia është pronar i vetëm, bazuar në Ligjin për shoqëritë tregtare.

Duke marrë parasysh legjislacionin kornizë të zbatueshëm, në kontekstin e Programit MIMN të Qarkut Berat paraqiten këto konsiderata të përgjithshme si vijon:

- Zbatimi i funksioneve MMN të marra përsipër nga enti i ri, ose mund të delegohet nga njëra bashki tek tjetra, ose të menaxhohet bashkarisht nga bashkitë e qarkut.

- Menaxhimi i përbashkët i funksioneve MMN po ashtu duhet të marrë parasysh rolin dhe kontributin e aktorëve të tjerë të interesuar në fushën e MMN.

Për rrjedhojë, alternativat më të përshtatshme të organizimit institucional duhet të shtjellohen bazuar në dy skenare:

*Alternativa 1:* Bazuar në pranimin e përbashkët të të pesta bashkive, funksionet rajonale për MMN i delegohen një bashkie të vetme, psh. bashkisë pritëse të objektit të vend

depozitimit rajonal. Kjo bashki i menaxhon shërbimet nëpërmjet ngritjes së një Enti të veçantë brenda organizimit të vet.

*Alternativa 2:* Ngrihet një strukturë e veçantë si person juridik, bazuar në kornizën ligjore të shoqërive tregtare, e cila lejon krahas pesë bashkive përfituese edhe pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë.

#### 3.4.2.1 Alternativa 1: Enti brenda një Bashkie

Bashkitë e Qarkut Berat do të hyjnë në një marrëveshje të përbashkët për të kryer funksione specifike (rajonale) të MMN – sipas Ligjit për NJQV, Neni 14 – për të krijuar një subjekt të ri operativ brenda një Bashkie, si subjekt i kompetencave të përbashkëta. Një ent i tillë nuk do të ketë personalitetin e vet juridik, por do të jetë i regjistruar për efekt të taksave në drejtorinë rajonale të tatimeve dhe do të ketë një numër identifikues për tatimet.

Nga pikëpamja organizative, enti i ri operativ mund të punojë i pavarur nga administrata e përgjithshme e bashkisë dhe gëzon – brenda kompetencave të dhëna – fleksibilitet në menaxhimin e funksioneve të veta. Nuk do të kërkohej të kishte statusin e vet juridik, për sa kohë që personeli njihet si staf i bashkisë dhe asetet mbeten pjesë e pronës bashkiake.

Për këto veprimtari specifike rajonale MMN do të mbahet një sistem kontabiliteti i ndarë dhe asetet e fondet e nevojshme për punën do të transferohen në një llogari të veçantë. Duke pasur në pronësi pasuri të ndara, enti do të ketë të drejtë që gjithashtu të futë në llogarinë e vet tarifat e mbledhura për shërbimin e ofruar, të ndara nga buxheti bashkiak. Të ardhurat e caktuara do të rridhnin drejtpërdrejt në pasurinë e veçantë të entit, me anë të së cilës mbulohen shpenzimet e veta, ndërkohë që buxheti bashkiak siguron vetëm ndërlidhjet financiare me entin e ndarë.

Enti do të hartojë një plan biznesi ku detajohen të ardhurat dhe shpenzimet aktuale, një plan investimesh afatshkurtër dhe afatmesëm dhe një listë përmbledhëse të pozicioneve të përcaktuara në grafikun e punonjësve.

Si një ent i pavarur nga pikëpamja juridike ai nuk do të mund të kalojë në faliment dhe në rast se do të ketë boshllëqe të mëdha për mbulimin e kostove, bashkia si zotërues i tij duhet të plotësojë fondet që mungojnë në buxhetin e tij. Enti do të vepronte në emër të bashkisë, çka nënkupton përgjegjësi të plotë financiare për të gjitha veprimet dhe autoriteti më i lartë do të mbetej Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.

Veçoritë kryesore të kësaj alternative do të ishin (i) fleksibiliteti i kufizuar për çështjet e menaxhimit që lidhen me politikat e personelit dhe procedurat e prokurimit, (ii) kontabilitet i ndarë që lejon llogaritjen e kostove aktuale të shërbimit, mbledhjen e pagesave për shërbimin dhe përdorimin e të ardhurave për këtë qëllim; (iii) më pak presion si aktivitet tregtar sa i përket humbjes dhe dividentëve, duke qenë se vetë bashkia merr risqet financiare si falimendimi ose likujdimi.

#### 3.4.2.2 Alternativa 2: Shoqëri tregtare

Një shoqëri tregtare mund të jetë e organizuar në formën e një kompanie me dy nivele menaxhimi, sipas Nenit 14/5 të Ligjit për NJQV, Ligjit nr. 7926/1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” dhe Ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14.04.2008.

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 7926/1995, të gjitha ndërmarrjet shtetërore të cilat fillimisht ishin ndërmarrje që funksiononin brenda një bashkie dhe ushtronin detyrat dhe funksionet në emër të popullit transformohen në *Shoqëri Aksionere (SHA)* me dy nivele. Po kështu, sipas Ligjit nr. 9901/2008, kompanitë me menaxhim me dy nivele njihen si Shoqëri Aksionere.

Organet e SHA me dy nivele do të jenë:

- *Asambleja e Përgjithshme*, me pjesëmarrjen e të gjithë aksionerëve, është organi më i lartë vendimmarrës i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve vendore pjesëmarrëse, ku votat janë në përpjestim me numrin e aksioneve. Asambleja e aksionerëve përfaqëson autoritetin për të ndryshuar statutin dhe propozon dhe përzgjedh Këshillin Mbikëqyrës.

- *Këshilli Mbikëqyrës* ka autoritetin të ushtrojë detyrat e mbikëqyrjes së punës së drejtuesve, të caktojë politikat e SHA dhe të ndjekë zbatimin e tyre nga drejtuesit, etj.; Këshilli konsiston në një numër tek personash, të cilët nuk janë punonjës të SHA.

- *Drejtori(ët)* që veprojnë si përfaqësues ligjor(ë) të SHA është/ janë punonjës të SHA. Drejtuesit mbulojnë të gjitha çështjet teknike, financiare, administrative dhe të personelit.

Një SHA është subjekt juridik në të cilin aksionet e kapitalit të kompanisë mund të blihen dhe të shiten nga aksionerët që kanë në zotërim kapitalin e kompanisë në përpjestim, sipas numrit të aksioneve të tyre (të vërtetuar me certifikatën e pronësisë). Aksionerët

mund t'ua transferojnë aksionet e tyre të tjerëve pa ndikuar në vazhdimësinë e aktivitetit të kompanisë.

Aksionerët e një SHA mund të jenë qeverisjet vendore, organe rajonale (Qark) dhe/ ose organe të qeverisë qendrore, si edhe partnerë nga sektori privat.[15]

Menaxhimi financiar bazohet në kontabilitetin tregtar të orientuar drejt performancës që i jep të drejtë Kompanisë të hyjë në marrëveshje shërbimi dhe të caktojë pagesa që do të mbulonin plotësisht kostot e shërbimeve të ofruara për bashkitë pjesëmarrëse ashtu si edhe për palë të treta që përfitojnë shërbimin.

Kompania mund të marrë dhe të administrojë hua, ndërkohë që asetet për aktivitetet e saj mbeten pronë e njësive vendore, ndërsa Kompania i ka në përdorim.

Shoqëritë aksionere formohen nga partnerë që janë përgjegjës për detyrimet dhe fitimet e Kompanisë deri në masën e kontributit të dhënë për kapitalin themeltar. Kontributet mund të jepen me pagesë në para ose prona: për themelimin e një SHA, kapitali themeltar duhet të jetë të paktën 3.5 milion Lekë (kur aksionet u vihen në dispozicion vetëm një numri të caktuar investitorësh).

Veçoritë kryesore të kësaj alternative janë (i) një dritëare e hapur për një gamë të gjerë aksionerësh, përfshi organet e qeverisjes vendore, rajonale dhe qendrore, si edhe sektorin privat (ii) fuqizimi i drejtuesve dhe përgjegjësi të plota për veprimtaritë teknike dhe çështjet financiare, përfshi marrjen dhe largimin nga puna të personelit, negocimin e kontratave me klientët, prokurimet dhe menaxhimin e pasurive (ii) kontabiliteti tregtar lejon përdorimin e plotë të të ardhurave për qëllimet e Kompanisë, (iii) aftësia për të mbledhur pagesat për shërbimin bazuar në llogaritjen e kostove të plota, (iv) vendime autonome lidhur me shpenzimet.

[15] Formimi i një SHA është zbatuar nga Shoqëria "Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë" (KRWM), me kapital publik në pronësi të 6 bashkive të Qarkut Korçë, (Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, Kolonjë, Pustec), për të menaxhuar dhe drejtuar punën në vend depozitimin sanitar rajonal në Maliq dhe në 3 stacionet e transferimit me vendndodhje në Bilisht, Çërravë dhe Ersekë.

Edhe menaxhimi i vend depozitimit të Bajkaj realizohet në formën e një shoqërie aksionere. Shoqëria, në përputhje me marrëveshjen e firmosur nga bashkitë përbërëse, parashikon pjesëmarrjen e njësive të qeverisjes vendore. Marrëveshja përcakton gjithashtu pjesëmarrjen me aksione të Këshillit të Qarkut Vlorë dhe të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Detyra kryesore që i caktohet shoqërisë është menaxhimi dhe funksionimi i vend depozitimit, megjithëse në funksion të punës kompania rezervon të drejtën të përdorë tenderimin dhe gjithashtu të tërheqë operatorët e sektorit privat.

### 3.4.3 Pjesëmarrja e sektorit privat në menaxhimin rajonal të mbetjeve

Përfshirja e aktorëve të sektorit privat është në përgjithësi e mundur në të dyja alternativat, megjithatë, sipas kushteve të ndryshme të përcaktuara me ligj.

Enti brenda bashkisë do të kishte të drejtë të lidhte kontrata me partnerë privatë për të kryer shërbime specifike, sipas standardeve të prokurimit të vendosura nga bashkia. Në këtë rast, partneri privat do të paguhej për ofrimin e shërbimeve të veçanta (p.sh. ndarja e mbetjeve, kompostimi), ose mund të drejtojë biznesin e vet me të ardhura që mbulojnë kostot.

Një shoqëri tregtare me identitetin e vet juridik, të ndarë nga ato të aksionerëve të vet dhe në të cilën palët do të marrin pjesë në bazë të kapitalit mund të hyjë në një bashkim shoqërish midis sektorit publik dhe privat, pra një partneritet publik-privat (PPP).

Objektivat kryesorë të një PPP janë ndarja e riskut, integrimi i njohurive të sektorit privat dhe përdorimi i burimeve financiare private. Megjithatë, në rast se masat e propozuara të investimit për projektin do të financohen me fonde të KfW, nuk do të ketë nevojë për financim privat. Gjithashtu duhet të merret parasysh që njohuritë e sektorit privat në rajon apo në Shqipëri janë të kufizuara, ndaj partneriteti nuk do të rezultonte me përfitime të konsiderueshme. Me këto njohuri të kufizuara, kompanitë private lokale mund të mos jenë në gjendje të gjenerojnë përfitime të mjaftueshme për të marrë përsipër një pjesë të riskut (më tepër se risku i një kontrate shërbimi). Për këtë arsye, PPP nuk është parë tani për tani si një zgjidhje e përshtatshme.

Po ashtu nuk është trajtuar këtu as mundësia e dhënies së të gjitha përgjegjësive dhe funksioneve të Kompanisë një operatori privat.

### 3.4.4 Alternativa e parapëlqyer për drejtimin e objekteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve

Alternativat e ndryshme për menaxhimin e objekteve rajonale MMN në Qarkun Berat janë paraqitur dhe diskutuar në një sërë seminaresh dhe udhëtimesh studimore me Ekipin e Kompetencave të projektit. Për të mësuar nga eksperiencat më të hershme në qarqet e tjera të vendit, anëtarët e Ekipit të Kompetencave kanë vizituar Shoqërinë “Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë”, e cila është përgjegjëse për drejtimin e vend depozitimit të Maliqit dhe tre stacioneve të transferimit, si edhe Shoqërinë “Bajkaj Land”, e cila është përgjegjëse për drejtimin e vend depozitimit të Bajkaj (Zona e Mbetjeve Vlorë Jug).

Duke ditur se vendimet në lidhje me organizimin institucional të parapëlqyer duhet të ndjekin procedurat e përcaktuara me ligj, ka pasur një preferencë të përgjithshme nga të gjitha bashkitë për të themeluar një shoqëri aksionere.

### 3.4.5 Procedurat për themelimin e një Autoriteti të Kompetencave të Përbashkëta në formën e një Shoqërie Aksionere dhe regjistrimi përkatës

Bashkitë në Qarkun Berat duhet të përmbyllin një marrëveshje mes tyre për krijimin e një personi juridik të veçantë, të cilit mund t'i japin autoritetin dhe pushtetin për të kryer aktivitetet rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Kjo marrëveshje përcakton: qëllimin e bashkëpunimit, funksionet që duhet të ushtrohen nga secila bashki ose bashkarisht, mjetet me anë të të cilave duhet të arrihet qëllimi, kohëzgjatjen dhe masën e kompetencave të deleguara, shumën përkatëse të kontributit financiar dhe metodën e ndarjes së të ardhurave dhe përfitimeve të tjera.

Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të miratohet nga këshillat përkatës të të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore, që janë palë të marrëveshjes. Detyrimi financiar për secilën prej njësive të vetëqeverisjes vendore do të miratohet çdo vit si një zë i veçantë në buxhetin bashkiak.

Marrëveshjet e miratuara nga këshillat bashkiakë të shoqëruar me konfirmimin nga prefektura janë pjesë e akteve të themelimit, përfshirë kërkesat ligjore për themelimin e një SHA me dy nivele.

Aktet e themelimit do të miratohen nga Këshilli Bashkiak i secilës prej bashkive partnere. Detyrimet financiare do të caktohen për secilën bashki, si një zë i veçantë në buxhetin bashkiak.

SHA do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) sipas procedurave të përcaktuara në Ligjet për Shoqëritë Tregtare dhe Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Procedura përfshin dorëzimin e dokumenteve në QKB dhe marrjen e numrit të regjistrimit; dokumentet do të regjistrohen brenda 2-4 ditësh kalendarike nga data e tyre efektive.

Pasi të plotësohen sa më sipër, Shoqëria do të marrë numrin e vet të identifikimit NIPT dhe njëkohësisht do të regjistrohet për efekt të taksave dhe të punësimit, pra kjo nënkupton që të gjitha detyrimet e Shoqërisë lidhur me këto çështje do të fillojnë në momentin e regjistrimit në QKB.

Procedurat e nevojshme do të përfshijnë (i) gjetjen e një emri unik për kompaninë, (ii) depozitimin e kapitalit fillestar në një bankë dhe marrjen e vërtetimit të bankës, (iii) noterizimin e dokumenteve të krijimit të kompanisë, (iv) dorëzimi i dokumenteve në Zyrën e regjistrimit të kompanive në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit dhe marrja e një numri regjistrimi, (v) regjistrimi tek tatimet dhe marrja e numrit të identifikimit NIPT dhe certifikatës, (vi) regjistrimi i kompanisë në Zyrën e Inspektoriatit të Punës, (vii) pagesa e tarifave vendore dhe marrja e vërtetimit për pagesën e tyre, (viii) regjistrimi në Institutin Publik të Sigurimeve Shoqërore për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, (ix) prodhimi i një vule për kompaninë.

### 3.4.6 Struktura funksionale për menaxhimin rajonal të mbetjeve

Detyrat e para që do të ketë ndërmarrja rajonale MM përshkruhen në kapitullin 3.4.1. Bazuar në funksionet e propozuara diagrama e mëposhtme tregon strukturën e mundshme funksionale.




**Figura 26 Struktura funksionale e propozuar e kompanisë publike rajonale të menaxhimit të mbetjeve**

Struktura e stafit dhe përshkrimet e punës do të shtjellohen më tej pas miratimit të PRMM në kuadër të Studimit të Fizibilitetit dhe Fazës së Zbatimit.

## 3.5 Ekonomia dhe financimi

### 3.5.1 Financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve bashkiake

Draft SKMIM (Korrik 2019) kërkon që bashkitë të përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan" dhe parimin e "vetëmjaftueshmërisë". Përmirësimi i shërbimeve dhe zbatimi i MIMN do të shoqërohet me kosto më të larta. Financimi i qendrueshëm i sistemit të ardhshëm të menaxhimit të mbetjeve mund të arrihet vetëm duke i ngritur tarifat në masë të konsiderueshme dhe duke përmirësuar nivelin e arkëtimit të tyre. Sipas draft SKMIM, bashkitë:

- Do të llogaritin koston e plotë të shërbimit përfshirë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe nevoja financiare shtesë në periudhën afatshkurtër
- Do të llogaritin dhe do të faturojnë tarifën e plotë të shërbimit për grumbullimin dhe transportin
- Do të financojnë 100% të kërkesave për investime për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në territorin e tyre administrativ
- Do të caktojnë një fond vjetor prej jo më pak se 5% të buxhetit për menaxhimin e mbetjeve për mbylljen e vendgrumbullimeve

Në përputhje me draft SKMIM (Korrik 2019) janë caktuar këto synime për t'u arritur nga bashkitë:

- Buxheti i alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financime: 80% deri në vitin 2023, 90% deri në 2028, 95% deri në 2033
- Mbulimi i kostove me të ardhurat nga mbledhja e tarifave MMN: 80% deri në vitin 2023, 90% deri në 2028, 100% deri në 2033
- Niveli i mbledhjes së tarifave: 80% deri në 2023, 90% deri në 2028, 100% deri në 2033

Skema e financimit të MIMN rajonale do të ngrihet gjithashtu nga bashkitë ose nga ndërmarrja publike rajonale për shërbimet MMN që do të formohet nga bashkitë në periudhën afatshkurtër.

Në nënkapitujt vijues paraqiten ndikimet që do të ketë zbatimi i PRMM në kostot, sa i përket investimit fillestar, kostove operative dhe kostove në total. Për të bërë të mundur krahasimin midis fazave të ndryshme, kostot totale jepen si kosto për njësi, e cila i referohet kostos për ton mbetje të grumbulluara.

### 3.5.2 Kërkesat për financim

Kostot e investimit fillestar tani mund të përllogariten vetëm me përafërsi, pasi ende nuk është përcaktuar vendndodhja e qendrës rajonale të menaxhimit të mbetjeve (duke nisur nga vend depozitimi rajonal). Për këtë arsye, janë marrë në konsideratë kosto mesatare bazuar në eksperiencën e projekteve të ngjashme në Shqipëri. Kostot e përllogaritura të investimit fillestar paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 20 Përmbledhje e investimeve fillestare (pa përfshirë taksat dhe kostot e konsulencës)**

| **Komponenti MMN** | **Gjithsej investimet fillestare të kërkuara (Përllogaritje)** | |
|---|---|---|
| Fshirja e rrugëve dhe grumbullimi I mbetjeve | 300,000 EUR | 36,600,000 Lekë |
| | Përfshin vetëm kostot për kontenierë për të gjitha bashkitë si edhe mjete për bashkinë Skrapar. Në bashkitë Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore presupozohet që investimet për mjetet e grumbullimit do t'i kryejë sektori privat | |
| Transferimi dhe transporti | 500,000 EUR | 61,000,000 Lekë |
| Vend depozitimi i ri rajonal | 4,500,000 EUR | 549,000,000 Lekë |
| Përmirësimi i vendgrumbullimeve në bashkitë Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore | 1,500,000 EUR | 183,000,000 Lekë |
| Ndërtimi i një argjinature në vend depozitimin e bashkisë Berat | 1,000,000 EUR | 122,000,000 Lekë |
| Mbyllja dhe rehabilitimi i vendgrumbullimeve (pas ndërtimit të një vend depozitimi rajonal) | 1,000,000 EUR | 122,000,000 Lekë |
| Impiante të vogla për kompostimin e mbetjeve të gjelbra nëpër bashki | 200,000 EUR | 24,400,000 Lekë |
| Impiante të volga për ndarjen, ruajtjen dhe trajtimin e materialeve të riciklueshme nëpër bashki | Supozohet që impiante të thjeshta për ndarjen e mbetjeve do të ndërtohen dhe menaxhohen nga sektori privat. | |
| Trajtimi kompleks i mbetjeve | Kosto investimi dhe financimi që duhet të sqarohen gjatë Fazës II | |
| **Grand Total (Faza I)** | **9,000,000 EUR** | **1,098,000,000 Lekë** |

Pa trajtimin kompleks të mbetjeve (i cili është planifikuar në një fazë të mëvonshme) totali i investimit fillestar arrin shumën rreth 9 milion EUR (1,098 milion Lekë). Llogaritje më të detajuara të kostove do të bëhen në Studimin e Fizibilitetit pas miratimit të PRMM dhe të vendndodhjes për vend depozitimin rajonal.

### 3.5.3 Kostot dhe mbulimi i kostove të shërbimeve MMN

Kostot për të tre sistemet MMN sipas PRMM janë përllogaritur me përafërsi duke përdorur vlera reference:

- Koncepti bazë: zhvillimi i shërbimeve bazë MMN përfshirë vend depozitimet e kontrolluara, masat fillestare për riciklimin dhe kompostimin
- Menaxhimi i Integruar Rajonal i Mbetjeve të Ngurta (MIMN): vend depozitimi sanitar rajonal dhe sistemet gjithëpërfshirëse për riciklimin dhe kompostimin
- MIMN rajonal me Trajtimin Mekanik-Biologjik (TMB): vend depozitim sanitar rajonal dhe impiant kompleks për trajtimin e mbetjeve (TMB).

Kostot janë llogaritur si kosto sistemi (duke përfshirë të gjithë elementët e shërbimeve MMN) për gjithë qarkun, duke mos bërë dallime midis bashkive të ndryshme dhe shërbimeve që do t'u ofrohen nga ndërmarrja e ardhshme rajonale e menaxhimit të mbetjeve. Llogaritja e detajuar e kostove do të kryhet gjatë Studimit të Fizibilitetit për këtë PRMM.

Përllogaritja e kostove bazohet në teknologjitë dhe metodat e planifikuara si edhe në sasinë e parashikuar të mbetjeve që do të grumbullohen, siç paraqitet në kapitullin 3.1.4 (Koncepti bazë: 2020, MIMN rajonal: 2023, MIMN rajonal me TMB: 2028). Kostot e investimit janë përfshirë për të gjithë komponentët MMN përveç depozitimit të mbetjeve. Kostot administrative janë përllogaritur në masën 7% dhe kostot për informimin e publikut dhe masat e rritjes së ndërgjegjësimit në masën 2% të totalit të kostove për shërbimet MMN. Tabela e mëposhtme paraqet kostot e përllogaritura për të tre sistemet MMN[16].

[16] Kostot e përllogaritura e kanë të përfshirë edhe zbritjen nëpërmjet të ardhurave që do të gjenerohen nga shitja e materialeve të ricklueshme.

**Tabela 21 Përllogaritje e kostove vjetore [EUR/vit]**

| | **Sistemi aktual** | **Koncepti bazë me vend depozitime të kontrolluar a** | **MIMN me vend depozitim rajonal** | **MIMN rajonal me TMB** |
|---|---|---|---|---|
| Pastrimi dhe fshirja e rrugëve | 246,000 | 306,000 | 326,000 | 347,000 |
| Grumbullimi i mbetjeve (Mbetje të përziera) | 439,000 | 575,000 | 502,000 | 427,000 |
| Grumbullimi i diferencuar | | 63,000 | 164,000 | 269,000 |
| Kompostimi | | 19,000 | 77,000 | 139,000 |
| Transferimi dhe transporti | | | 222,000 | 189,000 |
| TMB me kompostim | | | | 1,290,000 |
| Depozitimi i mbetjeve* | 11,000 | 111,000 | 266,000 | 113,000 |
| Rehabilitimi i vend depozitimeve** | | 50,000 | 50,000 | 50,000 |
| Të tjera | 191,000 | | | |
| Administrata (7%) | | 79,000 | 112,000 | 198,000 |
| Marrëdhënie me publikun (2%) | | 23,000 | 32,000 | 59,000 |
| **Total [EUR/vit]** | **887,000** | **1,227,000** | **1,757,000** | **3,007,000** |
| ***Total [Lekë/vit]*** | ***108,183,000*** | ***149,734,000*** | ***214,336,000*** | ***366,883,000*** |

* = kostot e investimit fillestar nuk janë përfshirë

** = 20% e gjithsej kostove të rehabilitimit

Kostot e shërbimit pritet të rriten nga 1.2 milion EUR në vit (149.7 milion Lekë/vit) për Konceptin Bazë deri në 1.8 milion EUR në vit (214.3 milion Lekë/vit) pas ndërtimit të një vend depozitimi rajonal dhe në 3 milion EUR në vit (366.8 milion Lekë/vit) pas ngritjes së një impianti kompleks për trajtimin e mbetjeve. Për të krahasuar kostot specifike vjetore të këtyre tre skenareve, këto kosto janë pjestuar me sasinë e përllogaritur të mbetjeve që do të grumbullohen në vitin përkatës. Kostot specifike të përllogaritura tregohen në diagramën e mëposhtme.




**Figura 27 Kostot specifike për tre skenarët e zbatimit**

Duket qartë se kostot specifike të sistemit MIMN (54 EUR/t ose 6,579 Lekë/t) pritet që të jenë më të larta se sa kostot e konceptit bazë (38 EUR/t ose 4,610 Lekë/t). Arsyeja kryesore për rritjen e kostos është ndryshimi i mënyrës së depozitimit nga vend depozitim i kontrolluar në vend depozitim sanitar dhe zbatimi i transferimit dhe transportit të mbetjeve drejt vend depozitimit rajonal. Kosto shumë më të larta janë përllogaritur për zbatimin e një sistemi MIMN me TMB (95 EUR/t ose 11,531 Lekë/t) për shkak të ndërtimit dhe funksionimit të impiantit TMB. Në tabelën e mëposhtme këto kosto jepen përsëri të detajuara.

**Tabela 22 Kostot specifike për tre skenarët e zbatimit [EUR/t]**

| | Sistemi aktual | Koncepti bazë me vend depozitime të kontrolluara | MIMN me vend depozitim rajonal | MIMN rajonal me TMB |
|---|---|---|---|---|
| Pastrimi dhe fshirja e rrugëve | 7.5 | 9.5 | 10.0 | 10.6 |
| Grumbullimi i mbetjeve (Mbetje të përziera) | 13.3 | 17.7 | 15.5 | 13.1 |
| Grumbullimi i diferencuar | | 1.9 | 5.0 | 8.3 |
| Kompostimi | | 0.58 | 2.4 | 4.3 |
| Transferimi dhe transporti | | | 6.8 | 5.8 |
| TMB me kompostim | | | | 39.6 |
| Depozitimi i mbetjeve (vetëm kosto operative) | 0.3 | 3.4 | 8.2 | 3.5 |
| Rehabilitimi i vend depozitimeve (vetëm 20% e kostove të përgjithshme) | | 1.5 | 1.5 | 1.5 |
| Të tjera | 5.8 | | | |
| Administrata (7%) | | 2.4 | 3.5 | 6.1 |
| Marrëdhënie me publikun (2%) | | 0.7 | 1.0 | 1.8 |
| **Total [EUR/t]** | **27** | **38** | **54** | **95** |
| **Total [Lekë/t]** | ***3,285*** | ***4,610*** | ***6,579*** | ***11,531*** |

Për vlerësimin e ndikimit që do të ketë ky zhvillim i kostove në tarifat për familjet, supozohet që financimi i sistemit të ardhshëm MIMN do të mbulohet tërësisht nëpërmjet tarifave. Gjithashtu, supozohet që 60% e kostove do të mbulohen nëpërmjet tarifave të familjeve dhe 40% nga tarifat e subjekteve të biznesit (dhe institucioneve). Bazuar në këto supozime, janë llogaritur këto tarifa që mbulojnë kostot, për të tre skenarët e zbatimit sipas normave të ndryshme të mbledhes së tarifave: 90%, 70% dhe 50%.

**Tabela 23 Llogaritja e tarifave (që mbulojnë kostot) për familje për tre skenarët e zbatimit**

| Niveli i mbledhjes së tarifave | Koncepti bazë me vend depozitime të kontrolluara | | MIMN me vend depozitim rajonal | | MIMN rajonal me TMB | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | EUR/fam/ muaj | Lekë/fam/ muaj | EUR/fam /muaj | Lekë/fam/ muaj | EUR/fam/ muaj | Lekë/fam/ muaj |
| 90% | 1.7 | 205 | 2.5 | 311 | 4.7 | 577 |
| 70% | 2.2 | 263 | 3.3 | 399 | 6.1 | 742 |
| 50% | 3.0 | 369 | 4.6 | 559 | 8.5 | 1,039 |

Siç tregohet në kapitullin 2.8.3 kufiri i tarifës së përballueshme të MMN përllogaritet të jetë mesatarisht 699 Lekë/familje/muaj. Në këtë aspekt, kostot e llogaritura për të mbuluar

kostot në dy skenarët e parë (koncepti bazë dhe sistemi MIMN me vend depozitim rajonal) janë brenda kufirit të përballueshmërisë për të gjitha nivelet e mbledhjes së tarifave. Po kështu, sistemi MIMN rajonal me TMB, bazuar në të ardhurat aktuale për familje, do të ishte i përballueshëm financiarisht vetëm nëse niveli i mbledhjes së tarifave është 90% ose më i lartë. Për këtë arsye, kur të planifikohet impianti kompleks për trajtimin e mbetjeve, duhet të rivlerësohet përballueshmëria financiare për alternativën e preferuar të trajtimit të mbetjeve bazuar në situatën e të ardhurave në atë kohë.

Tarifat në tabelën e mësipërme janë tarifa mesatare të llogaritura në bazë të numrit total të familjeve në qark. Për të përcaktuar tarifat për secilën bashki dhe strukturë vendbanimi: zonat urbane, gjysëm-urbane dhe rurale, kostot dhe tarifat duhet të llogariten sipas kushteve lokale dhe normave specifike të gjenerimit të mbetjeve në secilën bashki dhe njësitë administrative.

## 3.6 Ndërgjegjësimi publik, informimi dhe pjesëmarrja

Niveli i ndërgjegjësimit i banorëve të Qarkut Berat vlerësohet si i ulët bazuar në intervistat me stafin e bashkive dhe banorë të qarkut. Banorët kanë një interes të ulët për temën e MMN dhe nuk ndjehen të përgjegjshëm për mbajtjen pastër të qytetit. Krahas kësaj, nuk ka informacion të mjaftueshëm dhe mungon komunikimi midis entit përgjegjës për menaxhimin e MMN dhe banorëve. Ndaj është e nevojshme marrja e masave për rritur nivelin e ndërgjegjësimit të banorëve, për të përmirësuar informimin dhe marrëdhëniet me publikun (MP), si edhe pjesëmarrjen e publikut, në mënyrë që MIMN të zbatohet me sukses në të ardhmen.

Do të jetë detyrë si e subjektit rajonal të MMN (shihni kapitullin 3.4.1) edhe e bashkive për të realizuar aktivitete, fushata dhe programe për ndërgjegjësimin, marrëdhëniet me publikun dhe shmangien e mbetjeve. Shpërndarja e tyre do të jetë sipas përgjegjësive të dakordësuara për menaxhimin e mbetjeve:

- Kompania rajonale do të jetë përgjegjëse për masat e MP sa i përket çështjeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, si psh vend depozitimi i ri sanitar rajonal dhe aspekte që lidhen me të.
- Bashkitë do të jenë përgjegjëse për masat e MP sa i përket çështjeve vendore të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, përkatësisht grumbullimit të mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar), fshirjen e rrugëve, si edhe mbledhjen e tarifave dhe masa të përgjithshme për ndërgjegjësimin e publikut dhe MP që synojnë të ndryshojnë qëndrimin dhe zakonet e banorëve në drejtim të MMN.

### 3.6.1 Informimi dhe marrëdhëniet me publikun

**Informimi dhe marrëdhëniet me publikun** është një aspekt i rëndësishëm i MIMN për të bërë të mundur që publiku të marrë informacionin e duhur dhe të kuptojë çështjet dhe proceset që lidhen me sistemin e ardhshëm MIMN në mënyrë që të bëjë zgjedhje dhe veprime të arsyetuara.

Kompania e ardhshme rajonale për menaxhimin e mbetjeve, përgjegjëse për drejtimin e objekteve rajonale do të jetë e dukshme dhe e hapur ndaj publikut. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që një njësi specifike në strukturën organizative të ngarkohet me përgjegjësinë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së nevojshme dhe masave për informimin e publikut dhe MP. Kështu ndërmarrja rajonale:

- Do të caktojë përgjegjësitë për marrëdhëniet me publikun, ndërgjegjësimin dhe informimin dhe do të organizojë trajnime për stafin përkatës
- Do të zhvillojë markën dhe identitetin e kompanisë
- Do të krijojë portale komunikimi me publikun (linjë telefonike, website, media sociale, etj.)
- Do të publikojë rregullisht lajme rreth aktiviteteve të kompanisë

Gjithashtu, në nivel vendor, bashkitë do t'u mundësojnë banorëve të dorëzojnë ankesat e tyre në lidhje me shërbimet MMN. Për këtë qëllim, bashkitë:

- Do të përcaktojnë një njësi përkatëse për informimin dhe marrëdhëniet me publikun për të menaxhuar aktivitetet MP sa i përket shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.
- Do të krijojnë portale komunikimi me publikun (website, media sociale, linjë telefoni për ankesat), p.sh të lidhura me portalet ekzistuese të bashkive
- Do të përcaktojnë përgjegjësitë në kontratat e shërbimit në rastet kur shërbimet kryhen nga sektori privat.

### 3.6.2 Masat për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut

Angazhimi dhe mbështetja e publikut është një domosdoshmëri për të arritur objektivat dhe rezultatet e parashikuara në sistemin e ri MIMN. Për ta arritur këtë, masat **për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin e publikut** janë themelore për të promovuar ndryshimin e sjelljes dhe për të angazhuar publikun.

Draft SKMIM (Korrik 2019) parashikon integrimin e edukimit rreth mbetjeve në kurrikulat shkollore duke filluar që me masat afatshkurtra. Gjithashtu, draft strategjia synon të zbatojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nëpër shkolla për të inkurajuar zakohet e riciklimit tek nxënësit duke pasur si synim 50% të shkollave deri në 2023, 70% deri në 2028 dhe 95% deri në 2033. Për këtë bashkitë:

- Do të mbështetin dhe bashkëpunojnë me Ministrinë e Arsimit dhe shkollat për zbatimin e edukimit mbi mbetjet në kurrikulat shkollore si edhe grumbullimin e diferencuar, siç parashikohet në draft SKMIM (Korrik 2019)

**Pjesëmarrja e publikut** në procesin e vendimmarrjes për mbetjet është shumë e rëndësishme për të lehtësuar futjen e sistemit të MIMN. Për të shmangur kundërshtimin e publikut (psh kundër ndërtimit të një vend depozitimi të ri sanitar ose kundër rritjes së tarifave për menaxhimin e mbetjeve), rekomandohet që qytetarët dhe bizneset dhe aktorë të tjerë të interesuar të përfshihen që në fazat e para të vendimmarrjes dhe çështjet të prezantohen, të sqarohen dhe të diskutohen hapur dhe në mënyrën e duhur. Veç kësaj, sipas ligjit në procesin e miratimit të planeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve duhet të merret në konsideratë dhe opinioni publik.

Ndaj, publiku do të përfshihet nëpërmjet dëgjesave publike dhe opinioni i tij do të merret në konsideratë në procesin e përgatitjes së planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të mbetjeve.

Përveç pjesëmarrjes së publikut dhe gjithë aktorëve kryesorë në procedurat e planifikimit dhe miratimit për objektet e mbetjeve dhe në miratimin e rregulloreve të reja për MMN bashkiak (psh. tarifat), është gjithashtu e rëndësishme t'i tregohet publikut se ai luan një rol aktiv e të rëndësishëm për zbatimin me sukses të sistemit të ri MIMN të parashikuar dhe se aktivitetet dhe sjelljet e tij mund të kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e situatës aktuale. Për këtë qëllim bashkitë:

- Do të ndërmarrin fushata pastrimi vjetore në të cilat banorët të marrin pjesë në mënyrë aktive
- Do të organizojnë seminare me organizata lokale mjedisore dhe të tjera për të nxitur përfshirjen e tyre aktive në MMN bashkiak, p.sh sa i përket minimizimit, riciklimit ose kompostimit të mbetjeve
- Do të krijojnë banderola, postera ose reklama për praktikat e mira si duhet të veprojmë me mbetjet
- Do të marrin masa për të lejuar banorët të raportojnë rreth hedhjes së paligjshme të mbetjeve, zonave të ndotura dhe kontenierëve të pazbrazur

Gjatë periudhës së zbatimit të PRMM, ndërmarrja rajonale:

- Do të organizojë evente publike për të informuar publikun rreth aktiviteteve të zbatuara nga ndërmarrja rajonale, përfshi vizitat e shkollave në vend depozitimin rajonal.
- Do të publikojë reklama rreth avantazheve të MIMN dhe ndikimeve të tij pozitive
- Do të zbatojë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit

## 3.7 Menaxhimi i rrymave të tjera të mbetjeve

### 3.7.1 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet

Një përllogaritje e sasive të mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet në Qarkun Berat paraqitet në kapitullin 2.9. Draft SKMIM (Korrik 2019) fokusohet në ripërdorimin dhe riciklimin e MNP dhe mbetjeve inerte:

- Ngritja e qendrave të trajtimit për MNP të grumbulluara veçmas
- Ripërdorimi i mbetjeve inerte (30% deri në 2023, 50% deri në 2028, 80% deri në 2033)

Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet përfshijnë shumë lloje materialesh, ndër të tjera dru, beton, tulla, metal, qelq dhe suva, të cilat në varësi të strukturës së materialit ose do të riciklohen ose do të depozitohen në një vend depozitim për materiale inerte. Masat për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet mund të kryhen në vend ose në një ambient tjetër të caktuar, në varësi të kushteve të përgjithshme.

Figura e mëposhtme paraqet alternativat e mundshme për menaxhimin e mbetjeve nga një shesh ndërtimi dhe prishjeje.




**Figura 28 Alternativat për menaxhimin e mbetjeve nga një shesh ndërtimi dhe prishjeje**

Siç mund të shihet më sipër, trajtimi i MNP mund të realizohet ose në vend me anë të një makinerie trajtimi (gjysëm) të lëvizshme ose në një impiant qendror. Nga përvoja europiane rezulton se impiantet stacionare kanë efiçencë kostoje nëse futet në përpunim një sasi prej të paktën 100,000 tonë në vit. Sasia e përllogaritur e MNP në Qarkun Berat është rreth një e treta e kësaj sasie, ndaj vetëm makineria e lëvizshme e trajtimit do të ishte zgjidhje e përshtatshme.

Sipas VKM nr. 575, njësive të qeverisjes vendore u kërkohet të sigurojnë një vend për ruajtjen e përkohshme dhe një vend depozitim për mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet. Vëllimet e mëdha dhe pesha e lartë specifike e MNP në përgjithësi nuk e justifikojnë transportin e tyre në distancë të largët drejt një impianti qendror. Për shkak të rreziqeve të vogla ndaj mjedisit, MNP mund të menaxhohen në qendra të decentralizuara, çka nënkupton që në secilën bashki të Qarkut Berat duhet të ndërtohet një vend depozitim për mbetjet inerte.

Ruajtja, transporti dhe depozitimi i mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet janë detyrim i vetë zotëruesit të këtyre mbetjeve. Për trajtimin e mëtejshëm të MPN nevojiten leje. Struktura dhe lidhjet e lejeve ilustrohen në figurën e mëposhtme.




**Figura 29 Organizimi i depozitimit të mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet sipas VKM nr. 575**

Njësitë e qeverisjes vendore marrin raportime mbi sasitë e mbetjeve nga operatorët, në rast se ato vetë nuk veprojnë si operatorë.

Siç përmendet më sipër, politikat shqiptare në pajtim me Direktivat e BE nuk kërkojnë vetëm asgjësimin e sigurt, por edhe rritjen e nivelit të ripërdorimit dhe riciklimit të MNP. Krahasuar me kostot aktuale për depozitimin e MNP (ku zakonisht faturohet vetëm transporti), trajtimi dhe ripërdorimi i MNP në shumicën e rasteve do të ishte më i kushtueshëm. Përveç kësaj, aktualisht nuk ka treg për produktet e riciklimit të MNP – në

çdo rast duke marrë parasysh numrin e madh të guroreve në Qarkun Berat, mund të jetë e pakët sasia e materialeve të ricikluara që mund të pranohen.

Për shkak të sfidave në tregtimin e produkteve dhe në ushtrimin e aktiviteteve efiçente dhe ekonomike, trajtimi i MNP duhet të fillojë në formën e projekteve pilot në bashkëpunim me sektorin privat. Bazuar në përvojën e masave pilot aktivitetet duhet të zgjerohen më tej.

### 3.7.2 Mbetjet nga aktivitetet tregtare dhe industriale

Mbetjet nga aktivitetet tregtare dhe industriale të ngjashme nga natyra me mbetjet shtëpiake mblidhen kryesisht nëpërmjet shërbimeve bashkiake të grumbullimit të mbetjeve. Sipas të dhënave të INSTAT në Shqipëri, në 2017, mesatarisht përqindja që zënë mbetjet industriale që menaxhohen së bashku me mbetjet bashkiake arrin në 11.5 %.[17]

Sipas SKMIM (draft Korrik 2019), zotëruesit e mbetjeve industriale dhe minerale duhet të sigurojnë depozitimin e sigurt mjedisor të mbetjeve që ata kanë prodhuar. Ata janë përgjegjës për ndarjen në burim të paktën në fraksionet e mbetjeve të riciklueshme, të rrezikshme dhe jo të rrezikshme. Gjithashtu, ata kanë detyrimin t'i dorëzojnë mbetjet tek grumbulluesit e autorizuar privatë ose publikë ose në impiantet e trajtimit. Trajtimi mund të kryhet nga vetë zotëruesi i mbetjeve industriale, nëse është i autorizuar. Mbetjet e riciklueshme dhe jo të rrezikshme duhet të përpunohen në procese (të tjera) industriale, ndërsa fraksioni i mbetjeve të rrezikshme ose transportohet në qendrat e grumbullimit a pikat e trajtimit ose depozitohet në një vend depozitim të posaçëm për mbetje të rrezikshme.

Instituti shtetëror përgjegjës për zbatimin e Ligjit për sektorin e minierave në Republikën e Shqipërisë ka detyrimin të përgatitë plane për menaxhimin e mbetjeve të minierave në konsultim me njësitë e qeverisjes vendore.

### 3.7.3 Llumrat e kanalizimeve

Aktualisht nuk ka një impiant qendror për trajtimin e ujërave të përdorura (të zeza) (ITUP) në ndonjë nga bashkitë e Qarkut Berat. Ndaj, për momentin nuk prodhohen llumra në zonën e projektit. Në Bashkinë Berat është duke u përgatitur një Studim Fizibiliteti për një impiant trajtimi të ujërave të përdorura. Tani nuk ka informacion rreth teknologjisë së

[17] Shihni: INSTAT "Mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri", 2018

trajtimit, ripërdorimit ose depozitimit të llumrave të kanalizimeve që do të dalin nga proceset në ITUP. Teknologjia e ardhshme do të njihet pasi të zbatohet.

Ka disa mënyra për të përdorur ose asgjësuar llumin e kanalizimeve:

- Përhapja mbi tokë bujqësore; për pasurimin e tokës
- Kompostimi, trajtimi mekanik-biologjik (TMB)
- Mono-incinerimi, bashkë-përpunimi, incinerimi i kombinuar i mbetjeve
- Gazifikimi nëpërmjet pirolizës
- Oksidimi i lagësht
- Depozitimi në vend depozitim.

Secili nga proceset kërkon hapa përgatitorë si koncentrimi, heqja e lagështisë dhe tharja. Disa prej tyre kryhen në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorur, në vendndodhje të tjera të ndërmjetme ose aty ku do të kryhet përdorimi/ depozitimi përfundimtar. Figura e mëposhtme paraqet një pamje të proceseve të ndryshme.




**Figura 30 Proceset për përdorimin ose depozitimin e llumit të kanalizimeve**

Depozitimi i llumit të kanalizimeve nga ITUP do të jetë përgjegjësi e ndërmarrjes së ujësjellës kanalizimeve.

### 3.7.4 Mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet spitalore

Në Shqipëri, mbetjet e rrezikshme klasifikohen në nëngrupet e mbetjeve të rrezikshme me origjinë bashkiake, si bateritë, kimikate të papërdorura, të skaduara ose që nuk lejohen në vend depozitim dhe në mbetje të rrezikshme industriale. Nuk ka të dhëna të sigurta në zonën e projektit, as për sasinë e mbetjeve të rrezikshme as për nivelin e rrezikshmërisë së tyre.

Gjithë administrimi i mbetjeve të rrezikshme duhet të kryhet nën kushte që sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit. Gjithë transporti i mbetjeve të rrezikshme kërkon shoqërimin me dokumentacion sipas kërkesave të Ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe të gjitha të dhënat e regjistruara duhet të ruhen për tre vjet.

Sipas SKMIM (draft Korrik 2019), prodhuesit e të gjitha kategorive të mbetjeve të rrezikshme janë përgjegjës për organizimin e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, duke mbuluar prodhimin, grumbullimin, transportin dhe ruajtjen.

Aktualisht, nuk ka alternativa të qarta të caktuara për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme në zonën e projektit. Sipas SKMIM (draft Korrik 2019) deri në 2028 do të përgatitet një Master Plan për rrymat specifike të mbetjeve përfshi mbetjet e rrezikshme, nën përgjegjësinë e MTM, MIE dhe AKM.

Në përmbushje të synimeve të draft SKMIM, të dy palët, si bashkitë edhe kompanitë kërkohet të raportojnë mbi sasitë e mbetjeve të rrezikshme në një sistem të dhënash të ngritur nga AKM.

#### 3.7.4.1 Mbetjet e rrezikshme me origjinë bashkiake

Sipas draft amendimit të Ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Korrik 2019), njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të ngrenë sisteme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të rrezikshme shtëpiake deri në fillim të vitit 2025. Ato do të mbështeten në udhëzimet e Ministrisë që do të përcaktohen deri në Janar 2020.

Në përputhje me SKMIM (draft Korrik 2019), qendrat për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme menaxhohen në nivel kombëtar. Megjithatë, bashkitë duhet të ngrenë qendra grumbullimi për mbetjet e rrezikshme nga familjet dhe bizneset e vogla, bazuar në marrëveshje financimi me qeverinë qendrore ose me pjesëmarrës në Organizatat e Përgjegjësisë së Prodhuesit, të cilat do të transportohen më pas në qendrën pritëse.

### 3.7.4.2 Mbetjet e rrezikshme industriale

Për mbetjet e rrezikshme industriale legjislacioni shqiptar në fuqi parashikon që grumbullimi dhe trajtimi i tyre është përgjegjësi e prodhuesit. Historikisht, këta kontribues kanë bërë përpjekje për të vetë-menaxhuar sasitë e mbetjeve të rrezikshme që ose janë ruajtur në ambientet e tyre ose në magazinat e zonave të ndryshme industriale. Në zonën e projektit nuk raportohen të dhëna mbi sasinë e mbetjeve të rrezikshme industriale që prodhohen. Megjithatë, meqë ka filluar tranzicioni nga e kaluara komuniste e Shqipërisë në ekonominë e tregut të hapur, prodhuesit kryesorë të mbetjeve të rrezikshme në zonën e projektit janë pakësuar. Numri i subjekteve të regjistruara në Qarkun Berat është rritur nga 4,470 në 2012 deri në 8,300 në 2016. Kjo rritje vjen kryesisht si pasojë e rritjes së numrit të subjekteve në bujqësi, pyje dhe peshkim nga 60 në 3,545. Numri i subjekteve aktive në fushën e industrisë është relativisht i qendrueshëm, por i ulët në krahasim me fushat e tjera të ekonomisë. Për pasojë, meqë aktivitetet industriale që zhvillohen tani në zonën e projektit janë shumë të kufizuara, edhe prodhimi i mbetjeve të rrezikshme parashikohet të jetë i ulët.

Që prej vitit 2000 me ndihmën e UNDP/ UNEP janë identifikuar 45 pika të nxehta mjedisore në Shqipëri, ku janë depozituar mbetje të rrezikshme. Nxjerrja e naftës në Bashkinë Kuçovë është një nga këto pika të nxehta mjedisore të regjistruara. Pritet që kërkimet për naftë në Qarkun Berat do të rriten në të ardhmen dhe kjo kërkon marrjen e masave të veçanta paraprake për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

### 3.7.5 Mbetjet spitalore

Menaxhimi i mbetjeve spitalore duhet të kryhet bazuar në rregulloren për “Administrimin e mbetjeve spitalore”, të miratuar me VKM nr. 798 datë 29.09.2010. rregullorja përcakton qartë protokollet teknike dhe standardet për administrimin e mbetjeve spitalore, që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit. Elementi qendror i rregullores konsiston në ndarjen e mbetjeve spitalore të rrezikshme (infektive, radioaktive, citotoksike, farmaceutike, kimike, etj.), që janë në masën deri 20 % sipas SKMIM (draft i 7 Qershor 2019) nga mbetjet spitalore jo të rrezikshme (mbetje nga kuzhina, lavanteritë, zyrat, mbetje urbane nga pavionet, etj.). Mbetjet spitalore jo të rrezikshme do të trajtohen si mbetjet urbane.

Trajtimi i mbetjeve spitalore të rrezikshme mund të kryhet në vend ose në ambiente të tjera jashtë spitalit, ku ato prodhohen. Trajtimi në vend në përgjithësi bëhet me efiçencë kostoje për sasi të mëdha mbetjesh spitalore të rrezikshme, që prodhohen në spitale të mëdha dhe qendra universitare të cilat kanë hapësira, buxhet dhe punonjës për të drejtuar

pajisjen përkatëse. Për trajtimin jashtë qendrës, nga ana e prodhuesit të mbetjeve duhet të kontraktohet shërbim i specializuar, si incinerimi ose sterilizimi me autoklavë. nga një kompani, punonjësit e së cilës janë të trajnuar të mbledhin dhe transportojnë mbetjet spitalore të rrezikshme.

Prodhuesit e mbetjeve spitalore përcaktohen me rregullore si aktorët e vetëm përgjegjës për grumbullimin e ndarë të mbetjeve spitalore (të paktën të dy rrymave kryesore: të rrezikshme dhe jo të rrezikshme). Rregullorja gjithashtu përcakton kushtet e transportit (protokollin e paketimit, etiketimin, ruajtjen e përkohshme) si edhe metodat e trajtimit të mbetjeve spitalore.

Sipas SKMIM (draft Korrik 2019), në 2017, kishte 56 qendra shëndetësore në Qarkun Berat; 51 prej tyre kishin lidhur kontrata me palë të treta për menaxhimin e mbetjeve spitalore. Asnjë nga spitalet dhe qendrat shëndetësore në Qarkun Berat nuk ka në përdorim një autoklavë.

Deri në vitin 2033, 100 % e mbetjeve spitalore do të grumbullohen dhe trajtohen, sipas synimeve të vendosura në SKMIM (draft 7 Qershor 2019).

### 3.7.6 Rryma të veçanta mbetjesh nën Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit (PZP)

Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP) është një qasje politikash për t'ia transferuar përgjegjësinë e fazës së fundit të jetës të disa produkteve dhe rrymave të materialeve prodhuesve ose importuesve të tyre. Ideja thelbësore është të krijohen incentiva që prodhuesit të parandalojnë mbetjet dhe të promovojnë eko-modele, por gjithashtu edhe të rritet niveli i grumbullimit të diferencuar dhe për rrjedhojë i riciklimit dhe rikuperimit të materialeve.

Nën skemën PZP, prodhuesit janë përgjegjës për kostot e grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve. Zbatimi i sistemeve të menaxhimit PZP mund të funksionojë si një sistem i tregut të lirë ose sistemi i taksave ku qeveria mbledh taksat përkatëse.

Krahas ambalazheve dhe mbetjeve të tyre, mbetjeve nga elektrike dhe elektronike (MEE) dhe automjeteve në fund të jetës, gjithashtu mbetjet e gomave, bateritë, akumulatorët dhe vajrat e përdorura do të menaxhohen në skemën e PZP.

Në përgjithësi, bashkive u kërkohet të intensifikojnë fushatat e ndërgjegjësimit dhe të theksojnë nismat e biznesit për të rritur riciklimin e materialeve në skemat PZP.

Megjithatë, roli i bashkive ende nuk është i përshkruar qartë dhe i detajuar në nivele të ndryshme sipas rrymës së mbetjeve në SKMIM (draft 7 Qershor 2019).

SKMIM (draft Korrik 2019) parashikon krijimin e skemave që do të zbatohen nga bashkitë në mënyrë të pavarur ose bashkarisht për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike brenda skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Deri në 2023 do të krijohen të paktën 5 skema, deri në 2028 të paktën 10 dhe deri në 2033 do të ngrihen aq skema sa do të përcaktohet në Master Plan (i cili ende nuk është përgatitur).

#### 3.7.6.1 Ambalazhet dhe mbetjet e tyre

Ambalazhet dhe mbetjet e tyre u referohen ambalazheve që gjenden në treg dhe gjithë mbetjeve të ambalazheve prej metali, plastike, letre dhe kartoni, qelqi ose materiali tjetër.

Në Shqipëri, VKM nr. 177 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre" i miratuar më 6 Mars 2017, në përputhje me direktivat përkatëse të BE rregullon menaxhimin e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre.

Grumbullimi i diferencuar dhe riciklimi brenda skemave PZP duhet të organizohet dhe menaxhohet nga prodhuesit në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me industrinë e riciklimit dhe/ ose prodhues të tjerë. Kërkesat për skemën e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre do të specifikohen në nivel kombëtar në Master Planin e Menaxhimit të Mbetjeve nga Ambalazhet, i cili sipas SKMIM (draft Korrik 2019) do të përgatitet deri në 31 Dhjetor 2021.

Duke qenë se financimi është detyrim i prodhuesve dhe importuesve të produkteve të paketuara, në rastet kur bashkitë do të angazhohen në grumbullimin ose në hapa të tjerë të menaxhimit të këtij lloji të mbetjeve (për shembull, grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme të thata, ku përfshihen edhe mbetjet e ambalazheve nga familjet), ato duhet të marrin një kompensim nga prodhuesit në formën e një sistemi me transferta financiare.[18]

Detyrimi kryesor për zbatimin dhe monitorimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ambalazhet dhe mbetjet e tyre është në nivel kombëtar. Sidoqoftë, zbatimi kërkon bashkëpunim me bashkitë.

[18] SKMIM (draft 07 qershor 2019)

Sipas synimeve të vendosura në draft SKMIM (Korrik 2019), deri në 2023 të paktën 10 %, deri në 2028 të paktën 30 % dhe deri në 2033 të paktën 60 % e mbetjeve nga ambalazhet do të rikuperohet në nivel bashkie.

#### 3.7.6.2 Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MEE)

Mbetjet elektrike dhe elektronike (MEE) përbëhen nga pajisje si televizorë, frigoriferë, makina larëse, etj. MEE etiketohen kryesisht si mbetje të rrezikshme, për shkak të përbërësve të tyre. Përgjithësisht, mungojnë të dhëna mbi sasitë e prodhuara të kësaj rryme mbetjesh në Shqipëri.

Praktika e menaxhimit të kësaj rryme specifike mbetjesh përcaktohet në Ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe detajohet më tej në VKM nr. 957 “Për mbetjet elektrike dhe elektronike”. Sasitë e kësaj rryme mbetjesh po vijnë duke u rritur. Për këtë arsye, MEE do të menaxhohen brenda skemave të PZP. Prodhuesit dhe të gjitha subjektet që nxjerrin pajisje elektrike dhe elektronike në tregun shqiptar do të duhet të organizojnë dhe financojnë grumbullimin e diferencuar dhe më pas trajtimin dhe depozitimin e duhur mjedisor të MEE. Konsumatorët do t’i kthejnë MEE e tyre falas tek distributorët. Në bashkëpunim me bashkitë do të ngrihen qendrat e grumbullimit, në përputhje me SKMIM (draft Korrik 2019).

Në fazën e dizenjimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike, inkurajohet të përgatitet çmontimi dhe rikuperimi i pjesëve në fazën e fundit të jetës.

Sipas SKMIM (draft Korrik 2019), një Master Plan për MEE do të përgatitet deri në 2025 për MEE të përmasave të mëdha dhe deri në 2022 për MEE të vogla, si dhe do të ngrihet një skemë PZP. Krahas kësaj , bashkive u kërkohet të përgatitin mjetet për të kryer grumbullimin e tyre sipas marrëveshjeve të financimit me qeverinë qendrore ose me Organizatën e Përgjegjësisë së Prodhuesit.

Figura e mëposhtme ilustron menaxhimin e kësaj rryme mbetjesh.




**Figura 31 Menaxhimi i MEE**

Është detyrim i NJQV të mbledhin raportime nga prodhuesit mbi sasinë e MEE të prodhuara dhe sasinë e atyre të mbledhura. Në vijim, NJQV i raportojnë këto të dhëna mbi MEE tek AKM.

Synimet e vendosura në SKMIM (draft Korrik 2019) parashikojnë një normë rikuperimi të MEE prej 70 – 80 %, riciklimi 50 – 75 %, riciklimi prej 80 % të llambave që emetojnë gaz dhe grumbullimin e sasisë 4 kg/person/vit deri në 2033.

### 3.7.6.3 Mbetjet e baterive dhe akumulatorëve

Menaxhimi i mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve rregullohet në Ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe specifikohet më tej në Vendimin nr. 866 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre". Sipas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në 2016, një sasi totale prej 5,000 kg mbetje bateri është raportuar në Qarkun Berat, e cila konsiderohet të jetë vetëm një pjesë e gjithë sasisë së mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve.[19]

Për menaxhimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve do të përgatitet një Master Plan dhe do të ngrihet një skemë PZP. Është detyrim i prodhuesve të sigurojnë një sistem grumbullimi i cili do t'u mundësojë konsumatorëve t'i kthejnë bateritë falas. Ata mund ta

[19] SKMIM (draft 07 Qershor 2019)

instalojnë këtë sistem në bashkëpunim me bashkitë, meqënëse bashkive u kërkohet të sigurojnë mjetet për grumbullimin e tyre sipas marrëveshjeve të financimit me qeverinë qendrore ose Organizatën e Përgjegjësisë së Prodhuesit, në përputhje me SKMIM (draft Korrik 2019).

Synimet e vendosura në draft SKMIM parashikojnë një normë grumbullimi të baterive në qendrat pritëse dhe tërheqjen e tyre nga bizneset e liçencuara prej 30 % deri në 2023, 50 % deri në 2028 dhe 80 % deri në 2033, ndërsa norma e grumbullimit dhe trajtimit brenda skemës PZP do të arrijë 50 – 70 % deri në 2033.

### 3.7.6.4 Automjetet në fund të jetës

Menaxhimi i kësaj rryme mbetjesh duhet të realizohet duke respektuar Ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe Vendimin për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës, i cili pajtohet plotësisht me Direktivën e BE 2000/53/EC "Për automjetet në fund të jetës" (AFJ). Katër aktorë kryesorë janë të përfshirë në zbatimin e kuadrit ligjor, përkatësisht prodhuesi, industria e riciklimit, zotëruesi i fundit dhe autoritetet.

Sipas skemës PZP të propozuar në SKMIM (draft Korrik 2019), prodhuesit janë përgjegjës për financimin e menaxhimit të automjeteve në fund të jetës.

Ashtu sikundër përcaktohen kërkesat për ambalazhet dhe mbetjet e tyre dhe MEE, sipas SKMIM (draft Korrik 2019) do të përgatitet një Master Plan kombëtar edhe për automjetet në fund të jetës. Hartimi i planit do të konsolidohet me kontributin e bashkive dhe aktorëve të tjerë të interesuar në zinxhirin (furnizues) të automjeteve (p.sh. kompanitë e siguracioneve dhe qendrat e çmontimit). Autoritetet publike, qendrore dhe vendore dhe njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjës për miratimin e vendeve të përshtatshme për trajtimin e automjeteve në fund të jetës. Veç kësaj, do të ngrihen qendrat e grumbullimit në bashkëpunim me bashkitë.

Pronari i fundit i regjistruar i një automjeti në fund të jetës duhet ta çojë makinën një impiant trajtimi të autorizuar. Në rastin e një kamioni të vogël ose automjeti për transport pasagjerësh, pranimi në qendrën e grumbullimit do të jetë falas. Kamionët e mëdhenj kanë nevojë për trajtime të tjera shtesë (si p.sh. heqja e materialeve të rrezikshme) në një impiant tjetër.

Drafti SKMIM synon të arrihet një normë rikuperimi prej të paktën 85 % të peshës deri në 2028 dhe të paktën 95 % deri në 2033. Norma e riciklimit është paksa më e ulët, të paktën 80 % deri në 2028 dhe të paktën 85 % deri në 2033.

### 3.7.6.5 Mbetjet e gomave

Sipas Ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", mbetjet e gomave, përveç atyre të biçikletave dhe me diametër më të vogël se 1,400 mm, nuk lejohet të depozitohen më në vend depozitime. Rregullat përcaktohen më hollësisht në VKM nr. 652, datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura".

SKMIM (draft Korrik 2019) parashikon ngritjen e qendrave për menaxhimin e mbetjeve të gomave brenda skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Gjithashtu, një Master Plan do të përgatitet brenda datës 31 Dhjetor 2022 dhe do të ngrihen qendra grumbullimi në bashkëpunim me bashkitë.

Zotëruesi i mbetjeve të gomave i dorëzon ato falas në pikën e grumbullimit, për shembull një vend grumbullimi për goma të përdorura. Më pas, një grosist i merr gomat e përdorura nga shitësit me pakicë. Të gjithë subjektet që do të përfshihen në procesin e menaxhimit duhet të jenë të pajisur me liçencë.

Bashkitë duhet të bëjnë përgatitje për grumbullimin sipas marrëveshjes së financimit me qeverinë qendrore ose Organizatën e Përgjegjësisë së Prodhuesit, në përputhje me draft SKMIM. Deri në 2033, 65 % (e peshës) e mbetjeve të gomave do të rikuperohen dhe 50 % do të riciklohen.

Aktualisht nuk ka impiante për incinerimin ose trajtimin e gomave të përdorura në Shqipëri, depozitimi i tyre bëhet kryesisht në vend depozitim.

### 3.7.6.6 Vajrat e përdorura

Vajrat e përdorura (vajra minerale, lubrifikantë industrialë, etj.) klasifikohen si mbetje të rrezikshme dhe duhet të mblidhen veçmas dhe pa u përzier. Gjithashtu do të mblidhet veçmas edhe vaji i gatimit. Sipas qasjes së ekonomisë qarkulluese, vlera e energjisë në vajrat e përdorur duhet të rigjenerohet ose të rikuperohet në kushte të sigurta mjedisore.

Direktiva Europiane (2008/98/EC) është miratuar nëpërmjet VKM nr. 765 datë 7 Nëntor 2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura" dhe fokusohet në lubrifikantët dhe vajrat (gjysëm) të lëngshëm që nuk mund të përdoren për qëllimin për të cilin janë prodhuar.

Vetëm personat fizikë ose juridikë të pajisur me leje mjedisore lejohet të trajtojnë vajrat e përdorur. Në 2015 në Berat u trajtuan 7,650 litra dhe në 2016, 7,350 litra vaj nga një

kompani e licensuar, e cila megjithatë duket se është vetëm një pjesë e gjithë sasisë së vajrave të përdorur që prodhohet.

Sipas skemës së PZP, prodhuesit janë përgjegjës për të organizuar dhe financuar menaxhimin e vajrave të përdorura, përfshi pika grumbullimi, të cilat janë pa pagesë për familjet. SKMIM (draft Korrik 2019) parashikon një normë grumbullimi dhe trajtimi prej 100 % deri në 2033.

## 3.8 Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i Planit

PRMM do të rishikohet dhe nëse do të jetë e nevojshme do të përditësohet të paktën çdo gjashtë vjet.

Treguesit për të monitoruar zbatimin e planit janë në përputhje me treguesit e draft SKMIM (Korrik 2019) siç paraqiten në kapitullin 3.2. Autoriteti ose operatori i Zonës së Mbetjeve do të raportojë çdo vit në MTM dhe MIE rreth zbatimit të planit. Draft amendimi i Ligjit nr. 10463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" parashikon gjithashtu detyrimin e bashkive për t'u raportuar drejtpërdrejt ministrive. Formati i raportimit do të jetë sipas formatit që do të përcaktohet nga Ministritë.

Performanca e PRMM do të monitorohet bazuar në synimet e planit. Prej tyre mund të matet ecuria dhe rezultatet e arritura, mund të merren vendime bazuar në performancë dhe të përcaktohet e vlerësohet suksesi në zbatimin e planit. Treguesit janë në pajtim me legjislacionin përkatës, prodhimin e mbetjeve dhe me synimet për riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve.

Në figurën e mëposhtme paraqitet sistemi për monitorimin dhe raportimin. Ky sistem përfshin aktorë të ndryshëm, sipas organizimit institucional për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.




**Figura 32 Sistemi për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e PRMM në përputhje me draft amendimin e Ligjit nr. 10463**

Për të matur performancën e PRMM përcaktohen dhe përditësohen çdo vit treguesit e kostos si kosto për ton mbetje që grumbullohet dhe trajtohet dhe kosto për person, për familjet.

Cilësia e ujit dhe ajrit dhe emetimet e gazeve serrë monitorohen si tregues të qendrueshmërisë dhe përditësohen çdo vit. Këto sidomos bëhen në lidhje me vend depozitimet dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve.

Përveç këtyre treguesve, duhet të rishikohen çdo vit edhe planet e grumbullimit dhe aktivitetet operative.

## 4 Plani i Veprimit

Aktivitetet, përgjegjësitë dhe afatet kohore që janë shtjelluar në kapitujt e mëparshëm përmblidhen në këtë plan veprimi. Për të gjitha aktivitetet trajtohen dhe përgjegjësitë kryesore.

**Tabela 24 Plani i Veprimit, i cili përmbledh aktivitetet kryesore, përgjegjësitë dhe afatet kohore për zbatimin e PRMM**

(B – Bashkitë, Q – Qark, NR – Ndërmarrja Rajonale MM, P – Prodhuesit e mbetjeve, ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publikei, MTM – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MIE – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)

| Nr. | Masat | Përgjegjësi a kryesore |
|---|---|---|
| **1** | **Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)** | |
| 1.1 | Përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve | B |
| a) | Shtrirja e shërbimeve të grumbullimit në zonat rurale dhe malore | B |
| b) | Ngritja e sistemeve të monitorimit financiar dhe të performancës | B |
| ### | Grumbullimi i diferencuar materialeve të riciklueshme dhe mbetjeve organike | B |
| a) | Projekte pilot për grumbullimin e diferencuar | B |
| a1) | Projekte pilot për grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme të thata | B |
| a2) | Projekte pilot për grumbullimin e diferencuar dhe kompostimin e mbetjeve të gjelbra | B |
| b) | Shtrirja e grumbullimit të diferencuar në shkallë të gjerë | B |
| **2** | **Transporti dhe transferimi i mbetjeve** | |
| 2.1 | Projektimi konceptual i transportimit dhe transferimit | Q/B |
| 2.2 | Zbatimi i stacioneve të transferimit (projekt i detajuar, tenderimi, ndërtimi, vënia në punë) | NR |
| 2.3 | Funksionimi i stacioneve të transferimit si pjesë e sistemit rajonal të MIMN | NR |
| **3** | **Trajtimi i mbetjeve** | |
| 3.1 | Zbatimi i projekteve pilot për kompostimin kolektiv dhe në shtëpi të mbetjeve të gjelbra | B |
| 3.2 | Shtrirja e aktiviteteve të kompostimit | B |
| 3.3 | Projekt pilot për ndarjen e mbetjeve (Bashkia Kuçovë) | Kucova |
| 3.4 | Zbatimi i një impianti për Trajtim Mekanik Biologjik (TMB) | NR/B |
| a) | Planifikimi dhe ndërtimi i TMB | NR/B |
| b) | Funksionimi i MBT | NR/B |
| **4** | **Depozitimi i mbetjeve** | |
| 4.1 | Masa imediate për përmirësimin e vendgrumbullimeve bashkiake të bashkive Berat, Kuçovë dhe Ura Vajgurore | B/MTM |
| 4.2 | Zbatimi i një vend depozitimi sanitar rajonal | B/NR |
| a) | Përzgjedhja e vendit dhe projektimi konceptual i vend depozitimit rajonal | B |
| b) | Zbatimi i një vend depozitimi sanitar rajonal (projekti i detajuar, tenderimi, ndërtimi dhe vënia në punë) | B/NR |
| c) | Funksionimi i vend depozitimit rajonal | NR |
| 4.3 | Rehabilitimi i vendgrumbullimeve të tjera të identifikuara në Raportin për Zbutjen e Riskut në Vend depozitime të DLDP | B |



## Tabela 24 Plani i veprimit - vazhdim

Timeline columns: Faza I (2019–2022, T1–T4), Faza II (2023–2027/2028, T1–T4), Faza III (2028–2033, T1–T4)

| Nr. | Masat | Përgjegjësia kryesore | Timeline note |
|---|---|---|---|
| **9** | **Menaxhimi i mbetjeve nga ndërtimet** | | |
| 9.1 | Përcaktimi i vendeve për ndërtimin e vend depozitimeve për mbetjet inerte | B | |
| 9.2 | Ngritja e impianteve (të trajtimit) për MNP të grumbulluara veçmas | B | |
| 9.4 | Monitorimi i zbatimit të rregulloreve ekzistuese sa i përket grumbullimit të diferencuar, transportimit dhe depozitimit të MNP | B | |
| **10** | **Menaxhimi i rrymave të tjera të mbetjeve** | | |
| 10.1 | Ngritja e qendrave pritëse për materialet e ripërdorshme dhe të ricikluershme | B | |
| 10.2 | Raportimi vjetor i të dhënave për mbetjet, përfshi mbetjet e rrezikshme | M | |
| 10.3 | Bashkëpunimi midis skemave grumbulluese të PZP dhe bashkive | M/B | Depending on the establishment of EPR schemes at national level |
| **11** | **Monitorimi, raportimi dhe rishikimi** | | |
| 11.1 | Monitorimi i performancës së zbatimit të PRMM | B/NR | |
| 11.2 | Raportimi vjetor rreth zbatimit të planit | B/NR | |
| 11.3 | Rishikimi i PRMM (të paktën në vitin e 6-të prej fillimit të tij) | B/NR | |